



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 86

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E martë, 21 maj 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 337, datë 10.5.2024	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 9879
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 338, datë 10.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë... 9879
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 339, datë 10.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë.. 9880
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 340, datë 10.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës..... 9881
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 341, datë 10.5.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Letonisë..... 9883
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 11.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 22, datë 7.3.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-762, datë 9.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shfuqizimin e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 9886
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 16.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 137, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrin nr. 62, datë 26.4.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2023-1310, datë 27.7.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 9898

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 18.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2023-705 (85), datë 7.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 11, datë 17.7.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	9910
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 18.4.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 5622, datë 13.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2221, datë 13.7.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-1941 (159), datë 8.5.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.....	9920
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 2.5.2024	Mbi kërkesën e shoqërisë “FTL” sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k.....	9928
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 2.5.2024	Mbi fillimin e procedurës, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Greennat Solar Park Ballsh” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	9929
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 81, datë 2.5.2024	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 155, datë 7.10.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Mateo&Co’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Murasi’, me kapacitet të instaluar 2000 kw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër”.....	9930
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 82, datë 2.5.2024	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.1.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P.’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”, i ndryshuar.....	9932
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 2.5.2024	Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2024.....	9934
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 118, datë 9.4.2024	Autorizim i ndihmës shtetërore “Garancia shtetërore e huas për subjektet e industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion, si dhe për blerje të lëndës së parë”.....	9944
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 8/10, datë 14.5.2024	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos–Kënetë dhe sistemin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, faza e parë”.....	9948

**URDHËR****Nr. 337, datë 10.5.2024****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari, nga data 12.5.2024 deri më datë 15.5.2024.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese.

4. Zëvendësministri ndalohet të nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri z. Arian Jaupllari.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv/protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin z. Arian Jaupllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL**
Anila Denaj

URDHËR**Nr. 338, datë 10.5.2024****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht,

nga shteti i Bullgarisë, sipas tabelës së mëposhtme:



Nr .	Ndarja administrativ e e nivelit 1	*Ndarja administrativ e e nivelit 2	Ndarja administrativ e e nivelit 3
1	Dobrich	Dobrich-selska*	
2	Dobrich	Dobrich*	
3	Dobrich	General Toshevo*	
4	Pazardzhik	Pazardzhik*	
5	Pazardzhik	Septemvri*	
6	Veliko Tarnovo	Veliko Tarnovo	
7	Haskovo	Haskovo*	
8	Haskovo	Dimitrovgrad*	
9	Plovdiv	Brezovo*	
10	Plovdiv	Rodopi*	
11	Plovdiv	Sadovo*	
12	Kardzhali	Krumovgrad*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuara termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 304, datë 24.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR Nr. 339, datë 10.5.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	* Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Csongrád-Csanád	Szeged*	
Nógrád	Salgótarján*	
Békés	Orosháza*	
Békés	Sarkad*	
Békés	Szarvas*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Tiszavasvári*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Nyírbátor*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Mátészalka*	
Jász-Nagykun-Szolnok	Kunszentmárton*	
Jász-Nagykun-Szolnok	Tiszafüred*	
Komárom-Esztergom	Komárom*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*



2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 110, datë 14.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 340, datë 10.5.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe

embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe e ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi	
Chernivtsi	Hlybys'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Makarivs'kyi*	
Kirovohrad	Dolyns'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'ky*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Dnipropetrovs'k	Vasyl'kivs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolavs'kyi*	
Volyn	Starovyzhivs'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Volyn	Kivertsivs'kyi*	
Poltava	Kobeliats'kyi*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8.



2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka

dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat, në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistiki përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.



2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose më pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 307, datë 24.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 341, datë 10.5.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E LETONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe e ADIS-s, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Sakas*
Kurzemes	Dienvidkurzemes	Kalētu*
Kurzemes	Kuldīgas	Skrundas*
Kurzemes	Kuldīgas	Padures*
Kurzemes	Kuldīgas	Raņķu*
Kurzemes	Kuldīgas	Alsungas*
Kurzemes	Kuldīgas	Īvandes*
Kurzemes	Saldus	Pampāļu*
Kurzemes	Saldus	Zvārdes*
Kurzemes	Talsu	Libagu*
Kurzemes	Talsu	Balgales*
Kurzemes	Talsu	Dundagas*
Kurzemes	Talsu	Īves*
Kurzemes	Talsu	Kūļciema*
Kurzemes	Tukuma	Slampes*
Kurzemes	Tukuma	Degoles*
Kurzemes	Tukuma	Vārkavas*
Kurzemes	Tukuma	Smārdes*
Kurzemes	Tukuma	Jaunpils*
Kurzemes	Tukuma	Irlavas*
Kurzemes	Tukuma	Lestenes*
Kurzemes	Tukuma	Džūkstes*
Kurzemes	Ventspils*	
Latgales	Augšdaugavas	Vecsalienas*
Latgales	Augšdaugavas	Demenes*
Latgales	Augšdaugavas	Dvietes*
Latgales	Augšdaugavas	Maļinovas*
Latgales	Augšdaugavas	Salienas*
Latgales	Augšdaugavas	Bebrenes*
Latgales	Balvu	Lazdulejas*
Latgales	Balvu	Kubulu*
Latgales	Balvu	Lazdukalna*
Latgales	Balvu	Šķilbēnu*
Latgales	Balvu	Balvu*
Latgales	Balvu	Tilžas*
Latgales	Balvu	Rugāju*
Latgales	Balvu	Briežuciema*
Latgales	Briežuciema	Kantīnieku*
Latgales	Krāslavas*	
Latgales	Līvānu	Rožupes*
Latgales	Līvānu	Turku*

Latgales	Ludzas*	
Latgales	Preiļu	Rušonas*
Latgales	Preiļu	Riebiņu*
Latgales	Preiļu	Silajānu*
Latgales	Preiļu	Aizkalnes*
Latgales	Preiļu	Saunas*
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas*
Latgales	Rēzeknes	Silmalas*
Latgales	Rēzeknes	Ilzeskalna*
Latgales	Rēzeknes	Gaigalavas*
Latgales	Rēzeknes	Vērēmu*
Latgales	Rēzeknes	Audriņu*
Latgales	Rēzeknes	Bērzgales*
Latgales	Rēzeknes	Dekšāres*
Latgales	Rēzeknes	Nagļu*
Latgales	Rēzeknes	Grīškānu*
Montana	Valchedram*	
Rīgas	Siguldas	Krimuldas*
Rīgas	Siguldas*	
Rīgas	Ropažu*	
Rīgas	Salaspils	Salaspils*
Vārmes	Kuldīgas	Vārmes*
Vidzemes	Alūksnes*	
Vidzemes	Cēsu*	
Vidzemes	Gulbenes*	
Vidzemes	Limbažu*	
Vidzemes	Madonas*	
Vidzemes	Smiltēnes*	
Vidzemes	Valmieras*	
Vidzemes	Ventspils*	
Vidzemes	Varakļānu*	
Vidzemes	Ogres	Ķeipenes*
Vidzemes	Ogres	Taurupes*
Vidzemes	Ogres	Lauberes*
Vidzemes	Ogres	Suntažu*
Zemgales	Dobele*	
Zemgales	Jelgavas	Valgundes*
Zemgales	Aizkraukles*	
Zemgales	Jēkabpils*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Letonisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8.

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që kafshët:**



a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat, në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**



a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e

përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 306, datë 24.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në shtetin e Letonisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 28, datë 11.4.2024

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 11.4.2024
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të



dokumenteve çështjen nr. 14 (K) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Kestrin Katro, përfaqësuar nga avokat Erind Merkuri, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Lartë Gjyqësor, përfaqësuar nga kryetarja Nureda Llagami.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 22, datë 7.3.2023, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-762, datë 9.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Shfuqizimi i nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 49, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KL Gj*), i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimet nr. 108 dhe nr. 109, datë 9.7.2019, si dhe nr. 172, datë 11.9.2019, KL Gj-ja ka vendosur shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë dhe thirrjen për paraqitjen e kandidaturave, nga radhët e juristëve të spikatur, për tre pozicione të lira që plotësonin kërkesat për ekspertizë të veçantë në fushën e së drejtës administrative (një pozicion) dhe të drejtës civile (dy

pozicione). Për këto pozicione ka aplikuar pranë KL Gj-së edhe kërkuësja.

2. Me vendimin nr. 182, datë 2.10.2019, KL Gj-ja ka vendosur se për kërkuësen, e cila ka aplikuar edhe për pozicionet e shpallura me vendimet e KL Gj-së nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 9.7.2019, procedurat e verifikimit që janë në proces e sipër për këto kandidime janë të vlefshme edhe për kandidimet në pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 172, datë 11.9.2019.

3. Pas kryerjes së verifikimeve për plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit, për kërkuësen është kërkuar raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*ILDKPKI*) për sa i përket kriterit të pasurisë. ILDKPKI-ja i ka dërguar KL Gj-së raportin nr. 109/24 prot., datë 28.10.2019, sipas të cilit: i) deklarimi i kërkuësës nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë; iii) ka mosdeklarim të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) ka përfutur të ardhura në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Ky raport i është njoftuar kërkuësës në rrugë elektronike nga KL Gj-ja dhe ajo ka paraqitur pretendimet e shpjegimet e saj në lidhje me gjetjet e ILDKPKI-së. Nisur nga shpjegimet dhe dokumentet mbështetëse të paraqitura nga kërkuësja, KL Gj-ja i ka kërkuar ILDKPKI-së informacion shtesë, duke i përcjellë edhe këtë dokumentacion mbështetës. Në përfundim të veprimeve verifikuese, ILDKPKI-ja ka përcjellë në KL Gj raportin shtesë nr. 109/25, datë 2.12.2019, sipas të cilit: i) deklarimi i bërë nga kërkuësja nuk është i saktë në përputhje me ligjin; ii) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasurinë; iii) ka mosdeklarim të pasurisë; iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Pasi u njoh me gjetjet e kësaj procedure, kërkuësja ka depozituar pretendimet e saj në KL Gj, duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

4. Më datë 30.12.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në KL Gj, duke e konsideruar të plotë procedurën dhe verifikimet e kryera për kushtet dhe kriteret e kandidimit të kërkuësës, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e KL Gj-së. Kjo fundit, me vendimin nr. 41, datë 23.1.2020, ka vendosur skualifikimin e kërkuësës



dhe përjashtimin e saj nga kandidimi si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, me arsyetimin se ajo nuk ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, për shkak se nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor vlerat e investuara, burimet financiare dhe periudhat kur janë bërë këto investime dhe ka mosdeklarim të pasurisë. Duke mos qenë dakord me vendimin, kërkesja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Apelit.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 32, datë 21.2.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë, vendim që është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1229 (88), datë 24.6.2021, duke e kthyer çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas Kolegjit Administrativ, duke mos lejuar kryerjen e aktit të ekspertimit të kërkuar prej paditëses (kërkuases) në mënyrë të përsëritur gjatë procedurave administrative dhe gjyqësore, si dhe duke mos i dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve kryesore të saj, i është rënduar pozita procedurale në cenim të parimit të kontradiktoritetit. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se mungesa e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm gjatë procedurave administrative nuk është riparuar as gjatë gjykimit të mosmarrëveshjes në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila duhej të vlerësonte, në funksion të debatit gjyqësor, nëse pretendimet për parregullsinë e procesit ligjor në KLGJ kishin një bazë të mjaftueshme për të arsyetuar në mënyrë të plotë dhe për të konkluduar përfundimisht për rastin në shqyrtim.

6. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata Administrative e Apelit ka administruar, në cilësinë e provës shkresore, aktin e ekspertimit të ekspertes M.N. Në përfundim, me vendimin nr. 22, datë 7.3.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadi, duke arsyetuar se pala e paditur (KLGJ), me të drejtë, ka arritur në përfundimin se paditësja si kandidate për gjyqtare në Gjykatën e Lartë nuk e përmbush kriterin e vlerësimit të pasurisë, e, për pasojë, me të drejtë është skualifikuar nga kandidimi, pasi ka rezultuar se ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, sepse nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor vlerat e investuara, burimet financiare dhe periudhat kur janë bërë këto investime (*shih faqen 71 të vendimit të gjykatës së apelit*).

Kundër këtij vendimi kërkuësja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-762, datë 9.3.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas Kolegjit Administrativ, pretendimet e kërkuases janë të pabazuara dhe Gjykata Administrative e Apelit, në rigjykim, ka plotësuar kërkesat e lëna nga Gjykata e Lartë.

8. Më datë 10.7.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 28.7.2023. Kolegji i Gjykatës më datë 22.11.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Më datë 1.3.2024, një prej anëtarëve të Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, për shkak se ndodhej përpara rastit të parashikuar nga neni 36, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 18, pika 1, shkronja “c”, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, e cila u pranua nga Mbledhja e Gjyqtarëve me vendimin nr. 6, datë 3.4.2024.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit administrativ dhe atij gjyqësor i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të:

10.1 *Së drejtës së aksesit në funksione publike të lidhur me parimin e proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë, në rastin e kërkuases, ka devijuar nga praktika e saj e mëparshme (*shih vendimin nr. 00-2022-3674 (416), datë 6.12.2022 të Kolegjit Administrativ*), sipas së cilës “pala paditëse ishte në gjendje të argumentonte që akti objekt gjykimi nuk e ka respektuar këtë parim, që nuk është një akt i nevojshëm dhe se nuk janë mbajtur në konsideratë nga pala e paditur zhvillimi historik dhe situata ekonomike në vendin tonë”. Kërkuësja pretendon se është penguar të kandidojë në



Gjykatën e Lartë edhe për procedurat e tjera që mund të zhvillohen në të ardhmen, duke qenë se është përjashtuar për kriterin e pasurisë. Vendimmarrja e Gjykatës është një mjet për rivendosjen e së drejtës, pasi në rastin eventual të rikthimit për rigjykim dhe fitimit të çështjes, asaj i lind e drejta e shpërbërimit të dëmit.

10.2 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, për shkak se gjyqtari F.K. që ka gjykuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ka qenë i emëruar si gjyqtar në atë gjykatë, por ka qenë gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë, për rrjedhojë ai nuk i kishte tagrat dhe kompetencën për të vendosur si një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit.

10.3 *Parimit të paanshmërisë*, pasi dy nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, konkretisht gjyqtarët E.M. dhe F.K., ishin në një marrëdhënie të posaçme me palën e paditur (KLGJ-në), duke qenë se kishin aplikuar për ngritje në detyrë brenda pushtetit gjyqësor. Gjatë kohës që kjo çështje ishte në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, KLGJ-ja ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për tre pozicione, ku rezultoi se gjyqtarja E.M. është emëruar në një prej tyre. Kërkesa për heqjen dorë nga gjykimi i kësaj gjyqtareje është ngritur edhe në gjykatën e apelit. Edhe gjyqtari F.K., i komanduar për gjykimin e çështjes së kërkuësës, ka aplikuar për ngritje në detyrë në tre gjykata apeli, përfshirë edhe Gjykatën Administrative të Apelit që ka gjykuar çështjen e kërkuësës dhe në përfundim të procedurës është ngritur në detyrë duke u emëruar në një gjykatë apeli. Ky fakt është bërë i ditur vetëm pas përfundimit të gjykimit të çështjes. Ky parim është cenuar edhe nga gjyqtarja A.N., e cila ka shqyrtuar kërkesën e kërkuësës për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtarës E.M., të bërë për shkaqe të ndryshme nga ato më sipër. Gjyqtarja A.N. ka qenë pjesë e trupit gjykues të gjykatës së apelit që ka dhënë vendimin që është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili e ka kthyer çështjen për rigjykim.

10.4 *Parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja nuk i kanë vlerësuar shkresat në tërësinë e tyre, por të ndara, për të mos thënë që nuk i kanë analizuar fare. Raportet e organeve tatimore janë mbajtur në vitet 2004 dhe 2006 dhe tregojnë marrëdhëniet juridike që kanë ndodhur në atë kohë. Duke qenë dokumentacion i mbajtur në ato vite, është e qartë se mënyra e

mbajtjes së tyre nuk ka asnjë lidhje me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në kohën e sotme. Për këtë arsye vërtetësia e tyre nuk mund të vihet në diskutim.

10.5 *Parimit të barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë, në një rast të ngjashëm, kur nga Gjykata Administrative e Apelit ka pasur tre mendime të ndryshme, ka kërkuar aplikimin e nenit 307, paragrafi i tretë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (vendimi nr. 00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022 i Kolegjit Administrativ). Ky parim është cenuar edhe nga KLGJ-ja, pasi edhe prej saj janë aplikuar standarde të dyfishta për raste të ngjashme (vendimi për vlerësimin e një kandidati për magjistrat nr. 254, datë 12.11.2019).

10.6 *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka parashtruar si shkaqe rekursi disa nga pretendimet e kërkuësës. Gjithashtu, vendimi i Kolegjit Administrativ nuk ka qëndrim në lidhje me pretendimet për procesin në gjykatën e apelit, duke qenë se vendimi i kësaj të fundit përmbante tre qëndrime të ndryshme nga tre anëtarët e trupit gjykues (mendimin e shumicës, mendimin paralel dhe mendimin kundër). Në këtë drejtim, Kolegji Administrativ nuk ka arsyetuar në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 307, paragrafi i tretë, të KPC-së. Ky standard është cenuar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi nga përmbajtja e vendimit të saj nuk rezultoi se ka një vendimarrje konkrete, për shkak të pasjes së tre mendimeve të ndryshme, shumicë, kundër dhe paralel. Në rastin konkret, duke pasur tre mendime të ndryshme, nuk ka asnjë konkluzion në lidhje me vlerësimin e aktit të ekspertimit, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rigjykimin e çështjes, që ai të merrej si provë në gjykim. Qëndrim kontradiktor ka edhe për sa i përket vlerësimit në lidhje me praktikën e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe faktit nëse pasuria e kërkuësës është e ligjshme ose jo.

10.7 *Së drejtës për punë dhe profesion*, pasi ligjvënësi që nga viti 1993 nuk e konsideron të nevojshme mbajtjen e dokumentacionit kontabël nga subjektet tregtare më shumë se 10 vjet. Megjithatë, kërkuësja është penalizuar se nuk ka arritur të sjellë dokumentacionin kontabël të shoqërive tregtare për këtë periudhë 10-vjeçare. Mënyra se si është interpretuar ligji nga KLGJ-ja, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë ka sjellë një kufizim joproporcional të së drejtës së kërkuësës për



punë. E vetmja mënyrë interpretimi e kësaj dispozite është që verifikimi i pasurisë të përfshijë të gjithë periudhën për të cilën ekziston detyrimi për ruajtjen e dokumentacionit kontabël. Në rast se e vetmja formë interpretimi mbetet verifikimi i pasurisë së kandidatëve në mënyrë të pakufizueshme, atëherë neni 32, pika 2, i ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*), rezulton të jetë antikushtetues, pasi kufizon në mënyrë joproporcionale të drejtën për punë dhe profesion.

11. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

A. Për legjitimitimin

11.1 Kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimet e saj për cenimin e *parimit të paanshmërisë* dhe të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi, bazuar në dispozitat e KPC-së, ajo ka pasur mundësi të kundërshtonte përbërjen e trupit gjykues por nuk e ka bërë një gjë të tillë. Pretendimi se ajo nuk ka qenë në dijeni se dy nga anëtarët e trupit gjykues kishin aplikuar për ngritje në detyrë nuk qëndron, pasi ky është një informacion publik dhe ajo nuk mund të justifikohet me padijeninë e saj.

B. Për themelin

11.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar, pasi në rastin e çështjes së kërkueses është konstatuar mungesa e padisponueshmërisë ligjore të të gjithë anëtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe për këtë arsye zëvendëskryetari i saj i është drejtuar KLGJ-së me kërkesë për caktimin e gjyqtarit për shqyrtimin e çështjes. Me vendimin nr. 512, datë 26.10.2021 të KLGJ-së, gjyqtari F.K., i cili ka qenë gjyqtar i deleguar në Gjykatën e Apelit Durrës (sipas vendimit nr. 525, datë 27.10.2020), është caktuar në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen e kërkueses. Ky delegim është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

11.3 Pretendimi i kërkueses për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi vetëm fakti se gjyqtarët kanë aplikuar për ngritje në detyrë nuk mjafton për të mbështetur pretendimet për paanshmëri të tyre. Këtij pretendimi i është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë shteruese, sipas të cilit pretendimi është hipotetik dhe nuk krijon dyshime

të arsyeshme për paanësinë e gjyqtarit. Edhe pretendimi tjetër i kërkueses, që lidhet me gjyqtaren që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, nuk është i bazuar, pasi arsyeja për të cilën ka ngritur pretendimet e saj nuk përfshihet në asnjë prej dispozitave të nenit 72 të KPC-së.

11.4 Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* dhe të së drejtës për t’u dëgjuar nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, pasi, në thelb, kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga KLGJ-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata. Gjithsesi, këtyre pretendimeve u është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Kërkueses i është garantuar e drejta për t’u dëgjuar në procesin administrativ të zhvilluar nga KLGJ-ja. Ajo është njohur me aktet e nxjerra nga organet e përfshira në proces, për të cilat ka paraqitur disa herë shpjegimet e saj dhe dokumentet shoqëruese. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka bërë pjesë të procesit gjyqësor edhe ekspertin e kërkuar nga vetë kërkuesja, duke plotësuar detyrat e lëna nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, mendimi i ekspertit nuk është i detyrueshëm për gjykatën.

11.5 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi vendimi i ngjashëm i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i përmendur nga kërkuesja i referohet rastit kur mendimi i gjyqtarit paralel ka shfaqur kundërshti me pjesën urdhëruese të vendimit gjyqësor dhe jo alternativë të pjesës përshkruese-arsyetuese. Në rastin e paraqitur nga kërkuesja, mendimi i gjyqtaritka qenë mendim kundër dhe jo mendim paralel, pasi konkurronte me dispozitivin e vendimit dhe jo me arsyetimin e tij. Ndërkohë, ndryshe paraqitet rasti i kërkueses, ku mendimi paralel konkurren vetëm me pjesën arsyetuese të vendimit dhe jo me dispozitivin. KLGJ-ja në asnjë rast nuk ka mbajtur standarde të dyfishta, për shkak se kandidatët e tjerë që kanë aplikuar pranë saj kanë qenë në kushte të ndryshme me kërkuesen.

11.6 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit* është i pabazuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkueses për cenimin e procesit të rregullt ligjor. Pretendimet e kërkueses të ngritura në rekurs, jo vetëm që janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në vendim, por janë trajtuar nga Kolegji Administrativ, vendimi i të cilit është i qartë,



logjik dhe nuk ka kundërthënie, duke plotësuar standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Edhe Gjykata Administrative e Apelit e ka respektuar këtë standard, pasi vendimi i saj është marrë me shumicë votash, ku një nga anëtarët ka qenë me mendim pakice, ndërsa një tjetër, i cili ka qenë në shumicë, ka arsyetuar me mendim paralel. Që në fjalitë e para të mendimit paralel gjyqtari që ka mbajtur këtë qëndrim ka theksuar se vendimi i KLGJ-së për skualifikimin e kërkuësës është i bazuar në ligj. Gjithashtu, i njëjti gjyqtar (i mendimit paralel) rezulton se ka votuar që padia të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova (paragrafi 4, faqja 75, i vendimit). Gjyqtari me mendim paralel ka votuar kundër vetëm për sa i përket disponimit në pjesën e dispozitivit të vendimit përfundimtar për lejueshmërinë ose jo të rekursit. Në këtë kuptim vërehet qartë se vendimi i gjykatës së apelit është marrë me shumicën e nevojshme të votave të gjyqtarëve. Ai vendim ka respektuar standardet kushtetuese për arsyetimin, si dhe u ka dhënë përgjigje të detajuar të gjitha pretendimeve të kërkuësës. Ai është logjik, i qartë dhe jokontradiktor. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuësës në drejtëm të këtij pretendimi, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës.

11.7 Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për punë dhe profesion*, kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se zbatimi i parashikimeve ligjore të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 përbën cenim të këtyre parimeve. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenin 71 të ligjit nr. 8577/2000, ajo nuk legjitimohet në kërkesën e saj për shfuqizimin e kësaj dispozite.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi

gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka vërejtur se ai përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky kriter përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, Gjykata konstaton se kërkuësja në ankimin kushtetues individual ka pasur si pjesë të objektit edhe shfuqizimin e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016, duke e lidhur atë me cenimin e së drejtës për punë dhe profesion. Ndërsa në prapësimet e saj të datës 8.1.2024, që ka sjellë ndaj prapësimeve të subjektit të interesuar, KLGJ-së, kërkuësja ka parashtruar se pretendimet në lidhje me nenin 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 nuk janë në objekt të kërkesës, por janë ngritur vetëm si argumente për cenimin e së drejtës për punë dhe profesion.

16. Sipas nenit 31/b, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuësi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata. Në këtë rast Gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes. Në kuptim të kësaj dispozite, si edhe



prapësimeve të kërkuases të datës 8.1.2024, të sjella ndaj prapësimeve të subjektit të interesuar, Gjykata evidenton se vetë kërkuësja ka hequr dorë nga kërkitimi për shfuqizimin e nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 të lidhur me cenimin e së drejtës për punë dhe profesion. Për këtë arsye, Gjykata çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit për këtë kërkitim.

17. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në ankimin kushtetues individual, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, Gjykata vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, Gjykata konstaton se kërkuësja ka ngritur pretendime edhe për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime, konsiderohet se plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike, ndaj pretendimi i subjektit të interesuar, KLGJ-së, për mosplotësimin e këtij kriteri është i papabazuar.

18. Kërkuësja legjitimohet *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor që ka vendosur për çështjen e saj, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 9.3.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 10.7.2023 nëpërmjet shërbimit postar, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit, për shkak se Gjykata e Lartë në rastin konkret ka devijuar nga praktika e saj e mëparshme, kërkuësja i ka parashtruar para Gjykatës vetëm në aktin e shpjegimeve shtesë të datës 26.12.2023 dhe si të tilla

ato përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues. Referuar nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se këto pretendime të reja nuk mund të merren në shqyrtim¹, pasi ato janë paraqitur nga kërkuësja pasi Kolegji kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë plenare².

20. Në këndvështrim të legjitimitetit *ratione materiae*, edhe pse Gjykata nuk ka ende një qëndrim për sa i takon zbatimin të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, i cili parashikon verifikimin nga ana e Gjykatës të mundësisë për rivendosjen e të drejtave që pretendohen se janë shkelur, si kriter për legjitimitetin e kërkuases, në rastin konkret, duke qenë se shqyrtimi i ankimit kushtetues individual ka të bëjë me vlerësimin e pasurisë së saj, i cili është një kriter i pashërueshëm në të ardhmen, në rast të kandidimit në procedura për pozicione të ngjashme, Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione materiae* për paraqitjen e ankimit kushtetues.

21. Në lidhje me shkaqet e ankimit kushtetues individual të paraqitura nga kërkuësja në këtë gjykim kushtetues, Gjykata vëren se, ndër të tjera, ajo ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, duke argumentuar se në një rast të ngjashëm, kur nga Gjykata Administrative e Apelit ka pasur tre mendime të ndryshme, shumicë, kundër dhe paralel, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka kërkuar aplikimin e nenit 307, paragrafi i tretë, të KPC-së. Sipas saj, edhe KLGJ-ja ka aplikuar standarde të ndryshme për raste të njëjta.

22. Për sa u përket këtyre pretendimeve (për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit), Gjykata konstaton se kërkuësja nuk ka sjellë asnjë argument konkret dhe nuk ka arritur të provojë nga pikëpamja kushtetuese se si vendimet/qëndrimet e kundër-

¹ Gjyqtarja Elsa Toska votoi për pranimin e parashtrimeve shtesë të kërkuases, edhe pse janë shkaqe të reja, me argumentet se: (i) pretendimet janë brenda objektit dhe bazës kushtetuese të përcaktuar në ankimin kushtetues individual të kërkuases; (ii) mohimi i aksesit në lidhje me pretendimet e reja të kërkuases në gjykimin kushtetues, si rregull, nuk mund të mbështetet në dispozitat e KPC-së, por vetëm si përjashtim; (iii) jurisprudenca kushtetuese nuk e ka pasur të kufizuar shqyrtimin e pretendimeve/shkaqeve të reja të individit deri në fazën e vendimarrjes së kalimit të Faqe | 9892

çështjes në seancë plenare, ndaj edhe ky interpretim i shumicës e ngushton aksesin substancial të individit.

² Ndërsa, gjyqtarja Sonila Bejtja votoi për marrjen në shqyrtim të parashtrimeve shtesë, pasi në këtë rast nuk është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim paraprak nga Kolegji në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe më pas kalimi për shqyrtim në seancë plenare, por është vendosur kalimi për shqyrtim në seancë plenare nga Kolegji i Gjykatës, pa kaluar më parë filtrin e shqyrtimit nga Mbledhja e Gjyqtarëve.



shtuara kanë cenuar këtë parim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim prej saj.

23. Gjithashtu, kërkesja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t'u dëgjuar, duke argumentuar se: ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja nuk i kanë vlerësuar aktet në tërësinë e tyre, por të ndara, për të mos thënë që nuk i kanë analizuar fare; raportet e organeve tatimore janë mbajtur në vitet 2004 dhe 2006 dhe tregojnë marrëdhëniet juridike që kanë ndodhur atë kohë; duke qenë dokumentacion i mbajtur në ato vite, është e qartë se mënyra e mbajtjes së tyre nuk ka asnjë lidhje me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në kohën e sotme, për këtë arsye vërtetësia e tyre nuk mund të vihet në diskutim.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjyqimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre (*shih vendimin nr. 5, datë 9.2.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vëren se argumentet e kërkeses për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t'u dëgjuar kanë të bëjnë tërësisht me mënyrën e vlerësimit të provave nga ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja dhe, si të tilla, ato nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues të kësaj Gjykate.

25. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkeses, konkretisht atyre që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të paanshmërisë në gjykim dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, Gjykata çmon se hyjnë në juridiksionin kushtetues ndaj, në vijim, do të shqyrtohet bazueshmëria e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

26. Kërkesja ka pretenduar se gjyqtari F.K. që ka gjykuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ka qenë i emëruar si gjyqtar në atë gjykatë, por ka qenë gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë,

për rrjedhojë ai nuk i kishte tagrat dhe kompetencën për të vendosur si një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Apelit.

27. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi në rastin e çështjes së kërkeses është konstatuar mungesa e padisponueshmërisë ligjore të të gjithë anëtarëve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe për këtë arsye zëvendëskryetari i saj i është drejtuar KLGJ-së me kërkesë për caktimin e gjyqtarit për shqyrtimin e çështjes. Sipas subjektit të interesuar, ky delegim është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

28. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 2, datë 29.1.2016; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po, ashtu, kjo Gjykatë ka theksuar se një gjykatë e caktuar me ligj duhet të plotësojë një sërë kushtesh, si mënyra e emërimit të anëtarëve apo edhe ekzistenca e garancive procedurale (*shih vendimet nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, përfshin në vetvete edhe elementin e gjyqtarit të ligjshëm, çka do të thotë se një organ gjyqësor duhet të krijohet në përputhje me vullnetin e ligjvënësit. Kjo kërkon që një gjykatë duhet të formohet në përputhje me legjislacionin për krijimin dhe kompetencat e organeve gjyqësore, si dhe me çdo dispozitë tjetër ligjore, mosrespektimi i të cilave bën që pjesëmarrja e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjes të jetë jo e rregullt. Parimi i gjyqtarit të ligjshëm kërkon që të respektohen dispozitat që rregullojnë procedurën e emërimit të gjyqtarëve (*shih vendimin nr. 15, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja e kërkeses është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 14.9.2021. Pas regjistrimit të saj dhe hedhjes së shortit për caktimin e trupit gjykues, rezulton se disa gjyqtarë të asaj gjykate, të caktuar si anëtarë të trupit gjykues, konkretisht gjyqtarët E.M., A.G., R.L. dhe A.D., kanë kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesa të cilat janë pranuar respektivisht nga



zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë dhe zëvendëskryetarja e Gjykatës Administrative të Apelit. Në kushtet kur nuk kishte gjyqtarë të tjerë për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes së kërkuësës, zëvendëskryetarja e Gjykatës Administrative të Apelit i është drejtuar me kërkesë KLGJ-së për delegimin e një gjyqtari për formimin e trupit gjykues. Në përgjigje të kësaj kërkesë, KLGJ-ja, me vendimin nr. 512, datë 26.10.2021, ka vendosur që gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, F.K., i cili ishte i komanduar në atë gjykatë sipas vendimit të po atij organi nr. 525, datë 27.10.2020, të caktohej në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Apelit çështjen e kërkuësës.

31. Sipas nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t'u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill (*pika 1*). Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat (*pika 4, shëronja "a"*). Sipas të dhënave të faqes zyrtare të KLGJ-së rezulton se në mbledhjen e datës 27.10.2020 ajo ka vendosur përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtarit F.K. dhe komandimin e tij në skemën e delegimit të gjyqtarit dhe caktimin si gjyqtar të kësaj skeme në Gjykatën e Apelit Durrës. Gjithashtu, rezulton se më datë 22.4.2021 KLGJ-ja, në vijim të procesit të ngritjes në detyrë për plotësimin e vendeve vakante në gjykatat e apelit, ka vendosur kualifikimin e gjyqtarit F.K. dhe vijimin e procedurave të emërimit për të në gjykatën e apelit.

32. Gjykata, bazuar në faktet e mësipërme (*shih paragrafin 30 të vendimit*), konstaton se në Gjykatën Administrative të Apelit, nga numri i gjyqtarëve në detyrë në kohën e regjistrimit dhe shqyrtimit të çështjes së kërkuësës (pesë gjyqtarë), katër prej tyre kanë dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, të cilat janë pranuar. Në vijim, për sa kohë që kishte rënë shkaku i paraqitur si pengesë nga gjyqtarja E.M., kjo gjyqtare është caktuar anëtare e trupit gjykues. Megjithatë, në situatën që sërish nuk formohej trupa prej tre gjyqtarësh për gjykimin e çështjes, ishte i nevojshëm caktimi i një gjyqtari nga skema e delegimit në kuptim të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, delegimi i gjyqtarit në rastin konkret

nga KLGJ-ja është bërë në përputhje me kompetencat e saj dhe në përputhje me parashikimet e nenit 45 të ligjit nr. 96/2016, duke deleguar dhe caktuar në Gjykatën Administrative të Apelit një gjyqtar që plotësonte kriteret ligjore.

33. Për sa më lart, Gjykata çmon se delegimi dhe pjesëmarrja e atij gjyqtari në gjykimin e çështjes së kërkuësës është bërë duke respektuar dispozitat që rregullojnë procedurën e delegimit të gjyqtarëve. Pra, përbërja e trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuësës, në të cilën ka marrë pjesë edhe gjyqtari F.K., është formuar në mënyrë të rregullt, sipas legjislacionin në fuqi. Për rrjedhojë, në vlerësimin e Gjykatës, në rastin konkret është plotësuar elementi i gjyqtarit të ligjshëm, që në vetvete lidhet me respektimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

34. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim

35. Kërkuësja ka pretenduar se dy nga anëtarët e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, konkretisht gjyqtarët E.M. dhe F.K., ishin në një marrëdhënie të posaçme me palën e paditur (KLGJ), duke qenë se kishin aplikuar për ngritje në detyrë brenda pushtetit gjyqësor. Sipas saj, ky parim është cenuar edhe nga gjyqtarja A.N., e cila ka shqyrtuar kërkesën e kërkuësës për heqjen dorë nga gjykimi të gjyqtarës E.M., të bërë për shkaqe të ndryshme nga ato më sipër. Gjyqtarja A.N. ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar për herë të parë padinë e kërkuësës, vendim i cili është prishur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen për rigjykim.

36. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi vetëm fakti se gjyqtarët kanë aplikuar për ngritje në detyrë nuk mjafton për të mbështetur pretendimet për paanshmëri të tyre. Sipas KLGJ-së, këtij pretendimi i është dhënë përgjigje e arsyetuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në mënyrë shteruese dhe se ky pretendim është hipotetik e nuk krijon dyshime të arsyeshme për paanshmëri të gjyqtarit. Po ashtu, KLGJ-ja ka prapësuar se edhe pretendimi tjetër i kërkuësës, që lidhet me gjyqtaren që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, nuk është i bazuar, pasi arsyeja për të cilën ka ngritur



pretendimet e saj nuk përfshihet në asnjë prej dispozitave të nenit 72 të KPC-së.

37. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi nga një gjykatë e paanshme. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Në rastin konkret, Gjykata, nisur nga natyra e pretendimeve të kërkuases, vlerëson se duhet t'i trajtojë ato për secilin gjyqtar të Gjykatës Administrative të Apelit si në testin *objektiv*, ashtu dhe në testin *subjektiv* për të arritur në konkluzionin nëse ka pasur cenim të parimit të paanshmërisë.

40. Gjykata vëren se gjyqtarët E.M. dhe F.K., të cilët kanë qenë në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuases, kanë aplikuar pranë

KL.GJ-së për ngritje në detyrë. Në përfundim të këtyre procedurave, referuar të dhënave të faqes zyrtare të KL.GJ-së, rezulton se me vendimin e datës 1.11.2022 ajo ka vendosur ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit F.K., kurse me vendimin e datës 28.4.2023 ka miratuar propozimin e gjyqtarës E.M. për emërim në Gjykatën e Lartë.

41. Gjykata eidenton se sipas nenit 147, pika 1, të Kushtetutës, KL.GJ-ja ka përgjegjësinë për të siguruar jo vetëm pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e pushtetit gjyqësor, por edhe mbarëvajtjen e tij, e cila sipas ligjit nr. 96/2016 lidhet edhe me çështjet e emërimit, transferimit, delegimit ose ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, duke qenë se këta të fundit janë subjekte të veprimtarisë funksionale që ajo ushtron. Për rrjedhojë, bazuar në përgjegjësitë kushtetuese të KL.GJ-së, ashtu edhe në situatën faktike ku gjyqtarët në mënyrë sistematike vlerësohen profesionalisht në kuptim të ligjit nr. 96/2016, përfshihen në skemat e delegimit si dhe në sistemin e karrierës, me qëllim ngritjen e tyre në detyrë, vetëm fakti që këta dy gjyqtarë në kohën e shqyrtimit të çështjes kanë qenë pjesë e procedurave për promovimin e tyre që zhvillohen nga KL.GJ-ja, nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të vënë në dyshim njëanshmërinë e tyre. Marrëdhënia e KL.GJ-së me gjyqtarët që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së kërkuases, nuk është marrëdhënie personale në kuptim të nenit 72 të KPC-së, por marrëdhënie sistematike, për rrjedhojë nuk mund të përfshihet në ato shkaqe që kanë të bëjnë me pasjen e interesit për çështjen në gjykim apo që lidhen me arsye serioze njëanshmërie.

42. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuësja nuk ka paraqitur ndonjë provë ose fakt bindës që të vërë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve E.M. dhe F.K. dhe nuk ka arritur të provojë se si vlerësimi i tyre ka ndikuar në vendimarrje. Në këto kushte, në mungesë të provave të paraqitura nga kërkuësja në këtë drejtim, nuk ka arsye për të vënë në dyshim paanshmërinë e këtyre gjyqtarëve dhe për të besuar se ata kanë pasur interes të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes gjyqësore midis kërkuases dhe KL.GJ-së. Për më tepër, Gjykata konstaton se këto pretendime të kërkuases kanë marrë përgjigje të arsyetuar, shteruese, nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

43. Ndërsa për sa i përket pretendimit për gjyqtaren A.N., Gjykata konstaton se vendimarrjet në të cilat ajo ka marrë pjesë janë të një natyre



krejtësisht të ndryshme. Në rastin e parë të gjykuar nga gjyqtarja A.N. ajo ka marrë pjesë në shqyrtimin e ankimit të kërkuases kundër vendimit të KLGJ-së, ku ka shqyrtuar themelin e pretendimeve të saj, ndërsa në rastin e dytë ka marrë pjesë në shqyrtimin e kërkesës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes të gjyqtarës E.M., që nuk ka asnjë lidhje me procesin gjyqësor ku ka qenë pjesë dhe ku është shprehur për themelin e pretendimeve të kërkuases. Ajo gjyqtare ka shqyrtuar vetëm nëse në rastin konkret ndodhej para rastit të ekzistencës së kriterëve që e detyrojnë gjyqtarin të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje të caktuar. Kërkesja, për më tepër, nuk ka paraqitur ndonjë provë për të argumentuar se si vlerësimi i bërë nga gjyqtarja A.N. për kërkesën e gjyqtarës E.M. për heqjen dore nga shqyrtimi i çështjes ka ndikuar në vendimarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit.

44. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim janë të pabazuara.

B.3 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

45. Kërkesja ka pretenduar se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk rezulton se ka një vendimarrje konkrete, për shkak të pasjes së tre mendimeve të ndryshme, shumicë, kundër dhe paralel. Në këtë kuptim, sipas saj, vendimi i gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë i arsytuar. Ajo ka pretenduar se edhe pse e ka ngritur këtë pretendim në rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim, duke mos arsytuar në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 307, paragrafi i tretë, të KPC-së. Gjithashtu, kërkesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në pjesën hyrëse të vendimit të tij, nuk ka pasqyruar të gjitha pretendimet e ngritura prej saj në rekurs dhe mënyra e arsytimit të tij vjen në kundërshtim me jurisprudencën kushtetuese. Konkretisht, sipas kërkuases, në vendimin e Kolegjit Administrativ nuk janë parashtruar pretendimet për cenimin e parimit të paanshmërisë nga gjyqtarja A.N. dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj nga gjyqtari F.K.

46. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuases për cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe pretendimet e saj janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në vendim, si dhe janë trajtuar në

vendimin e kundërshtuar, i cili plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Sipas subjektit të interesuar, edhe vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit i plotëson këto kritere, pasi ai është marrë me shumicë votash, ku një nga anëtarët ka qenë me mendim pakice, ndërsa një tjetër, i cili ka qenë në shumicë, ka arsytuar me mendim paralel. Në këtë kuptim, sipas KLGJ-së, vendimi i gjykatës së apelit është marrë me shumicën e nevojshme të votave të gjyqtarëve.

47. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 23.2.2023; nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i asaj gjykate. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në rastet kur pretendimet me natyrë kushtetuese të paraqitura në rekurs nuk gjejnë pasqyrim në vendimin e Gjykatës së Lartë dhe atyre nuk u jepet përgjigje, arsytimi i vendimit të asaj gjykate nuk ka përmbushur një ndër funksionet e tij, konkretisht të drejtën e individit për t'u dëgjuar për të gjitha pretendimet e ngritura (*shih vendimin nr. 19, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin në përfundim të



gjykimit është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë së kërkuës (paditëses), përveç arsytimit të tij përmban edhe mendimin pjesërisht kundër dhe arsyetimin paralel të njërit gjyqtar, si edhe mendimin e pakicës të një gjyqtari tjetër. Kërkuësja, në rekurs ka pretenduar se për sa kohë që vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatës së apelit nuk ka një shumicë, konsiderohet se ajo nuk ka një vendim të arsyetuar në lidhje me pretendimet e saj të ngritura në kërkesëpadi. Për rrjedhojë, për shkak të mënyrës se si kanë votuar gjyqtarët e trupit gjykues në gjykatën e apelit dhe mënyrës së arsytimit të atij vendimi, kërkuësja ka parashtruar si shkak në rekurs edhe se ajo nuk ka marrë një përgjigje përfundimtare në lidhje me pretendimet e saj, ndërkohë që gjykata e apelit duhej të kishte vepruar sipas parashikimit të nenit 307 të KPC-së.

50. Gjykata vëren, gjithashtu, se në ankimin kushtetues individual kërkuësja ka referuar një çështje tjetër të shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka zgjidhur atë bazuar në interpretimin e nenit 307 i KPC-së (*shih vendimin nr. 00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Duke iu referuar asaj çështjeje, Gjykata vëren se një ndër shkaqet e rekursit, me të cilin është vënë në lëvizje Gjykata e Lartë, ka qenë edhe mënyra e arsytimit të gjyqtarëve të gjykatës së apelit, e parë kjo në lidhje me dispozitivin e vendimit. Në atë rast Gjykata e Lartë ka konstatuar tre qëndrime të ndryshme në vendimin e kundërshtuar, çka bënte të pamundur të kuptohej zgjidhja e çështjes konkrete dhe duke e shqyrtuar pretendimin në këndvështrim të standardit të arsytimit, në interpretim të nenit 307 të KPC-së, ajo ka analizuar në lidhje me mendimin paralel se ai “*nuk mund të synojë një disponim të ndryshim mbi mosmarrëveshjen në gjykim. Pra mendimi paralel ka një qasje ndryshe në arsytimin e vendimit për mënyrën e interpretimit të ligjit, e cila kurrsesi nuk mund të çojë në një zgjidhje të ndryshme të çështjes. Qëllimi i mendimit paralel është të pasurojë jurisprudencën me mënyra alternative dhe novatore të kuptimit të ligjit, të cilat mbështesin në mënyrë të plotë urdhërimet e dispozitivit, por jo të kundërshtojnë dispozitivin e vendimit gjyqësor*” (*shih paragrafin 50 të vendimit nr. 00-2022-1717 (265), datë 7.7.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*). Pra, në konkluzion Gjykata e Lartë ka vënë theksin te harmonia dhe koherenca që duhet të ekzistojë mes pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese të vendimit, mungesa e së cilës vë në dyshim legjitimitetin e vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, në atë rast Gjykata e Lartë e

ka konsideruar të pavlefshëm vendimin e gjykatës së apelit dhe në përfundim të gjykimit ka vendosur prishjen e tij dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

51. Gjykata vëren se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kërkuësja, përveç pretendimit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ka ngritur edhe disa pretendime të tjera me natyrë kushtetuese, siç është ai për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykatën e apelit dhe të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se shkaqet e parashtruara në rekurs nuk ngrenë problematika të zbatimit të gabuar të ligjit të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk parashtrojnë një qëndrim të ndryshëm të gjykatës së faktit nga vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit Administrativ, si dhe nuk konstatohet që gjykimi i zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë të ketë pasur shkelje të rënda procedurale me pasoje pavlefshmërinë e vendimit ose procedurës së gjykimit. Sipas Kolegjit Administrativ janë zbatuar detyrat e Gjykatës së Lartë në lidhje me riçeljen e hetimit gjyqësor, duke marrë në shqyrtim aktin e ekspertimit të kërkuar nga pala paditëse, ndërsa vlerësimi i aktit në raport me provat e tjera nga gjykata në funksion të vendimmarrjes së saj, ka të bëjë me vlerësimin e provave, vlerësim i cili del jashtë funksionit të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 41 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

52. Për sa u përket pretendimeve me natyrë kushtetuese të parashtruara nga kërkuësja në rekurs, rezulton se Kolegji Administrativ i ka dhënë përgjigje vetëm atij për cenimin e parimit të paanshmërisë, duke e vlerësuar të pabazuar. Për sa i përket pretendimit me natyrë kushtetuese për arsytimin e vendimit të gjykatës së apelit, të lidhur me mungesën e harmonisë dhe koherencës ndërmjet pjesës arsyetuese dhe asaj urdhëruese të tij, Gjykata e Lartë nuk e ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka dhënë përgjigje në pjesën arsyetuese të vendimit, por është mjaftuar me pasqyrimin e tij vetëm në pjesën hyrëse të vendimit. Për rrjedhojë, kërkuësja ka vënë në diskutim respektimin e standardit të arsytimit edhe nga Gjykata e Lartë, duke pretenduar se në çështjen e saj ishte e nevojshme që ajo gjykatë, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, të bënte interpretimin e nenit 307 të KPC-së, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të çështjes konkrete.



53. Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe, nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2 datë 11.2.2021; nr. 1, datë 20.1.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, në vlerësimin e Gjykatës është detyrë e Gjykatës së Lartë që, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë ligji dhe në kuptim të parimit të subsidiaritetit, t'u japë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese në rastet kur gjykatat më të ulëta nuk kanë kryer funksionin e tyre për interpretimin e ligjit të zbatueshëm (*shih vendimet nr. 25, datë 9.4.2024; nr. 19, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Në përputhje me standardet e mësipërme, si edhe bazuar në vetë praktikën e Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme, Gjykata vlerëson se për shkak të natyrës së pretendimeve të parashtruara në rekurs, ajo gjykatë duhej të kishte mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 307 të KPC-së, në mënyrë që t'i jepte përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuësës për respektimin e së drejtës për proces të rregullt në aspekt të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vlerëson se për shkak se mungesa e arsyetimit në vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në lidhje me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të nenit 307 të KPC-së, vë në dyshim respektimin e standardit të arsyetimit nga ana e Gjykatës së Lartë, pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për proces të rregullt është i bazuar.³

55. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësës për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj janë të pabazuara, ndërsa pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 31/b, pika 1, 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-762, datë 9.3.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 11.4.2024.

Shpallur më 16.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

VENDIM

Nr. 29, datë 16.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

të Apelit dhe, për rrjedhojë, duke qenë se shkelja është kryer nga ajo gjykatë, votuan edhe për kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit.

³ Gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim dhe Marjana Semini votuan për cenimin e këtij standardi edhe nga vendimmarrja e Gjykatës Administrative Faqe | 9898



me sekretare Belma Lleshi, më datë 16.4.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 26 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Elda Dinaj, përfaqësuar nga avokat Ermir Beta, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Altin Dumani dhe Enkeleda Millonai.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 137, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrin nr. 62, datë 26.4.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2023-1310, datë 27.7.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 41, 42 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i protokollit shtesë të saj; nenet 32 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbi bazën e kallëzimit të datës 22.2.2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 30, datë 24.2.2023 për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të

zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara respektivisht nga nenet 260, 257/a dhe 287 të Kodit Penal (KP) ndaj një deputeti. Më datë 17.3.2023 është vendosur regjistrimi i këtij shtetasi si person nën hetim, i dyshuar për kryerjen e këtyre veprave penale.

2. Në kuadër të këtij procedimi Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) me kërkesë me objekt caktimin e masës së sigurimit pasuror, sekuestro preventive, për dy pasuri të paluajtshme, një prej të cilave, një vilë dhe një sipërfaqe toke, e ndodhur në kompleksin “Green Coast” në fshatin Palasë, Vlorë. Kjo pasuri rezulton të jetë porositur me kontratën e sipërmarrjes nr. 3100 rep. dhe nr. 1660 kol., datë 16.8.2018 nga shoqëria “Inerte Express” sh.p.k. me administrator M.B. e më pas, me kontratën nr. 1382 rep., dhe nr. 1010 kol., datë 13.4.2021, i ka kaluar të drejtat shtetases Elda Dinaj (*kërkuesja*).

3. Sipas prokurorisë, në kushtet kur nga hetimi ka rezultuar lidhja e ish-bashkëshortes së deputetit nën hetim me këtë pasuri, është krijuar dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se kjo është një pasuri e fshehur dhe objekt material i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 137 akti, datë 23.3.2023, ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive edhe për pasurinë e pretenduar nga kërkuësja, me qëllim që të pengohej çdo transferim i mundshëm i saj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuësja.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*), me urdhrin nr. 62, datë 26.4.2023, ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas asaj gjykate, kontrata e blerjes së vilës, si edhe pagesa e parë e kështit janë veprime për kalimin e pronësisë kërkuases dhe janë kryer në bashkëpunim me deputetin nën hetim dhe ish-bashkëshorten e tij, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjishme të kësaj pasurie. Ndaj këtij vendimi kërkuësja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se vendimet gjyqësore janë marrë në kundërshtim me ligjin procedural penal.



5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1310, datë 27.7.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se vendimet e gjykatave të posaçme janë marrë në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale, referuar kushteve të përcaktuara në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), zbatimi i së cilës është argumentuar mjaftueshëm nga gjykatat e posaçme.

6. Më datë 15.12.2023 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të kërkesës. Me vendimin e datës 5.2.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 8.2.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

7.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1 *Së drejtës për t'u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi përmbajtja e dispozitave procedurale që rregullojnë sekuestron preventive nuk ka parashikuar mënyrë të veçantë gjykimi, ndaj seanca gjyqësore e datës 23.3.2023 në GJKKO-në e Shkallës së Parë duhej të ishte zhvilluar duke respektuar procedurën e njoftimit dhe thirrjes së personave që mund të preken nga kërkitimi i prokurorit në të drejtat e tyre të pronësisë, si dhe t'u jepte mundësinë që paraprakisht të paraqisnin prova në mbrojtje të interesave të tyre. Sipas arsyetimit të urdhrit të GJKKO-së së Apelit gjykimi i kërkesave të prokurorisë për sekuestrimin e pasurive në procesin penal bëhet në dhomë këshillimi si në shkallë të parë dhe në apel, por kjo gjykatë nuk përcakton se cila dispozitë konkrete procedurale e parashikon kufizimin e personave të prekur për të qenë pjesëmarrës në seancë gjyqësore. Kjo gjykatë ka refuzuar të administrojë prova të mbrojtjes, duke aluduar për pamundësinë e marrjes së provave nga palët private. Gjykata e Lartë nuk duhej të kishte pranuar faktin që GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka

shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit. Vendimi i GJKKO-së së Apelit bie ndesh me praktikën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, pasi kjo gjykatë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel dhe ka rënduar pozitën e kërkuarës. Kjo gjykatë duhej të kufizohej në shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të gjykatës së shkallës së parë brenda shkaqeve të ankimit.

7.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e posaçme në lidhje me caktimin e masës së sigurimit pasuror kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme. Përpos faktit se nuk mund të ketë masë sigurimi pa pasur person nën hetim, masa e sigurimit pasuror nuk duhej vendosur duke paraqitur thjesht një shpjegim të normës penale në mënyrë abstrakte. GJKKO-ja e Apelit, në mungesë të plotë të arsyetimit, ka refuzuar të administrojë provat e paraqitura nga përfaqësuesi ligjor i kërkuarës, duke aluduar për pamundësinë e marrjes së provave nga palët private. Kjo gjykatë ka zhvilluar një gjykim tërësisht formal, të paragjykuar dhe në shkelje të parimeve bazë procedurale, çka e bën të papranueshëm arsyetimin përfundimtar. Gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuarës për të drejtën e pronësisë mbi sendin për të cilin është vendosur sekuestroja.

Po në këtë drejtim, gjykatat nuk kanë analizuar veprimtarinë konkrete të kërkuarës, problematikën e çështjes dhe tërësinë e provave. Gjykatat e posaçme kanë gabuar në aplikimin e ligjit, duke lejuar shkelje të rënda të të gjithë procedurës së parashikuar nga legjislacioni për vënien e masave pasurore në procedurën penale. Ndryshe nga sa pretendohet nga Prokuroria e Posaçme dhe sa është arsyetuar nga gjykatat, kërkesja nuk ka pasur dijeni për veprimtarinë e dyshuar si kriminale të ish-funksionarit dhe ish-bashkëshortes së tij. Ajo ka vepruar në mirëbesim kur ka hyrë në marrëdhënie kontraktore me shoqërinë "Inerte Express" sh.p.k. për blerjen e vilës. Gjykatat nuk kanë bërë analizë të provave në drejtim të evidentimit të origjinës së pronës dhe të të drejtave që kërkesja gëzon në lidhje me këtë pronë. Verifikimi i saktë i pronësisë së sendit merr rëndësi të veçantë në rastin konkret, pasi përveç deputetit nën hetim asnjë nga personat e tjerë të përfshirë nuk janë palë në procedimin penal ndaj tij.

7.2 *Së drejtës së pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi vendosja e sekuestros preventive ndaj pasurisë së kërkuarës përbën një ndërhyrje



joproporcionale dhe të papërligjur në të drejtën e saj të pronës, duke e privuar nga të gjitha tagrat dhe jo vetëm nga disponimi i sendit. Kjo pasuri nuk është produkt i mundshëm i ndonjë veprë penale, as krijon mundësi për vepra të tjera të mundshme apo shtim të pasojave penale. Në rastin konkret nuk është paraqitur një lidhje e qartë midis sendit të vendosur nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet. Objekti është ndërtuar në respektim të ligjit dhe pronësia e kërkuësës ka kaluar nëpërmjet një transaksioni të ligjshëm përpara noterit publik. Nga vendimet gjyqësore nuk rezulton që kontrata të ketë qenë fiktive ose me qëllim mashtrimin e ligjit, përkundrazi kërkuësja ka përmbushur detyrimet e saj. Prokuroria dhe në vijim gjykata e kanë vendosur kërkuësen *de facto* në pozitën e personit nën hetim, për pasojë vendimi i sekuestros preventive është një masë ekstreme për sa kohë kërkuësja disponon burime të ligjshme për blerjen e pasurisë dhe nuk ka asnjë komunikim me deputetin nën hetim. Masa e sekuestros është vendosur mbi supozime, sepse ish-bashkëshortja e këtij shtetasi është kujdesur për mobilimin e vilës. Organi i akuzës ka paraqitur në rrugë abstrakte mundësinë e konsumimit të veprës penale të korrupsionit pasiv apo pastrimit të produkteve të veprës penale, por nuk ka paraqitur një tablo të qartë për faktin se si kërkuësja mund të ketë lidhje me kryerjen e kësaj veprë penale në mënyrë direkte ose indirekte.

8. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

8.1 Kërkuësja nuk legjitimohet për kundërshtimin e masës së sekuestros, pasi pronari i sendit në atë kohë ka qenë subjekti “Green Coast” dhe e vetmja kontratë ligjshme e vlefshme është ajo midis këtij subjekti dhe shoqërisë “Inerte Express” dhe kjo e fundit nuk ka gëzuar titullin “pronar” në momentin e nënshkrimit të kontratës. Nga të gjitha të dhënat e administruara ngrihet dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se kërkuësja është thjesht një emër i vendosur për të fshehur pronarin e vërtetë të vilës nr. 73. Kërkuësja ka kundërshtuar vendimin e sekuestros kur jo vetëm nuk ka bërë pagesën e plotë, por nuk i ka kaluar as e drejta e pronësisë së vilës. Për më tepër, ajo ka kryer pagesë në një kohë që sendi është vendosur nën sekuestro.

8.2 Në lidhje me pretendimin për *cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së*

armëve dhe të kontradiktoritetit, sipas nenit 274 të KPP-së gjykata urdhëron sekuestrimin mbështetur në kërkesën e prokurorit. Duke qenë një masë sigurimi, që tipar kryesor të saj ka kufizimin e sendit, në mënyrë që në lidhje me këtë send të mos kryhen veprime të tjera, por të arrihet ngritja e tij në gjendjen fizike dhe juridike në të cilën ndodhet, elementi i befasisë është kryesori. Në rast se do të zhvillohet seanca në praninë e palës do të shkaktohet rreziku i transferimit të të drejtave për sendin të persona të tretë pa lidhje me aktivitetin kriminal. Kërkuësja është pyetur dhe është dëgjuar në lidhje me pretendimet e ngritura dhe në ndërthurje me provat e administruara pretendimet e saj kanë rezultuar të pabazuara. Asaj nuk i është mohuar aksesimi në gjykatë, pasi edhe pretendimet në lidhje me dorëzimin e provave, ato që ajo ka dashur të dorëzojë në apel, janë dorëzuar në vijim në organin procedues dhe nuk rezulton se ato kanë sjellë ndonjë ndryshim të situatës. Për më tepër, gjatë procesit penal gjykata administron vetëm provat e nevojshme.

8.3 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit*, gjykatat kanë analizuar momentet në të cilat kërkuësja pretendon se ka vendosur marrëdhënie kontraktore me pasurinë e paluajtshme në ndërthurje me atë çfarë ka rezultuar realisht nga hetimi, në lidhje me posedimin dhe personin që e ka poseduar atë, që rezulton të jetë ish-bashkëshortja e deputetit nën hetim. Marrëdhëniet e kërkuësës nuk mund të shihen në drejtim të sendit, por në drejtim të shoqërive “Inerte Express” dhe “Green Coast” dhe çuditërisht asnjëra prej tyre nuk ngre pretendime në lidhje me këtë send. Duhet të ishte shoqëria “Green Coast” që mund të ngrinte ndonjë pretendim, pasi rezulton se ende nuk është paguar për këtë send. Bindja e brendshme e gjyqtarit në arsyetimin e vendimit nuk mund të çojë *apriori* drejt pretendimeve për paanshmërinë e tij ose prezumimin e pafajësisë.

8.4 Pretendimi për cenimin e *së drejtës së pronës* në drejtim të faktit se nuk provohet një lidhje e qartë midis sendit të vendosur në sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet personi nën hetim është i pabazuar, duke pasur parasysh qoftë dhe vetëm faktin se kontrata është lidhur në një datë kur kërkuësja nuk ka qenë në Shqipëri. Sendi shfaqet i qartë në lidhje me veprat penale që dyshohet të kenë kryer deputeti nën hetim dhe ish-bashkëshortja e tij, pasi ka dyshime se është objekt konkret i përfituar



nga vepra penale e korrupsionit dhe për të cilin janë marrë të gjitha masat për të mbuluar këtë produkt, pronësinë e tij dhe mënyrën e fitimit të tij ose edhe shpenzimet e kryera në lidhje me investimet në këtë objekt. Pretendimi se vendosja e sekuestros preventive përbën një ndërhyrje të shpërpjesëtuar dhe të papërligjur në të drejtën e pronësisë, pasi gjykatat e kanë privuar nga të gjitha tagrat e pronësisë dhe jo vetëm nga disponimi i sendit (të cilin kërkuesja gjithsesi e kishte të pamundur për shkak të qenies së tij jashtë qarkullimit civil), është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, pretendohet se vila nuk ishte e regjistruar ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ndërsa, nga ana tjetër, ngrihen pretendime se nuk nevojitet sekuestrimi fizik i vilës, ndërkohë që mund të vendoset shënim në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Kërkuesja ka pretenduar se është privuar nga të gjitha tagrat e pronësisë, kur në të vërtetë ajo nuk i gëzon këto tagra, pasi, sikurse citohet në kontratën e lidhur mes shoqërisë “Inerte Express” dhe “Green Coast”, si dhe pas daljes së certifikatës në emër të shoqërisë “Inerte Express”, ajo, brenda 30 ditëve, do të nënshkruante kontratën përfundimtare me kërkuesen. Në situatën e mospagimit të çmimit të shitjes së plotë pronar i vilës vijon të jetë shoqëria “Green Coast”, ndaj nuk konstatohet se çfarë e drejte pronësie i është shkelur kërkueses.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata vëren se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, individ i është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet në aspektin procedural, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues. Edhe pse kërkuesja nuk rezulton të ketë regjistruar pasurinë e sekuestruar në emrin e saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ajo ka lidhur me shoqërinë “Inerte Express” kontratën për kalimin e të drejtave reale për atë send, kontratë e cila është në formën e kërkuar nga ligji, prandaj ajo legjitimohet edhe në aspektin substancial për atë pjesë të vendimit që ka disponuar për objektin që pretendon të drejta pronësie (vila në kompleksin “Green Coast”, Palasë, Vlorë). Gjithashtu, pavarësisht se gjatë procesit ka pasur dyshime në lidhje me pronësinë reale të këtij sendi, për sa kohë që këto dyshime nuk janë provuar me një vendim përfundimtar të formës së prerë, ato nuk janë të mjaftueshme për të vënë në dyshim interesin e drejtpërdrejtë të kërkueses në çështjen e parashtruar. Për këto arsye, pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuesja nuk legjitimohet, pasi pronari i këtij sendi në momentin e vendosjes së sekuestros është subjekti “Green Coast” dhe ajo nuk ka vërtetuar pronësinë e saj mbi sendin e paluajtshëm, është i pabazuar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesja ka pretenduar se ndonëse vendimi objekt kërkese nuk është vendim përfundimtar që zgjidh themelin e çështjes, për shkak të pasojave që ai sjell në të drejtat themelore të saj, duhet t’i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Sipas kërkueses, gjykimi i zhvilluar me nismë të çdo personi të tretë, i cili nuk është person nën hetim, për të mbrojtur të drejtën e pronësisë nga masa e sekuestros, ka tiparet e gjykimit të themelit, prandaj në lidhje me të drejtën e pronësisë ai është përfundimtar.



12. Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individit ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret Gjykata vëren se objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit me të cilat është vendosur masa e sekuestros preventive për pasurinë e paluajtshme, vilën e ndodhur në fshatin Palasë, Vlorë. Edhe pse Gjykata nuk e ka vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të këtyre lloj vendimesh, së fundmi ajo i ka përfshirë në juridiksionin e saj me arsyetimin se përjashtimi i vendimeve të caktimit të masës së sekuestros nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të mbrojtjes së të drejtave substanciale të individit, ndërkohë që ankimi kushtetues individual synon të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit (*shih vendimin nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të këtij qëndrimi, Gjykata çmon se vendimi i caktimit të sekuestros, ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendos për themelin e çështjes, ndërhyr në të drejtat kushtetuese individuale, siç është ajo e pronës dhe kjo ndërhyrje vazhdon deri në dhënien e një vendimi të mundshëm për konfiskimin e pasurisë. Për rrjedhojë, ai konsiderohet me natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues, për sa kohë pretendimet ndaj këtij vendimi kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave substanciale kushtetuese. Në këtë kuptim, në rastin konkret, kërkesja i ka shteruar pretendimet e saj në formë dhe substancë përpara gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë ajo e ka përmbyllur edhe këtë kriter legjitimitimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të

së drejtës. Gjykata ka vlerësuar se data e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë ajo konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.7.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur më datë 15.12.2023. Bashkëlidhur kërkesës përfaqësuesi ligjor i kërkesës ka paraqitur shkresën nr. 6287/1 prot., datë 5.12.2023 të Gjykatës së Lartë, përmes së cilës rezulton se vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare më datë 18.10.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Për rrjedhojë, duke konsideruar këtë të fundit si data nga e cila ka filluar afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, kërkesja legjitimohet *ratione temporis*.

17. Për sa i takon legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ashtu edhe cenimin e së drejtës së pronës. Gjykata, duke pasur në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila i ka trajtuar vendimet e sekuesttrimit kryesisht në këndvështrim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, ka theksuar se, në të tilla raste, ajo mund të ndalet rast pas rasti edhe në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimin nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të trajtojë aspektet e tjera procedurale të lidhura me të drejtën për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, por do t’i trajtojë ato



si aspekte procedurale të së drejtës së pronës së garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë pretendimet e kërkuases në drejtëm të së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së pronës

18. Sipas kërkuases, vendosja e sekuestros preventive përbën ndërhyrje joproporcionale dhe të papërligjur në të drejtën e saj të pronës, duke u privuar kështu nga të gjitha tagrat dhe jo vetëm nga disponimi i sendit. Kjo pasuri nuk është produkt i mundshëm i ndonjë veprë penale, as krijon mundësi për vepra të tjera të mundshme apo shtim të pasojave penale dhe nuk është paraqitur një lidhje e qartë midis sendit të vendosur nën sekuestro dhe veprës penale për të cilën po hetohet. Objekti në fjalë është ndërtuar në respektim të ligjit dhe pronësia e kërkuases ka kaluar nëpërmjet një transaksioni të ligjshëm përpara noterit publik dhe nga vendimet gjyqësore nuk rezulton që kontrata të ketë qenë fiktive apo me qëllim mashtrimin e ligjit, përkundrazi kërkuësja ka përmbushur detyrimet e saj. Prokuroria dhe në vijim gjykata e kanë vendosur kërkuesen *de facto* në pozitat e personit nën hetim, për pasojë vendimi i sekuestros preventive është një masë ekstreme, për sa kohë kërkuësja disponon burime të ligjshme për blerjen e pasurisë dhe nuk ka asnjë komunikim me deputetin nën hetim. Masa e sekuestros është vendosur mbi supozime, sepse ish-bashkëshortja e deputetit nën hetim është kujdesur për mobilimin e vilës. Gjykatat e posaçme në lidhje me caktimin e masës së sigurimit pasuror kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit kryesor të kërkuases për të drejtën e pronësisë mbi sendin që është vendosur sekuestroja.

19. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimi i kërkuases është kontradiktor, pasi, nga njëra anë pretendohet se vila nuk ishte e regjistruar ende në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ndërsa, nga ana tjetër, ngrihen pretendime përse është proceduar me sekuestrimin fizik të vilës, pasi mund të vendosej shënim në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Sipas këtij subjekti, kërkuësja pretendon se është privuar nga të gjitha tagrat e pronësisë kur në të vërtetë ajo nuk i gëzon këto tagra, pasi, siç citohet në kontratën e lidhur mes shoqërive “Inerte Express” dhe “Green

Coast”, si dhe pas daljes së certifikatës në emër të shoqërisë “Inerte Express”, brenda 30 ditëve kjo e fundit do të nënshkruante kontratën përfundimtare me kërkuesen. Subjekti i interesuar ka parashtruar edhe se pronar i vilës rezulton të jetë ende shoqëria “Green Coast”, si dhe ajo është gëzuar nga ish-bashkëshortja e deputetit nën hetim, për rrjedhojë nuk konstatohet se çfarë e drejte pronësie i është shkelur kërkuases.

20. Gjykata ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas nenit 41 të Kushtetutës, e drejta e pronës private është e garantuar dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik. E drejta e pronës përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Megjithatë, me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat duhen bërë sipas disa kriterëve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës. Edhe sipas nenit 41 të Kushtetutës e drejta e pronës mund të kufizohet, duke përcaktuar si kriter garantues të këtij kufizimi interesin publik (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive edhe për pasurinë e paluajtshme të pretenduar nga kërkuësja, me arsyetimin se me kontratën e kalimit të të drejtave dhe detyrimeve nr. 1382. rep., dhe nr. 1010 kol., datë 13.4.2021 shoqëria “Inerte Express”, e përfaqësuar nga M.B., i ka transferuar kërkuases të drejtat reale mbi këtë pasuri, me sipërfaqe të përgjithshme 177.1 m² dhe sipërfaqe parcele 482.7 m². Sipas kësaj kontrate, në përfundim të punimeve të vilës dhe pas lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes mes shoqërive “Inerte Express” dhe “Green Coast”, si dhe pas daljes së certifikatës në emër të shoqërisë “Inerte Express”, brenda 30 ditëve kjo e fundit do të nënshkruante kontratën përfundimtare me kërkuesen. Vlera e shitjes është 300,000 euro, e cila do të likuidohet me këste në llogarinë bankare të palës shitëse brenda 1 viti nga data e nënshkrimit të



kontratës. Sipas gjykatës, referuar të dhënave të sistemit TIMS, rezulton se kërkuësja ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe, gjithashtu, shoqëria “Inerte Express” ka vendosur të shesë vilën në fjalë në një shumë prej 87,731 eurosh më pak nga ajo që e ka marrë (*shih paragrafin 92 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Në përfundim, gjykata ka vlerësuar se kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për vendosjen e sekuestros preventive është e bazuar në ligj dhe në prova, pasi ekziston dyshimi i arsyeshëm se kjo pasuri është pasuri e fshehur dhe se është vendosur me të ardhura nga burime të paligjshme. Sipas asaj gjykate, ekziston dyshimi se për këtë pasuri mund të merren masa me qëllim tjetërsimin e saj, ndaj duhet vendosur masa e sekuestros preventive me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm i pasurisë së paluajtshme (*shih paragrafin 108 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

22. Për ankimin e kërkuësës GJKKO-ja e Apelit ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se kontrata e blerjes së vilës në fshatin Palasë, Vlorë, si edhe pagesa e parë e kështit janë veprime për kalimin e pronësisë kërkuësës, të kryera në bashkëpunim me deputetin nën hetim dhe ish-bashkëshorten e tij për fshehje ose mbulim të origjinës së paligjshme të kësaj pasurie. Sipas asaj gjykate, krijohet dyshimi i arsyeshëm se deputeti ka pastruar produktin e veprës penale të korrupsionit për këtë pasuri të paluajtshme nëpërmjet transferimit ose zhvendosjes së të drejtave në lidhje me pasurinë, me qëllim fshehjen dhe mbulimin e origjinës së paligjshme të saj dhe se këto vepra penale janë kryer në bashkëpunim me së paku tre persona me marrëveshje ndërmjet tyre. Ai shtetas dyshohet se i ka kryer veprat penale për të realizuar përfitim material ose jomaterial, siç parashikon pika 4 e nenit 28 të KP-së dhe se bashkëpunimi dyshohet se është i paramenduar dhe i parallogaritur, pra nuk është formuar rastësisht (*shih faqet 20–21 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Kundër këtij vendimi kërkuësja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

23. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-1310, datë 27.7.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësja, me arsyetimin se vendimet e gjykatave të posaçme janë marrë në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale penale, për sa u përket kushteve të përcaktuara në nenin 274 të KPP-së, dhe se zbatimi i kësaj dispozite është

argumentuar mjaftueshëm prej tyre. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat kanë vlerësuar se disponimi i lirë i sendeve, i lidhur ngushtësisht me veprat penale të korrupsionit, krijon lehtësira për kryerjen e veprës tjetër penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe ekziston dyshimi se për këto pasuri mund të merren masa me qëllim tjetërsimin e tyre, ndaj vendosja e masës së sekuestros preventive ka si qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm (*shih paragrafin 30 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po sipas Kolegjit Penal, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka bërë një arsyetim korrekt, duke iu përmbajtur objektit të kërkesës së paraqitur nga prokurori, ndërsa GJKKO-ja e Apelit në shqyrtimin e ankimit nuk ka pasur parasysh kërkesat e nenit 425/1 të KPP-së. Pavarësisht se nuk pajtohet me një pjesë të arsyetimit të GJKKO-së së Apelit, e cila ka akuzuar persona të tretë, emrat e të cilëve nuk rezultojnë të jenë regjistruar sipas nenit 287 të KPP-së dhe nuk kanë qenë palë në këtë proces penal, Kolegji Penal ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga kërkuësja nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së (*shih paragrafet 33-36 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

24. Gjykata ka theksuar se e drejta e pronës përfshin tre garanci që duhet të zbatohen në shqyrtimin e pretendimeve për cenimin e saj: *garancia e parë* ka të bëjë me parimin e gëzimit të qetë të pronës, e cila ka natyrë të përgjithshme; *garancia e dytë* ka të bëjë me kufizimet e lejueshme për të drejtën e pronës; *garancia e tretë* ka të bëjë me të drejtën e autoriteteve publike për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Sekuestrimi i pasurisë në kuadër të procedurave ligjore zakonisht lidhet me kontrollin e përdorimit të pronës dhe jo me privimin e saj (*shih vendimet nr. 18, datë 19.3.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se kontrolli i përdorimit të pasurisë nga autoritetet publike duhet të jetë i ligjshëm, në kuptimin që të jetë vendosur me ligj dhe të ndjekë një qëllim të ligjshëm, në kuptim të interesit publik. Po kështu, ndërhyrja duhet të vendosë një “ekuilibër të drejtë” midis kërkesave të interesit të përgjithshëm dhe garancive për mbrojtjen e së drejtës së pronës. Midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti. Ekziston një hapësirë e gjerë vlerësimi për autoritetet publike në lidhje me zgjedhjen e mjeteve



dhe atë çfarë konsiderohet në interes të përgjithshëm, me përjashtim të rasteve kur vendimi është haptazi i paarsyeshëm. Ndërsa pranohet dyshimi i arsyeshëm në fillim të hetimeve penale si bazë për ndërhyrje në të drejtën e pronës, hetimet duhet të jenë të shpejta, në mënyrë që ndërhyrja të zgjasë për një kohë të kufizuar. Masat e përkohshme të vendosura në kuadër të procedurave gjyqësore, të cilat i paraprijnë një konfiskimi të mundshëm, mund të shkaktojnë dëmtim të pronës, por në mënyrë që dëmi të jetë në përputhje me garancitë e lartpërmendura, ai nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme (*shih vendimin nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Sikurse ka pohuar në jurisprudencën e saj, për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke zbatuar standardet e mësipërme në rastin konkret në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimet gjyqësore të cilat kanë pranuar kërkesën e prokurorit për caktimin e masës së sekuestros preventive kanë vendosur një ndalim të përkohshëm në të drejtën e kërkuarës për gëzimin e pasurisë së paluajtshme, konkretisht pasurinë vilë, mbi të cilën, bazuar në kontratën noteriale, shoqëria “Inerte Express” i ka transferuar të drejta reale kërkuarës dhe se ka rezultuar e provuar se ka paguar edhe një pjesë të çmimit. Edhe pse kërkuarja nuk rezulton ta ketë regjistruar këtë pasuri në emrin e saj në regjistrin e pasurive të paluajtshme, kjo nuk përbën shkak për të mos gëzuar të drejtat që i burojnë nga një kontratë e lidhur sipas qëllimit dhe formës së kërkuar nga ligji. Për rrjedhojë, për sa kohë që provohet se ka ardhur një kufizim në të drejtat e kërkuarës, do të vlerësohet në vijim nëse ai plotëson kriteret kushtetuese të ndërhyrjes, pra nëse është bërë vetëm me ligj, për interes publik ose për arsye të rëndësishme publike dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit.

27. Gjykata konstaton se masa e sekuestros është vendosur në kuadër të procedimit penal të filluar për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose i të zgjedhurve vendorë” dhe është bazuar në parashikimet e nenit 274 të KPP-së, i cili lejon sekuestrimin e sendit kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj apo të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Në këtë mënyrë,

Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtën e pronës është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik. Lidhur me këtë të fundit, Gjykata risjell në vëmendje se rregullat procedurale penale që lejojnë sekuestrimin e pasurisë i shërbejnë mbarëvajtjes së procedimit penal, në kuptimin e ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, ndaj interesi publik është i prezumuar.

28. Për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis sekuestros dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, çmon të marrë në analizë disa elemente që lidhen drejtpërdrejt me natyrën e pasojave që prodhon vendimi për vendosjen e masës së sekuestros, në kuptim të balancimit të të drejtave ndërmjet interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Në këtë kontekst dhe në bazë të parimit të subsidiaritetit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, që përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se Gjykata duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Për këtë qëllim, Gjykata do të ndalet në vlerësimin e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë së masës së sekuestros, duke mbajtur në konsideratë shpejtësinë e procedurave, pra që ndërhyrja në të drejtën e pronës të zgjasë për një kohë të kufizuar, si dhe dëmin që vjen nga cenimi, i cili nuk duhet të jetë përtej asaj që është e pashmangshme.

29. Lidhur me nevojën e ndërhyrjes, Gjykata analizon nëse masa e marrë është e aftë të realizojë pasojën që ajo synon, pra të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal në kuadër të të cilit është marrë. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ndonëse pasuria nuk ishte ende e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të kërkuarës, kontrata e lidhur prej saj ka sjellë premisa për ushtrimin e tagrit të së drejtës së gëzimit të sendit, si pjesë e së drejtës së pronës. Megjithatë, sikurse ka prapësuar subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, kërkuarja nuk e ka gëzuar efektivisht asnjëherë sendin dhe, për më tepër, ajo nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të provonte se ka ushtruar të drejta të gëzimit mbi të, të cilat janë ndërprerë për shkak të vendosjes së masës së sekuestros preventive. Gjithashtu, sikurse rezulton nga vendimet gjyqësore, ekziston një



dyschim i arsyeshëm se kjo pasuri është vendosur me të ardhura nga burime të paligjshme dhe se nuk është pasuri e kërkueses, por një pasuri e fshehur e deputetit nën hetim dhe ish-bashkëshortes së tij. Duke qenë se ekziston rreziku i tjetërsimit të kësaj pasurie, vendosja e masës së sekuestros preventive është bërë me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm deri në përfundimin e procesit penal në kuadër të të cilit është marrë kjo masë.

30. Lidhur me përshtatshmërinë e masës, në vlerësimin e Gjykatës masa e sekuestros duhet të jetë e arsyeshme, duke balancuar qëllimin e procedimit penal me interesat e individit të përfshirë, në kuptimin që ajo nuk duhet të caktohet përtej asaj që është e pashmangshme. Gjykata, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore në të cilat arsyetohet se ka dyshime të arsyeshme se vila është një pasuri e fshehur dhe është objekt material i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, vlerëson se kjo masë është e përshtatshme dhe jo përtej asaj që është e pashmangshme. Ndërkohë nuk rezulton që kërkuesja të ketë kundërshtuar kohëzgjatjen e procedurave, prandaj Gjykata nuk do të ndalet për këtë kriter.

31. Lidhur me ashpërsinë e masës së sekuestros, Gjykata vlerëson se ajo analizohet në raport me të tria tagrat e së drejtës së pronës, përkatësisht: posedimin, gëzimin (ku përfshihet edhe gëzimi i fryteve të pronës ose zhvillimi i saj) dhe disponimin. Gjykata thekson se në çdo rast vendimet për caktimin e masës së sekuestros duhet të përcaktojnë se cilin tagër të së drejtës së pronësisë do të prekin përtej disponimit të lirë të sendit, rreziku për ndodhinë e të cilit duket të jetë synimi kryesor dhe i shprehur i nenit 274 të KPP-së. Në këtë drejtim masa e sekuestros është e lidhur me objektivin që konsiston në parandalimin e pasojave të mëtejshme të veprës penale.

32. Në rastin konkret, edhe pse masa e sekuestros kufizon të drejtat reale të kërkueses për pasurinë e paluajtshme Gjykata, mban në vëmendje faktin se pasuria ndaj së cilës është vendosur masa e sekuestros nuk përdoret nga kërkuesja për të përmbushur nevojat e strehimit të saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka arritur të provojë masën e dëmit që i shkaktohet nga sekuestrimi, si dhe rrezikun real dhe të drejtpërdrejtë

që mbetet nga sekuestrimi i pronës së paluajtshme, pra në drejtim të ashpërsisë së masës nuk ka argumentuar që masa e sekuestros preventive është e tillë që të vendosë në dyshim proporcionalitetin e saj. Edhe pse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë arsyetuar në lidhje me proporcionalitetin e masës së sekuestros së vendosur ndaj kërkueses, barra e provës i takonte kësaj të fundit për të vërtetuar se masa e vendosur, në këndvështrim të natyrës së veprës penale, është e ashpër në atë masë që tejkalon kriterin e proporcionalitetit të ndërhyrjes.

33. Në përmbledhje të sa më sipër, Gjykata vlerëson se masa e sekuestros preventive: (i) e justifikon nevojën e ndërhyrjes, sepse synon të pengojë çdo transferim të mundshëm të pasurisë me qëllim që të sigurojë mbarëvajtjen e procedimit penal; (ii) është e përshtatshme se mbetet një mjet me natyrë të përkohshme që balancon në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme qëllimin e procedimit penal me interesat e kërkueses; (iii) nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet, sepse kufizimi i së drejtës së kërkueses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë e saj vendoset përballë objektivit për parandalimin e kryerjes së mëtejshme të veprës penale. Për këto arsye, Gjykata çmon se midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së kërkueses për të gëzuar dhe poseduar pasurinë e saj është në raport të drejtë me gjendjen që ka diktuar nxjerrjen e tij.

34. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së pronës janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,⁴

⁴ Gjyqtarët Elsa Toska, Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për rrëzimin e kërkesës me të njëjtën linjë

argumentimi të shprehur në mendimet paralele të vendimit nr. 18, datë 19.3.2024.



VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 16.4.2024.

Shpallur, më 16.5.2024.

Kryetar: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Ilir Toska

Anëtare kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses Elda Dinaj, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 137, datë 23.3.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrin nr. 62, datë 26.4.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2023-1310, datë 27.7.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ndaj, në vijim, do të parashtroj argumentet që mbështesin qëndrimin tim në këtë çështje.

2. Nga shqyrtimi kushtetues i çështjes rezulton se në kuadër të një procedimi penal ndaj një deputeti të dyshuar për kryerjen e disa veprave penale, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sekuestros preventive për dy pasuri të paluajtshme. Një ndër këto pasuri rezulton se është porositur nga shoqëria “Inerte Express” sh.p.k. e më pas me kontratën noteriale të kalimit të të drejtave dhe detyrimeve të datës 13.4.2021 i ka transferuar të drejta reale për pasurinë kërkueses Elda Dinaj. Prokuroria ka krijuar dyshime të arsyeshme se prona është një pasuri e fshehur dhe objekt material i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprave penale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur caktimin e masës së sekuestros preventive edhe për pasurinë e pretenduar nga kërkuësja, me qëllim që të pengohet çdo transferim i mundshëm i saj, vendim i cili është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit. Kërkuësja ka paraqitur rekurs kundër këtij vendimi, për të cilin Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se ai nuk

përbante shkaqet e përcaktuara në nenin 274 të KPP-së.

3. Në vijim, kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës së pronës. Për këtë të fundit kërkuësja ka pretenduar se vendosja e sekuestros preventive përbën një ndërhyrje joproporcionale dhe të papërligjur në të drejtën e saj të pronës, duke u privuar nga të gjitha tagrat dhe jo vetëm nga disponimi i sendit dhe se kjo masë është vendosur mbi supozime (*shih paragrafin 7.2 të vendimit*), duke mos u arritur të provohet lidhja me veprën penale të hetuar.

4. Shumica, në këndvështrim edhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, për vendimet e sekuestrimit ka vendosur t’i trajtojë pretendimet e kërkueses vetëm në drejtim të së drejtës së pronës, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (*shih paragrafin 17 të vendimit*). Ajo ka arsyetuar se ndonëse rezulton se pasuria nuk është regjistruar në emrin e kërkueses në regjistrin e pasurive të paluajtshme, kjo nuk përbën shkak për të mos gëzuar të drejtat që i burojnë nga një kontratë e lidhur sipas qëllimit dhe formës së kërkuar nga ligji dhe, për rrjedhojë, ka vijuar me analizimin e kriterëve kushtetues të ndërhyrjes, pra nëse është bërë vetëm me ligj, për interes publik, ose për arsye të rëndësishme publike dhe nëse respekton kriterin e proporcionalitetit (*shih paragrafin 26 të vendimit*). Sipas shumicës, masa e sekuestros preventive përmbush dy kriteret e para, pasi është bërë me ligj dhe i përgjigjet një interesi publik (*shih paragrafin 27 të vendimit*). Edhe për sa i përket kriterit të proporcionalitetit, shumica ka arritur në përfundimin se e justifikon nevojën e ndërhyrjes, është e përshtatshme dhe nuk është më e ashpër se sa objektivi që kërkohet të arrihet (*shih paragrafin 33 të vendimit*).

5. Përkundër vlerësimit të shumicës, ndonëse bashkohem me analizën e dy kriterëve të para të ndërhyrjes në të drejtën e pronës, se është bërë me ligj dhe për interes publik, ndaj qëndrim ndryshe, për sa i përket proporcionalitetit të masës së sekuestros, në rastin konkret.

6. GJEDNJ-ja ka pohuar se në rastin e vendimeve të caktimit të masave të sekuestros ose



konfiskimit për pasurinë e personave të tretë, të cilët nuk janë pjesë e procedimit penal, për të përcaktuar ekuilibrin midis qëllimit të ligjshëm dhe të drejtave themelore të kërkuesit, ekuilibri i drejtë varet nga shumë faktorë, ndër të cilët edhe sjellja e individit që ka të drejtën e pronës. Prandaj, gjykatave u lind detyrimi për të përcaktuar shkallën e fajit ose kujdesit që ka pasur kërkuesi ose, të paktën, marrëdhënien midis sjelljes së tij dhe veprave penale të kryera (*shih Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 24.10.1986, § 54; Silickiene kundër Lituanisë, datë 10.4.2012, §66*).

7. *Së pari*, çmoj se gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë në mënyrë shteruese të gjitha elementet e dyshimit të arsyeshëm, që konsiderohet i domosdoshëm për vendosjen e masës së sekuestros, në kushtet kur ajo kërkohet për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. Për shkak të natyrës së veprës penale, hetimi paraqet karakteristika të veçanta, pasi pasuria e cila dyshohet se është produkt i kësaj vepre, nuk është menjëherë e identifikueshme. Ndonëse është me rëndësi thelbësore lufta kundër këtyre veprave penale, të cilat dëmtojnë interesat shtetërore dhe sistemin financiar, autoriteteve publike u lind detyrimi për të realizuar një hetim të drejtë dhe të thelluar në mënyrë që të mos cenohen të drejta substanciale të individëve të tretë të cilët nuk janë të përfshirë në aktivitete të paligjshme dhe kanë vepruar *bona fide*.

8. Në këtë drejtim, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të gabuar, ka vlerësuar se kërkuesja nuk konsiderohet pronare e pasurisë dhe ajo nuk e ka gëzuar titullin pronar në momentin e nënshkrimit të kontratës. Në analizë të fakteve dhe dokumenteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton se kërkuesja ka lidhur një kontratë noteriale për kalimin e të drejtave me shoqërinë “Inerte Express”, çka nënkupton se ai është momenti kur, bazuar në dispozitat e kësaj kontrate, asaj i lind edhe e drejta e gëzimit dhe disponimit të pronës, ndonëse ende nuk ka kaluar pronësia mbi sendin. Në vlerësimin tim, gjykatat e posaçme nuk kanë bërë një verifikim të plotë të tagrave që gëzonte kërkuesja për pronën për të cilën është vendosur sekuestroja dhe nuk kanë analizuar nëse veprimet e saj janë kryer ose jo në mirëbesim.

9. *Së dyti*, vlerësoj se masa e sekuestros për pasurinë e kërkueses e tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi ndalimi tërësor i tagrave që ajo ka për pasurinë, pra disponimi dhe gëzimi i janë kufizuar tërësisht

nëpërmjet vendosjes së kësaj mase. Edhe parashikimi i nenit 274 të KPP-së kërkon ndalimin e disponimit të lirë të një sendi në rast se ai mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera. Në kushtet kur sendi mbi të cilin është vendosur sekuestro preventive ishte jashtë qarkullimit civil, pasi ende nuk ishte regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme, nuk arrin të provohet se disponimi i lirë i tij do të sillte pasoja.

10. Sikurse ka pranuar edhe shumica, gjykatat nuk kanë arsyetuar në lidhje me proporcionalitetin e masës së sekuestros së vendosur ndaj kërkueses, ndonëse ky detyrim u lind për shkak të natyrës së gjykimit të juridiksionit të zakonshëm, i cili bazohet në prova dhe fakte konkrete (*shih paragrafin 32 të vendimit*). Gjithashtu, në këtë drejtim, gjykatat nuk kanë arsyetuar as se përse masa e sekuestros konsiderohet si masa e vetme për mbarëvajtjen e procesit penal, në kushtet kur ekzistojnë edhe masa të tjera më të lehta, të cilat do t'i mundësonin asaj gëzimin e disa tagrave të pronës, duke siguruar njëkohësisht edhe zhvillimin e procesit penal të themelit, por janë mjaftuar vetëm me një arsyetim formal të kushteve dhe kriterëve për vendosjen e masës së sekuestros. Në këndvështrim të kriterit të proporcionalitetit, gjykatat e posaçme mund të urdhëronin bllokimin e të gjitha veprimeve juridike për pasurinë, për sa i përket tjetërsimit të persona të tretë, por duke lejuar disponimin efektivisht ose gëzimin e sendit deri në përfundimin e procesit penal.

11. Nën dritën e argumenteve të mësipërme, vlerësoj se masa e sekuestros preventive për pasurinë e kërkueses nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit, pasi ajo është një masë e ashpër dhe gjykatat nuk kanë arritur të arsyetojnë se përse në rastin konkret mbizotëron interesi për mbarëvajtjen e procesit penal përkundërt atij të kërkueses.

12. Në përfundim, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se pretendimet e kërkueses në drejtim të së drejtës së pronës janë të bazuara, prandaj duhej të ishte vendosur pranimi i kërkesës.

Anëtare: Sonila Bejtja



VENDIM
Nr. 30, datë 18.4.2024
NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 18.4.2024
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 1 (O) 2023, që u përket:

KËRKUES: Odise Xhelita

SUBJEKT I INTERESUAR:

Banka e Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim
nga juristët Genci Ndrija dhe Kristi Mezini.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2023-
705 (85), datë 7.3.2023, të Kolegjit Administrativ të
Gjykatës së Lartë; nr. 11, datë 17.7.2014, të Gjykatës
Administrative të Apelit, si të papajtueshme me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 131, pika 1, shkronja
“P”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
(*Kushtetuta*); nenet 71 dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë
10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida
Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e
kërkuesit Odise Xhelita, i cili ka kërkuar pranimin e
kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar,
Bankës së Shqipërisë, që ka kërkuar rrëzimin e
kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe një shtetase tjetër, në cilësinë e
kredimarrësve, më datë 22.7.2010 kanë lidhur

kontratën e kredisë me Bankën Kombëtare Greke,
dega Tiranë, në cilësinë e kredidhënësit, për shumën
29.300 euro me afat 25 vjet, me qëllim blerjen e një
apartamenti. Në vitin 2011 Banka Kombëtare
Greke, dega Tiranë, ka themeluar filialin e ri me
emrin Banka NBG, transaksionet e së cilës prej
datës 6.6.2018 i kanë kaluar Bankës Amerikane të
Investimeve.

2. Më datë 11.9.2013 kërkuesi i është drejtuar
Bankës NBG me kërkesë për shlyerjen e
parakohshme të kredisë. Me shkresën e datës
18.9.2013, ajo bankë e ka informuar kërkuesin se
detyrimi i mbetur deri në këtë datë ishte në vlerën
29.864,16 euro, ku përfshihej principali i mbetur
(28.182,48 euro), kësti në vonesë (250,95 euro),
penaliteti 5 % në rast shlyerjeje përpara kohe
(1.409,12 euro) dhe interesi i akumuluar (21,61
euro). Në vijim, kërkuesi ka depozituar shumën
29.864,16 euro në llogarinë bankare të hapur për
qëllim të kredisë, duke shlyer kredinë përpara afatit
të përcaktuar në kontratë.

3. Kërkuesi i është drejtuar disa herë Bankës
NBG për ta informuar zyrtarisht për përfundimin e
kontratës së kredisë përpara maturimit dhe
reduktimin e kostos totale të saj, duke kërkuar uljen
e interesave dhe kostove të aplikuara për pjesën e
pashlyer të kredisë, për periudhën e mbetur sipas
kontratës; uljen e penaliteteve për shlyerjen e
parakohshme të kredisë dhe për mosndryshim
kolateral; uljen e shpenzimeve për sigurimin e jetës
dhe pronës për periudhën pas shlyerjes së detyrimit.
Sipas kërkuesit, nga 25 vjet që ishte afati fillestar,
kredia është shlyer në mënyrë të parakohshme në 3
vjet e 2 muaj, ndërkohë që kostot janë paguar
referuar periudhës fillestare 25 vjet, përfshirë vlerën
e shpërpjesëtuar të penalitetit prej 5 % për shlyerjen
përpara kohe të pjesës së mbetur të kredisë.

4. Për shkak të refuzimit të kërkesës për
reduktimin e kostove kërkuesi i është drejtuar
Bankës së Shqipërisë me kërkesë për të ndërhyrë
nëpërmjet veprimeve korrigjuese ndaj veprimeve në
kundërvajtje të Bankës NBG. Banka e Shqipërisë,
me shkresën e datës 17.1.2014, ka informuar
kërkuesin, ndër të tjera, se, referuar nenit 31 të ligjit
nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në
Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr.*
9662/2006), rishikimi i kushteve të kontratës në
rastet e shlyerjes së parakohshme të kredisë është e
drejtë e bankës tregtare që e ka dhënë atë dhe se
kredia për të cilën kishte aplikuar klasifikojë si kredi



hipotekare dhe jo konsumatore. Po kështu, sipas përgjigjes së Bankës së Shqipërisë, shpenzimet për sigurimin e jetës dhe të pronës ishin reduktuar, pasi kërkesit i ishte kthyer primi i policës së sigurimit më datë 6.12.2013, bazuar në kërkesën e bankës kredidhënëse drejtuar shoqërisë së sigurimit.

5. Më datë 29.1.2014, kërkesi i është drejtuar Bankës së Shqipërisë me ankesë ndaj shkresës së saj të datës 17.1.2014. Nga materialet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që Banka e Shqipërisë të jetë shprehur për këtë ankesë. Ndërsa më datë 12.3.2014, kërkesi i ka paraqitur Bankës së Shqipërisë kërkesë për pajisje me dokumentacion, konkretisht kopje të vërtetuara të të gjithë praktikës së administruar në lidhje me procedimin administrativ të nisur nga kredimarrësit, duke përfshirë, në veçanti, aktet dhe dokumentacionin e inspektimit të kryer.

6. Në përgjigje të kërkesës për pajisje me dokumentacion, Banka e Shqipërisë, me shkresën e datës 25.3.2014, ka informuar kërkesin se konkluzionet e procesit mbikëqyrës të ushtruar ndaj Bankës NGB i janë vënë në dispozicion me shkresën e datës 17.1.2014, ndërsa komunikimet mes Bankës së Shqipërisë dhe bankës përkatëse kanë karakter konfidencial dhe nuk mund t'u vihen në dispozicion personave që nuk e gëzojnë këtë të drejtë me ligj.

7. Në këto rrethana, kërkesi ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit, me objekt detyrimin e Bankës së Shqipërisë që në ushtrim të funksionit të saj të kryejë veprimin administrativ të realizimit të procesit të mbikëqyrjes në lidhje me kontratën e kredisë së tij nëpërmjet kryerjes së inspektimit të plotë të Bankës NGB, konstatimit të veprimeve në kundërvajtje, si dhe të kryerjes së veprimeve korrigjuese, duke marrë masat përkatëse në përfundim të këtij procesi, si dhe detyrimin për ta pajisur me informacionin dhe dokumentet e përdorura në procedurën e mbikëqyrjes.

8. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 11, datë 17.7.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkesi më datë 18.8.2014, ndërsa më datë 29.9.2014 ka paraqitur kundërrekurs Banka e Shqipërisë. Më datë 31.8.2021, kërkesi ka paraqitur shtesë rekursi. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit.

9. Më datë 11.2.2022, kërkesi i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese

(Gjykata) për shfuqizimin e vendimit të mospranimin të rekursit të Gjykatës së Lartë. Gjykata, pas shqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 19, datë 7.7.2022 (*vendimi nr. 19/2022*), ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2021-1362, datë 16.9.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë kolegji. Pas dhënies së këtij vendimi, kërkesi i është drejtuar përsëri Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e pjesës hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit nr. 19/2022 të Gjykatës. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 127, datë 10.10.2022, (*vendimi nr. 127/2022*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pas rishqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 00-2023-705 (85), datë 7.3.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 11, datë 17.7.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

11. Më datë 18.9.2023, kërkesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, më datë 22.11.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale* përmes një *procesi të parregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

12.1 *Të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është përbërë nga gjyqtarë të pacaktuar me short. Gjyqtari që ka zëvendësuar gjyqtarin e dorëhequr është caktuar po ashtu pa short dhe në caktimin e gjyqtarëve pa short ka marrë pjesë këshilltari ligjor, në kundërshtim me detyrat funksionale të tij.

12.2 *Të drejtën e gjykimin nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi gjyqtari relator në Gjykatën e Lartë ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve pa studiuar dosjen gjyqësore. Gjyqtari relator, me pakujdesi të rëndë, ka kryer vetëm njoftim individual postar pa pasur qëllim ta njoftonte realisht kërkesin. Gjykata e Lartë e ka nisur njoftimin 6 ditë përpara seancës, ndonëse afati ligjor është të paktën 15 ditë. Gjykata



e Lartë e ka përshpejtuar shqyrtimin e çështjes për shkaqe të pabazuara dhe për të marrë një vendim të paracaktuar. Për çështjen janë kryer të paktën 20 veprime procedurale në kushtet e mungesës së transparencës dhe të painventarizuara në dosje. Gjykata e Lartë nuk ka paraqitur saktë rrethanat e çështjes, që tregon njëanshmërinë e saj.

12.3 *Parimin e sigurisë juridike, të drejtën për t'u dëgjuar, aksesin në drejtësi dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë, në kundërshtim me detyrën e lënë nga Gjykata, nuk e ka shqyrtuar shtesën e rekursit të datës 31.8.2021, ku ishte ngritur pretendimi për gjykatën e paanshme. Gjykata e Lartë ka interpretuar në mënyrë kontradiktore nenet 5, paragrafi i dytë, 120, paragrafi i dytë dhe 478, paragrafi i parë, të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Gjykata e Lartë ka arsyetuar se kërkuesi nuk është treguar diligjent në paraqitjen e shkaqeve të rekursit, pasi nuk ka referenca konkrete ligjore, në një kohë që edhe veprimet në tërësi të Gjykatës së Lartë tregojnë se ajo nuk është treguar diligjente në shqyrtimin e çështjes së kërkuarit.

12.4 *Standardin e arsyetimit të lidhur me të drejtën e pronësisë dhe atë të njohjes me të dhënat personale*, pasi nuk janë të sakta, të plota dhe logjike konstatimet e Gjykatës së Lartë lidhur me objektin e gjykimit për sjelljen kontraktore të bankës së nivelit të dytë, pretendimet e kërkuarit, llojin e kredisë hipotekare në raport me atë konsumatore, kundërvajtjet e bankave të nivelit të dytë dhe garancitë e procedimit administrativ, si dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm. Gjykata e Lartë, në kundërshtim me parimin e disponibilitetit të padisë, i ka dhënë çështjes trajtën e mosmarrëveshjes civile. Konkluzioni i saj në këtë drejtim, jo vetëm bie ndesh haptazi me një vendim tjetër të po asaj gjykate, por nuk përputhet me zgjidhjen e dhënë, pasi, sipas ligjit, gjykimi duhej të ishte pushuar. E drejta e pronës duhet të mbrohet edhe nëpërmjet kontributit me veprime pozitive të Bankës së Shqipërisë. Interpretimi i nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006 nga Gjykata e Lartë bie ndesh me vendimin nr. 19/2022 të Gjykatës. Në kuptim të nenit 35, pika 3, të Kushtetutës, legjislacioni bankar nuk kufizon të drejtën për t'u njohur me çdo të dhënë të mbledhur nga Banka e Shqipërisë rreth kërkuarit.

13. Subjekti i interesuar, Banka e Shqipërisë, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

13.1 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar,

pasi kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë të dhënë rreth ndarjes së çështjes me short në Gjykatën e Lartë, ndaj nuk mund të pretendojë se nuk është hedhur shorti. Argumenti për caktimin e datës së seancës pa u studiuar dosja është i pasaktë.

13.2 Pretendimi për cenimin e parimit të *gjykatës së pavarur dhe të paanshme* nuk qëndron, pasi Gjykata e Lartë, megjithëse nuk e ka njoftuar kërkuarin me mjete elektronike, e ka njoftuar atë me postë, në njërën nga adresat që ka paraqitur në shkresat e tij. Kërkuesi nuk ka pretenduar mosmarrjen e njoftimit të postës, ndaj pretendimi për mosnjoftimin në adresën elektronike është i pabazuar.

13.3 Pretendimi për cenimin e parimit të *sigurisë juridike, së drejtës për t'u dëgjuar, aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë arsytet se përse shtesa e rekursit nuk është shqyrtuar prej saj. Banka e Shqipërisë ka ushtruar rolin mbikëqyrës duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme ndaj Bankës NBG. Inspektimet e Bankës së Shqipërisë nuk fillojnë me kërkesë të klientëve të bankave, të cilët nuk mund të përcaktojnë llojin, intensitetin dhe mënyrën e ushtrimit të inspektimeve. Një pjesë e pretendimeve janë trajtuar më parë nga Gjykata, ndërsa argumenti lidhur me fjalën diligjencë, pra se në vendimet e gjykatave duhet të ketë vetëm fjalë që i ka fjalori, është i pakuptueshëm.

13.4 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë objektit të padisë trajtën civile, por është kërkuesi që mosmarrëveshjen civile kërkon ta realizojë në rrugë administrative, ndonëse nuk ka dispozitë ligjore që autorizon nxjerrjen e aktit administrativ të pretenduar. Informacionin për proceset mbikëqyrëse Banka e Shqipërisë mund t'ua japë vetëm subjekteve të përcaktuara në nenin 91, pika 2, të ligjit nr. 9662/2006. Pretendimi se Banka e Shqipërisë ka akte të tjera për kërkuarin, përveç atyre që ka paraqitur në cilësinë e provës, përbën një pretendim të ri dhe është i bazuar vetëm në hamendësime.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesat paraprake

14. Kërkuesi, përpara fillimit të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, ka paraqitur dy kërkesa



procedurale: (i) për shtyrjen e afatit të parashtrimeve; (ii) për mospranimin e prapësimeve të subjektit të interesuar.

15. Në lidhje me afatin e paraqitjes së parashtrimeve, i cili ishte caktuar të përfundonte më datë 26.12.2023, kërkuesi ka parashtruar se ishte e pamundur për t'u respektuar prej tij për shkak të festave zyrtare, si dhe për shkak se i nevojitej marrja e dokumenteve shtesë në Gjykatë. Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 27.12.2023, bazuar në nenet 38 dhe 43/b të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë, duke shtyrë afatin deri më datë 31.1.2024.

16. Për sa u takon prapësimeve të subjektit të interesuar, Bankës së Shqipërisë, kërkuesi ka parashtruar se përfaqësuesit e tij janë caktuar me autorizim nga Guvernatori. Ky i fundit, sipas kërkuetit, nuk ka të drejtë për t'u shprehur për procedurat e kryera nga Këshilli Mbikëqyrës, duke përfshirë edhe veprimet e Departamentit të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë.

17. Gjykata vëren se nenet 44 dhe 53 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8269/1997*) përcaktojnë rolin dhe kompetencat e Guvernatorit. Sipas tyre, ai është kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe vepron si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv, i ngarkuar për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së përditshme të saj. Në veçanti, Guvernatori i njihet kompetenca për përfaqësimin e Bankës së Shqipërisë në procedurat ligjore (shkronja "c", pika 4, e nenit 53 të ligjit nr. 8269/1997). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se prapësimet e subjektit të interesuar janë paraqitur nga përfaqësues të autorizuar rregullisht, ndaj pretendimi i kërkuetit është i pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuetit

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pikat 1, shkronja "I" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr.

8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

21. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.

22. Në çështjen konkrete, vendimi i Gjykatës së Lartë që kundërshtohet nga kërkuesi është dhënë më datë 7.3.2023, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës më datë 18.9.2023, nëpërmjet shërbimit postar. Gjykata e Lartë më datë 19.5.2023 i ka dërguar kërkuetit vendimin në adresën e postës elektronike të depozituar prej tij.

23. Subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata duhet të verifikojë ditën se kur vendimi i Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen zyrtare, pasi në jurisprudencën kushtetuese është mbajtur qëndrimi se afati ligjor 4-mujor fillon nga kjo ditë. Në mbështetje të këtij prapësimi, subjekti i interesuar ka referuar vendimin nr. 226, datë 1.11.2023 të Kolegjit të Gjykatës, në të cilin afati ishte llogaritur nga dita e publikimit të vendimit në Gjykatën e Lartë. Kërkuesi e ka kundërshtuar këtë prapësim, duke parashtruar se ai është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të jurisprudencës kushtetuese për llogaritjen e fillimit të afatit ligjor.

24. Gjykata ka pohuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit, për qëllime të afatit ligjor 4-



mujor, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në mjediset fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individit depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij (*shih vendimin nr. 34, datë 12.6.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për sa më lart, Gjykata thekson se në rastet kur individit depoziton të dhënat e kontaktit elektronik, njoftimi individual në adresën elektronike është i detyrueshëm dhe ka përparësi në radhë për qëllime të vlerësimit të të drejtave procedurale të individit, përfshirë përlllogaritjen e afateve ligjore. Në këtë kuptim, është e papërshtatshme referenca e subjektit të interesuar në vendimin nr. 226, datë 1.11.2023 të Kolegjit të Gjykatës, në të cilin afati ishte llogaritur nga dita e publikimit të vendimit në Gjykatën e Lartë, pasi në atë rast ankuesi nuk rezultoi të kishte depozituar të dhënat elektronike të kontaktit të tij. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete, momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuarit, nga i cili ka filluar afati ligjor 4-mujor, konsiderohet data 19.5.2023 kur vendimi i është dërguar në adresën e postës elektronike. Për rrjedhojë, kërkuari e ka paraqitur ankimin kushtetues brenda afatit ligjor 4-mujor dhe legjitimohet *ratione temporis*.

26. Në drejtëm të legjitimitetit *ratione materiae* Gjykata fillimisht vëren se në përmbajtje të ankimit, në pjesën e argumenteve të legjitimitetit të tij, kërkuari ka pretenduar se vetë Gjykata, në dhënien e vendimeve nr. 19/2022 të Gjykatës dhe nr. 127/2022 të Kolegjit, i ka cenuar të drejtën për zgjidhje efektive dhe barazisë përpara ligjit, ndaj ai rezervon të drejtën për të ushtruar çdo mjet ligjor kundërshtimi për ato vendime. Sipas kërkuarit, pretendimet e paraqitura më parë prej tij nuk janë zgjidhur në mënyrë efektive, pasi Gjykata nuk ka konstatuar pretendimet për përgjegjësi që kishte për detyrë të ushtronte Këshilli Mbikëqyrës, ndërsa vendimi nr. 127/2022 i Kolegjit është marrë në tejkalim të kompetencave, në kushtet e

diskriminimit dhe pa u respektuar e drejta për t'u njohur me të dhënat e mbledhura.

27. Në funksion të këtij pretendimi, kërkuari ka kërkuar që Gjykata të marrë mendimin me shkrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave lidhur me legjislacionin për normat tekniko-profesionale dhe metodologjinë e shërbimit arkivor, duke parashtruar se ai është i nevojshëm për të ndryshuar qëndrimin që Gjykata ka mbajtur në vendimin nr. 19/2022 të saj në rastin e kërkuarit. Konkretisht, në atë vendim Gjykata është shprehur se pretendimi i kërkuarit se Gjykata e Lartë kishte detyrimin të njihte dhe të zbatonte legjislacionin për normat tekniko-profesionale dhe metodologjinë e shërbimit arkivor, nuk është ngritur në nivel kushtetues.

28. Subjekti i interesuar ka prapësuar se, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe nuk mund të rishikohen, ndaj është i papranueshëm pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për zgjidhje efektive dhe barazisë përpara ligjit.

29. Gjykata eidenton se, në thelb, pretendimi i kërkuarit lidhet me rishikimin dhe interpretimin e vendimeve të mëparshme të saj. Kushtetuta në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, edhe në nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 është parashikuar se vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar forca detyruese dhe natyra përfundimtare e vendimeve të Gjykatës. Efekti detyrues i këtyre vendimeve ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të tyre. Nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata (*shih vendimet nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nga ana tjetër, ligji nr. 8577/2000, në nenin 80, pika 1, të tij, ka rregulluar kompetencën e Gjykatës për të saktësuar dhe plotësuar vendimin e saj kur konstatohen gabime në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi e dukshme, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes. Ndërsa, sipas nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të po këtij ligji, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë



themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës për rihapje të procesit gjyqësor.

31. Mbi bazën standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi për zgjidhje efektive dhe barazi përpara ligjit vë në dyshim natyrën përfundimtare të vendimeve të mëparshme të saj, përtej kushteve të parashikuara nga ligji për saktësimin e vendimeve ose rihapjen e procesit. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim dhe kërkesa për marrjen e mendimit me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave nuk pranohet.

32. Në vijim të verifikimit të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor, ndaj i kanë cenuar: (i) të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj; (ii) të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; (iii) parimin e sigurisë juridike, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor; (iv) standardin e arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale. Gjykata konstaton se e drejta për t'u njohur me të dhënat personale, e drejta e pronësisë dhe e drejta për proces të rregullt ligjor garantohen nga nenet 35, 41 dhe 42 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë në kompetencën lëndore të saj.

33. Për sa i takon së drejtës për t'u njohur me të dhënat personale dhe së drejtës së pronës, ndonëse ato garantohen veçmas nga nenet 35 dhe 41 të Kushtetutës, kërkuesi pretendimet e tij i ka ngritur ndaj procesit gjyqësor të zhvilluar, ndaj Gjykata çmon ta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

34. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, Gjykata vëren se ai është parashtruar nga kërkuesi bazuar vetëm në argumente që lidhen me njëanshmërinë e gjyqtarëve, ndaj do ta shqyrtojë atë në këndvështrim të parimit të gjykatës së paanshme. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, së drejtës për t'u dëgjuar dhe aksesit në gjykatë, duke mbajtur në konsideratë

se kërkuesi e ka lidhur atë me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka arsyetuar vendimin e saj, Gjykata çmon ta analizojë në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

35. Për sa më lart, Gjykata do të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve për cenimin e të drejtave për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të paanshme, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1 Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

36. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke parashtruar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin në çështjen e kërkuetit është përbërë nga gjyqtarë të pacaktuar me short. Sipas tij edhe gjyqtari që ka zëvendësuar gjyqtarin e dorëhequr është caktuar pa short dhe në caktimin e gjyqtarëve pa short ka marrë pjesë këshilltari ligjor, në kundërshtim me detyrat funksionale të tij.

37. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi i kërkuetit është i pabazuar. Sipas tij, duke mbajtur në konsideratë pohimin e kërkuetit se nuk ka asnjë të dhënë rreth ndarjes së çështjes me short në Gjykatën e Lartë, në mungesë të të dhënave ai nuk mund të pretendojë se nuk është hedhur shorti.

38. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një prej aspekteve të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këtë të drejtë Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vijim, Gjykata vëren se, në përputhje me këtë të drejtë kushtetuese, nenet 25 dhe 23, pika 6, të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 98/2016*) parashikojnë se ndarja e çështjeve gjyqësore dhe zëvendësimi i një gjyqtari në trupin gjykues bëhet me short, i cili realizohet në rrugë elektronike, bazuar në parimet e transparencës dhe të objektivitetit.

39. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se tre gjyqtarët në përbërje të trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e kërkuetit janë caktuar duke u



bazuar në vendimin nr. 17, datë 7.7.2022, “Për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, si dhe caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupave gjykues të secilit koleg”, të nxjerrë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 23 dhe shkronjës “ç” të nenit 38 të ligjit nr. 98/2016. Më datë 2.2.2023 një prej tre gjyqtarëve ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, dorëheqje e cila është pranuar me vendimin nr. 289/1, datë 2.2.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në vijim, më datë 6.2.2023 është mbajtur procesverbal në lidhje me formimin e trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes, ku tregohet caktimi i gjyqtarit zëvendësues. Me vendimin e datës 13.2.2023 relatori i çështjes ka caktuar shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit më datë 7.3.2023, datë në të cilën është shpallur edhe vendimi i kundërshtuar.

40. Kërkuesi në ankimin kushtetues individual, gjatë parashtrimit të këtij pretendimi, ka kërkuar nga Gjykata marrjen e akteve të inspektimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) për procedurat e shortit në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar se në dosjen e çështjes së tij gjyqësore nuk janë dokumentuar procedurat për caktimin e trupit gjykues dhe plotësimin e tij me një tjetër gjyqtar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Sipas tij, ILD-ja, bazuar në nenin 25, pika 4, të ligjit nr. 98/2016, ka detyrimin të kryejë rregullisht inspektime të ndarjes së çështjeve me short. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument se përse aktet e inspektimit të ILD-së nuk janë tërhequr për t’u paraqitur prej vetë atij në gjykimin kushtetues në përputhje me nenin 43/b, shkronja “c”, të ligjit nr. 8577/2000, dhe as ndonjë argument nëse është penguar për tërheqjen e akteve, në kushtet kur atij i përket barra për të paraqitur provat që mbështesin pretendimet e tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kjo kërkesë nuk duhet të pranohet.

41. Në analizë të rrethanave të mësipërme, Gjykata nuk konstaton ndonjë të dhënë që të tregojë mosrespektimin e rregullave procedurale në Gjykatën e Lartë për caktimin e trupit gjykues dhe zëvendësimin e njërit prej anëtarëve, pas paraqitjes së kërkesës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Ashtu siç prapëson, me të drejtë, subjekti i interesuar, argumentet e kërkuesit janë hipotetike dhe nuk mjaftojnë për të mbështetur pretendimin e

tij, pasi, ndonëse pohon se nuk disponon ndonjë të dhënë faktike, ai nxjerr përfundimin për shkeljen e rregullave të shortit. Po kështu, Gjykata rithekson se veprimtaria e këshilltarit ligjor ka natyrë ndihmëse dhe këshillimore për funksionet gjyqësore të trupit gjykues dhe dokumentohet në akte me karakter të brendshëm, të cilat nuk janë të detyrueshme për t’iu komunikuar palëve (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se mënyra dhe cilësia e përmbushjes së detyrave funksionale të këshilltarit ligjor, si rregull, nuk i nënshtrohen kontrollit kushtetues kur Gjykata verifikon pretendimet për procesin e rregullt ligjor.

42. Për sa më lart, në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar.

C.2 Për cenimin e parimit të gjykatës së paanshme

43. Kërkuesi ka pretenduar se gjyqtari relator në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë ka urdhëruar kryerjen e njoftimeve pa studiuar dosjen gjyqësore. Sipas tij, gjyqtari relator kishte dijeni për adresën elektronike dhe postare të vlefshme të kërkuesit, por me pakujdesi të rëndë, në formën e neglizhencës, ka kryer vetëm njoftim individual postar pa pasur qëllim ta njoftonte realisht kërkuesin. Po kështu, kërkuesi ka parashtruar se njoftimi me fletëthirrje për kohën e seancës është i pavlefshëm, pasi Gjykata e Lartë e ka nisur njoftimin 6 ditë përpara seancës, ndonëse afati ligjor është të paktën 15 ditë. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë ka përsheptuar shqyrtimin e çështjes për shkaqe të pabazuara dhe për të marrë një vendim të paracaktuar. Po sipas tij, për çështjen janë kryer të paktën 20 veprime procedurale në kushtet e mungesës së transparencës, të painventarizuara në dosje dhe Gjykata e Lartë nuk ka paraqitur saktë rrethanat e çështjes, që tregon njëanshmërinë e saj.

44. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së paanshme është i pabazuar, duke parashtruar se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje çështjeve të trajtuara nga Gjykata në vendimin që ka urdhëruar rishqyrtimin e çështjes. Sipas tij, Gjykata e Lartë e ka njoftuar kërkuesin me postë, në njërën nga adresat që ka paraqitur në shkresat e tij dhe jo me *e-mail*. Po sipas subjektit të interesuar, duke qenë se kërkuesi nuk pretendon që nuk e ka marrë njoftimin e postës, nuk qëndron argumenti për mosdërgimin me *e-mail* të njoftimit.



45. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por edhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 6, datë 2.3.2018; nr. 46, datë 19.7.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Në çështjen konkrete Gjykata konstaton se, për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarëve, përfshirë atë të gjyqtarit relator, kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë thelbësore, por e ka bazuar këtë pretendim në interpretimin e veprimeve procedurale të çështjes, të cilat analizohen në vijim.

47. Gjykata vëren se kërkuesi, gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të dytë ka nënshkruar deklaratën për t'u njoftuar edhe në adresën e postës elektronike, megjithatë kjo adresë nuk është përdorur nga Gjykata e Lartë. Më datë 13.2.2023 sekretaria e Gjykatës së Lartë ka realizuar shpalljen publike të njoftimit për seancën e datës 7.3.2023, ora 13:00, duke njoftuar edhe përbërjen e trupit gjykues. Gjithashtu, përpara rishqyrtimit të çështjes së tij në Gjykatën e Lartë, sekretaria gjyqësore ka lëshuar dy herë akte njoftimi drejtuar kërkuesit individualisht në adresat fizike: (i) më datë 13.2.2023 dhe dëftesa e komunikimit mban shënimin “zyra mbyllur”; (ii) më datë 28.2.2023 dhe dëftesa e komunikimit është nënshkruar dhe mban shënimin “mora dijeni”, por me emër të pakuptueshëm. Njoftimi i dytë është nisur në adresën e shënuar nga kërkuesi në aktet e apelit dhe të rekursit, ndërsa në aktin e shtesës së rekursit ai ka caktuar një adresë të re, e cila nuk rezulton të jetë përdorur nga Gjykata e Lartë. Pas marrjes së njoftimit për datën e seancës nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur parashtrime në Gjykatën e Lartë dhe as ndonjë pretendim për vlefshmërinë e njoftimeve.

48. Në analizën e këtyre të dhënave, Gjykata vë në dukje se kërkuesi nuk merr në këtë marrë dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore në Gjykatën e Lartë. Pretendimi i tij lidhet drejtpërdrejt me mënyrën se si është realizuar

njoftimi, duke theksuar mungesën e njoftimit elektronik, që, sipas tij, përbën tregues të njëanshmërisë së gjyqtarit relator. Në këto rrethana, Gjykata çmon se argumenti i kërkuesit se gjyqtari relator e ka dërguar njoftimin e kërkuesit në adresa të pavlefshme, ndonëse kishte dijeni për adresat e sakta elektronike dhe postare, është i pamjaftueshëm për të provuar qëndrimin subjektiv të njëanshëm të gjyqtarit, në kushtet kur aktet e njoftimit të palëve përpilohen dhe dërgohen nga sekretaria gjyqësore, ndërsa gjyqtari ka detyrën të verifikojë dhe mbikëqyrë realizimin e tyre. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se saktësia e veprimeve të administratës gjyqësore në kryerjen e njoftimeve paraqet rëndësi thelbësore në drejtim të efektivitetit të gjykimit, ndërsa lidhur me elementet e procesit të rregullt ligjor ajo merr vlerë përcaktuese kur nuk është riparuar nga gjyqtari përgjegjës dhe eventualisht i ka sjellë pasojë reale individit në ushtrimin e të drejtave kushtetuese. Për sa i takon dërgimit të njoftimit 6 ditë përpara seancës gjyqësore dhe jo 15 ditë, sikur parashikon pika 5 e nenit 460 të KPC-së, Gjykata ripohon se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Gjithashtu, Gjykata çmon se periudha e shkurtër e rishqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përbën argument që të provojë pretendimin për cenimin e paanshmërisë në kuptimin subjektiv. Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje pas rikthimit të çështjes nga Gjykata dhe bazuar në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky fakt përbën shkak për shqyrtimin e çështjes me përparësi.

50. Për sa i përket paanshmërisë objektive, Gjykata vëren se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes. Argumentet e kërkuesit për cenimin e këtij parimi nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, pasi ai nuk ka paraqitur ndonjë provë konkrete për të mbështetur këtë pretendim.

51. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë cenimin e parimit të



paanshmërisë në aspektin subjektiv ose objektiv të tij, për rrjedhojë edhe ky pretendim është i pabazuar.

C.3 Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

52. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është dhënë në kundërshtim me ligjin dhe se mospranimi për shqyrtimin e shtesës së rekursit nga Gjykata e Lartë, për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor, është rezultat i interpretimit kontradiktor të neneve 5, paragrafi i dytë, 120, paragrafi i dytë dhe 478, paragrafi i parë, të KPC-së. Sipas tij, Gjykata e Lartë nuk është shprehur nëse Banka e Shqipërisë ka ushtruar në mënyrë të ligjshme pushtetin diskrecional dhe as për zbatimin e nenit 75 të ligjit nr. 8269/1997 të lidhur me vendimin nr. 52/2002 (manuali i veprimeve korrigjuese ndaj bankave). Kërkuesi ka parashtruar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë është jologjik, pasi e ka trajtuar objektin e padisë sipas së drejtës civile. Po kështu, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar detyrat e lëna nga Gjykata në vendimin nr. 19/2022, pasi nuk ka shqyrtuar pretendimin për cenimin e gjykatës së caktuar me ligj gjatë gjykimit në shkallë të dytë dhe nuk ka interpretuar nenin 91 të ligjit nr. 9662/2006, në kushtet kur neni 35 i Kushtetutës dhe legjislacioni bankar nuk kufizojnë të drejtën e kërkuesit për t'u njohur me çdo të dhënë të mbledhur nga Banka e Shqipërisë rreth tij. Gjithashtu, kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë ka përdorur termin “diligjencë”, që nuk e njeh ligji procedural dhe as Fjalori i Gjuhës Shqipe, por edhe nëse i jepet kuptim kësaj fjale, është vetë Gjykata e Lartë që nuk është treguar diligjente në shqyrtimin e çështjes së tij.

53. Subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë objektit të padisë trajtën civile, por është kërkuesi që një mosmarrëveshje të natyrës civile kërkon ta realizojë në rrugë administrative pa pasur dispozitë ligjore. Sipas tij, kërkuesi nuk paraqet ndonjë referencë ligjore për të drejtën e marrjes dijeni të proceseve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë, informacion i cili u jepet vetëm subjekteve të përcaktuara në nenin 91, pika 2, të ligjit nr. 9662/2006. Banka e Shqipërisë ka ushtruar rolin e saj të mbikëqyrjes duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme ndaj Bankës NBG. Po kështu, subjekti i interesuar ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka dhënë argumentet e saj për mospranimin e shkaqeve të shtesës së rekursit të kërkuesit, ndërsa pretendimi

për përdorimin e fjalës “diligjencë” është i pakuptueshëm.

54. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 12, datë 15.3.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka theksuar se kur pretendimi lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit, ajo ndërhyr vetëm kur interpretimi është arbitrar ose kur konstaton gabim ligjor aq evident që të karakterizohet si një gabim që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (*shih vendimet nr. 67, datë 6.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjykata në vijimësi ka pohuar se ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsytimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimet nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 18, datë 14.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se me vendimin nr. 19/2022, me të cilin është pranuar ankimi kushtetues individual i kërkuesit, ajo ka vlerësuar se në respektim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata e Lartë në rishqyrtimin e çështjes duhet të: (i) evidentojë në vendimin e saj shkaqet e parashtruara në shtesën e rekursit, edhe nëse në përfundim do të konkludojë se shtesa është paraqitur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ndërsa nëse e vlerëson të ligjshme paraqitjen e shtesës, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, si rrjedhojë e shortimit manual të trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, duhet të gjejë pasqyrim dhe t'i jepet përgjigje si pretendim i natyrës



kushtetuese (*shih paragrafin 43 të vendimit nr. 19/2022*); (ii) arsyetojë, qoftë edhe minimalisht, pretendimin lidhur me zbatimin e nenit 91 të ligjit nr. 9662/2006 që lidhet me të drejtën e kërkuarit për informim dhe njohjen me të dhënat e mbledhura rreth tij (*shih po aty, paragrafët 46-47*).

57. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë, pas rishqyrtimit të çështjes, në vendimin nr. 00-2023-705 (85), datë 7.3.2023, ka pasqyruar në pjesën hyrëse, në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e paraqitura në shtesën e rekursit. Lidhur me këto të fundit ka arsyetuar se bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka konkluduar se në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në shtesën e rekursit të datës 31.8.2021 nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (*shih paragrafët 21, 22 dhe 23 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

58. Për sa i takon së drejtës për informim, Gjykata e Lartë ka analizuar kuadrin rregullator ligjor dhe nënligjor për kompetencat e Bankës së Shqipërisë, si dhe përmbajtjen e shkresës së datës 17.1.2014 të atij institucioni drejtuar kërkuarit. Ajo ka arsyetuar se “llogaridhënia” e Bankës së Shqipërisë në raport me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë mbikëqyrëse është çështje e kontrollit gjyqësor sipas nenit 72 të ligjit nr. 8269/1997 dhe se ligji nuk ka parashikuar funksionimin e ndonjë organi kompetent në Bankën e Shqipërisë ose ndonjë procedurë konkrete për të shqyrtuar ankimet e konsumatorëve për mosmarrëveshjet me bankat e nivelit të dytë (*shih paragrafët 30 dhe 31 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuari është njohur me rezultatin e procedurës mbikëqyrëse dhe me aktet, si dhe pretendimet e tij që banka tregtare nuk ka zbatuar në mënyrën e duhur aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë, janë çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të kontratës së kredisë, për rrjedhojë ato duhet të ishin adresuar gjyqësisht në një gjykim të një natyre tjetër (*shih paragrafët 33 dhe 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

59. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi nr. 00-2023-705 (85), datë 7.3.2023 i Gjykatës së Lartë i ka dhënë përgjigje të shprehur kërkuarit se pretendimi i parashtruar në shtesën e rekursit është i papranueshëm, duke interpretuar

ligjin procedural. Interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë arbitrar dhe as me gabime ligjore evidente, që të kenë prishur drejtësinë e procesit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin, brenda kompetencave kushtetuese të saj, si gjykatë ligji dhe interpretimi konkret nuk rezulton të jetë haptazi i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se nuk qëndron pretendimi i kërkuarit se Gjykata e Lartë ka keqinterpretuar ligjin procedural kur ka vlerësuar papranueshmërinë e shtesës së rekursit.

60. Po kështu, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë ka përmbushur standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, siç ato janë evidentuar në vendimin nr. 19/2022. Ajo ka pasqyruar në vendimin e saj shkaqet e parashtruara në shtesën e rekursit, si dhe ka arsyetuar përse kjo shtesë rekursi nuk mund të merrej në shqyrtim. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar rekursin e kërkuarit në themelin e tij dhe ka arsyetuar edhe të drejtën për informim të tij, në raport me legjislacionin bankar, përfshirë nenin 91 të ligjit nr. 9662/2006. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se forca detyruese e vendimit të saj nr. 19/2022 nuk është vënë në dyshim nga Gjykata e Lartë.

61. Për sa i takon paqartësisë së konceptit “diligjent”, që është përdorur në vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se koncepti nuk ka krijuar paqartësi të nivelit kushtetues. Koncepti i dilijencës i referohet një huazimi, që, siç ka evidentuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në thelb përmban kërkesën që palët duhet të tregohen të kujdesshme në respektimin e hapave proceduralë për çështjen e tyre (*shih Bačkowska kundër Polonisë, datë 22.11.2010, § 54*).

62. Nga ana tjetër, vetë kërkuari duket që e ka kuptuar këtë fjalë të huazuar, sepse ka parashtruar në ankim pretendimin se vetë Gjykata e Lartë nuk është treguar dilijente në shqyrtimin e çështjes së tij. Lidhur me këtë pretendim të fundit, Gjykata, në shtesë të analizës së veprimtarisë procedurale të Gjykatës së Lartë, në kuadër të pretendimeve për gjykatën e caktuar me ligj dhe të paanshme, rithekson se nga shqyrtimi i vendimit të saj nuk rezultojnë gabime në interpretimin e ligjit që të nxirret përfundimi që ai të ketë qenë arbitrar, ndaj ky pretendim është i pabazuar.

63. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të



vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i pabazuar.

64. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit ndaj procesit gjyqësor të zhvilluar janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj nuk rezulton që të jenë cenuar e drejta e pronës dhe e drejta për t'u njohur me të dhënat personale, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual i kërkuarit rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 18.4.2024.

Shpallur, më 16.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim

VENDIM

Nr. 31, datë 18.4.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 18.4.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 43 (A) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Agim Goga

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përfaqësuar nga kryeinspektori Ervin Hoxha; Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, përfaqësuar nga drejtuesi i parë Tonin Vocaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 5622, datë 13.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 2221, datë 13.7.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2023-1941 (159), datë 8.5.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtuashme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, pikat 1 dhe 4, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Komisarariatit të Policisë Vorë, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Agim Goga (*kërkuari*) ka fituar pronësinë për pasurinë e paluajtshme laborator fotografik, me sipërfaqe 16 m², të ndodhur në Vorë, përmes kontratës së shitblerjes të datës 2.2.1995, e cila është regjistruar rregullisht në regjistrat hipotekarë të kohës. Me vendimin nr. 270, datë 22.8.2001, dega e Policisë Ndërtimore Tiranë ka



vendosur prishjen e tij, duke e konsideruar si ndërtim pa leje, vendim i cili është shfuqizuar më tej nga drejtoria e Policisë së Ndërtimit me vendimin nr. 38, datë 3.9.2001. Pavarësisht kësaj, në ditët në vijim, objekti i kërkuarit është prishur tërësisht, ndërsa një pjesë e truallit të objektit është përfshirë brenda rrethimit të Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë (postës së policisë Vorë).

2. Mbi pretendimin se objekti i është prishur nga Policia Ndërtimore dhe Komisarati i Policisë nr. 4, Tiranë, kërkuar ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara (palë të paditura në gjykimin e zakonshëm) për t'i dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar nga prishja e objektit, si dhe detyrimin e Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë për të liruar dhe dorëzuar truallin e zënë. Në vijim, ai ka depozituar aktin e datës 23.11.2001, përmes të cilit ka saktësuar dhe shtuar objektin e kërkesëpadisë, duke kërkuar shpërblimin e dëmit për fitimin e munguar nga dita e prishjes së objektit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si dhe detyrimin e të paditurve solidarisht për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme (*procesi i parë gjyqësor*).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 5787, datë 25.11.2004, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, duke detyruar Komisaratin e Policisë nr. 4, Tiranë për të liruar dhe dorëzuar në favor të kërkuarit sipërfaqen e truallit 8 m², e cila, sipas aktit të ekspertimit të kryer gjatë gjykimit, ndodhej brenda rrethimit me kangjella të postës së policisë Vorë, edhe pse rezultonte në pronësi të kërkuarit. Po kështu, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë lidhur me shpërblimin e dëmit për fitimin e munguar, duke arsyetuar se kërkuar nuk ka arritur të provojë ekzistencën e dëmit si pasojë e veprimeve të subjekteve të interesuara, duke u mbështetur vetëm në vendimin e Policisë së Ndërtimit Tiranë, pasi ai nuk ka krijuar efekte, për sa kohë që organi administrativ më i lartë ka korigjuar me vendim veprimet e organit administrativ më të ulët. Po sipas gjykatës, nuk ka elemente që të provojnë se veprimet që kanë shkaktuar dëm në pronën e kërkuarit të jenë kryer nga subjektet e interesuara, si dhe nuk është kompetencë e Policisë së Rendit të prishë objektet e paligjshme ose, për më tepër, të dëmtojë objekte të ndërtuara me leje ndërtimi. Në këto kushte, gjykata ka vlerësuar se nuk ndodhet përpara kërkesave të

nenit 608 të Kodit Civil (KC) për shpërblimin e dëmit të shkaktuar e aq më pak të ekzistencës së fitimit të munguar që rrjedh nga ky dëm. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuar.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1274, datë 22.12.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për sa i përket detyrimit të Komisarariatit të Policisë nr. 4, Tiranë për të liruar e dorëzuar në favor të kërkuarit sipërfaqen e truallit prej 8 m² të zënë padrejtësisht. Për kërkimet e tjera të kërkuarit gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesëpadisë, duke detyruar të paditurit, drejtorinë e Policisë së Ndërtimit dhe Komisaratin e Policisë nr. 4, Tiranë, për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme, si dhe për t'i paguar kërkuarit fitimin e munguar në shumën 3.553.474 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2007-239, datë 9.3.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit të Avokaturës së Shtetit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për interpretimin e vendimit të saj nr. 1274, datë 22.12.2005, me pretendimin se ky vendim ishte i paqartë për masën e detyrimit që duhej të shlyente secili nga të paditurit. Po kështu, kërkuar ka kërkuar nga gjykata e apelit që detyrimi i të paditurve për fitimin e munguar të shtrihej deri ditën e ekzekutimit të vendimit dhe jo deri në ditën e gjykimit, sikurse ajo ishte shprehur në atë vendim, duke detyruar të paditurit t'i paguanin shumën prej 75000 lekësh në muaj. Gjithashtu, kërkuar ka kërkuar nga gjykata e apelit të sqaronte edhe se si do të realizohej nga të paditurit përmbushja e detyrimit për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 158, datë 29.4.2010, ka vendosur pranimin e kërkesës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 1274, datë 22.12.2005 për një nga urdhërimet e tij, duke disponuar për detyrimin e të paditurve, Drejtorinë e Policisë së Ndërtimit dhe Komisaratin e Policisë nr. 4, Tiranë, t'i paguajnë kërkuarit fitimin e munguar në shumën 3.553.474 lekë në pjesë të barabarta. Lidhur me kërkimet e tjera të parashtruara në kërkesë, gjykata e apelit i ka vlerësuar ato si të pabazuara në ligj. Konkretisht, për sa i përket kërkesës në lidhje



me fitimin e munguar, ajo gjykatë ka arsyetuar se përmes saj kërkuesi nuk kërkonte sqarimin dhe interpretimin e vendimit të saj nr. 1274, datë 22.12.2005, por dhënien e një vendim të ri, i cili ndryshonte dhe cenonte vendimin në fjalë të gjykatës së apelit dhe atë të gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuptim, gjykata e apelit ka vlerësuar se një pretendim i tillë mund të ishte objekt i ankimit dhe shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë, por jo i ndreqjes së gabimit, siç pretendonte kërkuesi.

7. Ndërkohë, kërkuesi ka vënë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit nr. 1274, datë 22.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, megjithatë, detyrimi për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme nga ana e subjekteve të interesuara nuk është përmbushur. Nisur nga kjo, me qëllim përfitimin e dëmshpërblimit për fitimin e munguar deri në ekzekutimin e plotë të vendimi gjyqësor të formës së prerë (pra deri në ndërtimin e objektit), më datë 27.12.2011 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e të paditurve për t'i dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar në formën e fitimit të munguar prej datës 12.10.2002 deri në ekzekutimin e plotë të vendimit nr. 5787, datë 25.11.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*procesi i dytë gjyqësor*). Kjo e fundit, me vendimin nr. 1461, datë 4.2.2014, ka vendosur konstatimin e mungesës së kompetencës së saj për shqyrtimin e çështjes dhe dërgimin e saj për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

8. Përmes akteve të datave 2.10.2014 dhe 16.6.2014, me lëndë “Sqarime rreth padisë”, të depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kërkuesi ka sqaruar se kërkitimi i tij konsistonte në dëmshpërblimin në formën e fitimit të munguar nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë deri në rindërtimin e objektit nga palët e paditura. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5622, datë 13.10.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuetit si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se Gjykata e Apelit Tiranë, gjatë procesit të parë gjyqësor, e ka zgjidhur përfundimisht se cili është fitimi që kërkuesi do të realizojë në të ardhmen nëse do të vazhdonte ta kishte pronën. Sipas saj, vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohet e zgjidhur tashmë në bazë të parimit të gjësë së gjykuar. Po kështu, ajo e ka çmuar si të bazuar në ligj prapësimin e palëve të

paditura lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë së kërkuetit, pasi, bazuar në nenin 115, shkronja “dh”, të KC-së, ai kërkonte fitimin e munguar për një periudhë 9-vjeçare, duke filluar nga viti 2004, në tejkalim të afatit 3-vjeçar për kërkitimin e dëmshpërblimit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2221, datë 13.7.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se ky vendim ishte rrjedhojë e një procesi të rregullt ligjor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale dhe ishte marrë në zbatim të drejtë të ligjit material në raport me faktet dhe provat objekt gjykimi. Kundër këtij vendimi më datë 23.8.2016 kërkuesi ka ushtruar rekurs.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1941 (159), datë 8.5.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se përfundimi i arritur nga kjo gjykatë është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) më datë 1.9.2023 me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 19.9.2023. Kolegji i Gjykatës më datë 20.11.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është i paligjshëm dhe shkel në mënyrë flagrante detyrimet kushtetuese për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e pronës private. Arsyetimi i saj është kontradiktor dhe në kundërshtim me ligjin. Nga njëra anë, ajo citon dhe interpreton dispozitat e KC-së për dëmin pasuror dhe fitimin e munguar, ndërkohë që, nga ana tjetër,



rrëzon kërkesëpadinë, në kundërshtim me këto parashikime. Po kështu, arsyetimi i saj se kërkesëpadia përbën gjë të gjykuar nuk qëndron, për sa kohë që prej vetë gjykatës është interpretuar se fitimi i munguar është ai fitim që subjekti i dëmtuar do të realizonte në të ardhmen. Edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe normat ligjore për të njëjtat shkaqe dhe për të njëjtat arsyeime të paligjshme.

12.2 *Së drejtës së pronës private*, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë garantuar atij pronën private, si dhe i kanë bërë të pamundur përfitimin e shpërblimit të drejtë të pronës në vijim të prishjes të saj në mënyrë të kundërligjshme nga institucionet shtetërore. Dëshmipërblimi në formën e fitimit të munguar, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i takon periudhës kohore nga momenti i prishjes së objektit në vitin 2001, deri në momentin e shpalljes së vendimit nr. 5787, datë 25.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë, pretendimi i ngritur përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka lidhje me dëshmipërblimin në formën e fitimit të munguar që i përket periudhës pas shpalljes së vendimit gjyqësor të mësipërm deri në ekzekutimin e detyrimit kryesor nga palët e paditura, që është ndërtimi i objektit në gjendjen e mëparshme. Ky është një kërkim i ri, i cili, fillimisht, është pasqyruar gabim në objektin e kërkesëpadisë dhe, në vijim, është kërkuar saktësimi i tij në seancën përgatitore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

13. Subjektet e interesuara, Inspektorati Kombëtar i Mbrotjes së Territorit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në thelb, kanë paraqitur të njëjtat argumente dhe, në mënyrë të përmbledhur, kanë prapësuar, si vijon:

13.1 Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi interpretimi dhe zbatimi i ligjeve qëndron jashtë juridiksionit kushtetues. E kundërta ndodh në rastin e kërimit të interpretimit të dispozitave kushtetuese, ku Gjykata ka rolin e interpretuesit përfundimtar të Kushtetutës. Shqyrtimi i pretendimeve për themelin e çështjes është pjesë e juridiksionit të gjykatave të faktit dhe Gjykatës së Lartë, në rastin eventual të rekursit ose mjeteve të tjera ankimore të parashikuara nga ligji procedural. Kërkesa nuk reflekton ndonjë

problematikë me natyrë kushtetuese dhe në këto kushte duhet rrëzuar për mungesë juridiksioni.

13.2 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi në rastin objekt gjykimi nuk ekziston kufizimi i *së drejtës për akses në gjykatë*, për sa kohë kërkuar nuk provon se është privuar nga e drejta për të parashtruar pretendimet e tij. E drejta e aksesit ose të drejtat e tjera procedurale nuk garantohen domosdoshmërisht dhe vetëm duke e paraqitur çështjen në seancë publike. Gjykata e Lartë është gjykatë ligji dhe jo fakti dhe ajo ka të drejtë të investohet vetëm në çështje që kanë të bëjnë me shkelje të rënda të ligjit procedural dhe material.

13.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të kontradiktoritetit* është i pabazuar. Në lidhje me zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit, Kolegji Administrativ ka revokuar vendimin e ndërmjetëm për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, për të vijuar shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, vendim i cili u është komunikuar palëve. Në këto kushte nuk rezulton që kërkuar të jetë vendosur në pozita të pabarabarta me subjektin e interesuar.

13.4 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur* është i pabazuar, pasi në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt ligjor, në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me dispozitat procedurale për shqyrtimin e rekursit dhe njoftimin e palëve, vetëm fakti që ky gjykim është zhvilluar në dhomën e këshillimit, nuk e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese. Kërkimet dhe argumentet në përmbajtje të kërkesës nuk reflektojnë ndonjë problematikë të natyrës kushtetuese.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuar

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të



garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij. Pretendimet e tij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe së drejtës së pronës janë ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se ai nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë ka përmbyllur në formë dhe substancë kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton

se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-1941(159), datë 8.5.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 1.9.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor në kuptim të dispozitës së lartpërmendur. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

19. Për sa i takon legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe të drejtën e pronës private, të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës.

20. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkesa nuk reflekton ndonjë problematikë me natyrë kushtetuese dhe në këto kushte duhet rrëzuar për mungesë juridiksioni, pasi interpretimi dhe zbatimi i ligjeve qëndron jashtë juridiksionit kushtetues. Gjykata vlerëson se edhe pse subjektet e interesuara kanë kundërshtuar juridiksionin e saj për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të kërkuetit, argumentet e tyre kanë të bëjnë me legjitimitimin *ratione materiae* të pretendimeve të tij. Në këtë këndvështrim, duke qenë se kërkuesi pretendon se i është mohuar e drejta e tij e pronës private përmes një procesi jo të rregullt ligjor të zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në ndryshim nga sa kanë prapësuar subjektet e interesuara, nisur nga përmbyllja e pretendimeve të tij, pra cenimi i të drejtave kushtetuese si pasojë e vendimmarrjes së këtyre gjykatave, Gjykata çmon se ato përfshihen në juridiksionin kushtetues.

21. Gjithashtu, Gjykata konstaton se përkundrejt pretendimeve të kërkuetit, subjektet e interesuara, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në prapësimet e tyre në themel kanë argumentuar për disa të drejta dhe parime kushtetuese, asnjë prej të cilave nuk lidhet, qoftë edhe tërthorazi, me pretendimet e ngritura nga kërkuesi në ankimin kushtetues individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se prapësimet e subjekteve të interesuara për themelin e çështjes nuk mund të merren në konsideratë.

22. Për sa u takon pretendimeve të ngritura nga kërkuesi, duke qenë se argumentet mbi të cilat ai ka bazuar pretendimin e tij për cenimin e së drejtës së pronës private janë të ndërrarura me ato për



cenimin e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon që çështja e paraqitur të analizohet në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Për sa i takon së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ajo përfshin, ndër të tjera, edhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Prandaj, duke mbajtur në konsideratë se kërkuesi parashtron se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë dhënë në kundërshtim me ligjin, Gjykata vlerëson të analizojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të tij në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e pronës private.

B. Për themelën e pretendimeve

B.1 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private

23. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është i paligjshëm dhe shkel në mënyrë flagrante detyrimet kushtetuese për zhvillimin e procesit të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e pronës private. Arsyetimi i saj është kontradiktor dhe në kundërshtim me ligjin. Nga njëra anë, ajo citon dhe interpreton dispozitat e KC-së për dëmin pasuror dhe fitimin e munguar, ndërkohë që, nga ana tjetër, rrëzon kërkesëpadinë, në kundërshtim me këto parashikime, duke konsideruar se kërkesëpadia përbën gjë të gjykuar. Edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe normat ligjore për të njëjtat shkaqe dhe për të njëjtat arsyeime të paligjshme. Ato nuk i kanë garantuar atij pronën private, si dhe shpërblimin e drejtë për shkatërrimin e saj në mënyrë të kundërligjshme nga institucionet shtetërore. Dëmshpërblimi në formën e fitimit të munguar, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i takon periudhës kohore nga momenti i prishjes së objektit në vitin 2001 deri në momentin e shpalljes së vendimit nr. 5787, datë 25.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndërkohë, pretendimi i ri ka lidhje me dëmshpërblimin në formën e fitimit të munguar që i përket periudhës pas shpalljes së vendimit gjyqësor të mësipërm deri në ekzekutimin e detyrimit kryesor nga palët e paditura, që është ndërtimi i objektit në gjendjen e mëparshme.

24. Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar përkon me

detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Po kështu, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e saj është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022. nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. E drejta e pronës private është e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës. Edhe Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se garantimi i së drejtës së pronës private përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. E drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. E drejta e pronës realizohet përmes ushtrimit të tagrave të pronësisë dhe se cenimi qoftë edhe i pjesshëm i çdo tagri të pronësisë përbën, në vetvete, cenimin e së drejtës të pronës në tërësinë e saj (*shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.4.2017; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekt të këtij gjykimi kushtetues, Gjykata konstaton se për shkak të prishjes në mënyrë të paligjshme të objektit laborator fotografik në pronësi të kërkuesit, gjatë



procesit të parë gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit, me qëllim përcaktimin e dëmit të shkaktuar nga prishja e objektit, si dhe të fitimit të munguar nga moskryerja e aktivitetit nga momenti i prishjes së objektit deri në momentin e gjykimit. Në aktin e ekspertimit të datës 14.10.2004 rezulton se është përllogaritur dëmi që përbëhet nga vlera e godinës së prishur në shumën 817.474 lekë dhe vlera e fitimit të munguar për moskryerje të aktivitetit në shumën prej 2.736.000 lekësh për periudhën nga momenti i prishjes së objektit në vitin 2001 deri më datë 18.9.2004. Në total akti i ekspertimit ka llogaritur një dëm në shumën prej 3.553.474 lekësh, vlerë e cila është përcaktuar nga Gjykata e Apelit Tiranë si detyrim që palët e paditura duhet t'i paguajnë kërkuarit. Përveç këtij detyrimi, gjykata e apelit për subjektet e interesuara ka përcaktuar edhe detyrimin për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme. Ky vendim nuk rezulton të jetë kundërshtuar në Gjykatën e Lartë nga kërkuari, por vetëm nga Avokatura e Shtetit.

27. Gjatë procesit të dytë gjyqësor, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuarit, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se Gjykata e Apelit Tiranë në procesin e parë gjyqësor, ndonëse ka disponuar edhe për detyrimin e të paditurve për ndërtimin e objektit në gjendjen që ka qenë, në lidhje me njohjen e së drejtës për fitimin e munguar dhe llogaritjen e tij, për vetë konceptin që ka fitimi i munguar, e ka zgjidhur përfundimisht se cili është fitimi që paditësi (kërkuari) do të realizonte në të ardhmen, nëse do të vazhdonte ta kishte pronën e tij. Në këtë mënyrë, sipas saj, pretendimi i kërkuarit për fitimin e munguar, që rrjedh nga mospërmbushja e detyrimit të palës së paditur për ndërtimin e objektit në gjendjen që ka qenë, është i pabazuar në ligj, pasi kjo e drejtë i është njohur në masën konkrete në atë gjykim, duke nënkuptuar pikërisht mospasjen e pronës. Në këto kushte, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se vendimi është i formës së prerë dhe çështja konsiderohej e zgjidhur në bazë të parimit të gjësë së gjykuar (*res judicata*). Po kështu, ajo e ka gjetur të bazuar prapësimin e të paditurve për parashkrimin e kërkesëpadisë së kërkuarit, referuar nenit 115, shkronja “dh”, të KC-së, duke arsyetuar se ai kërkonte shpërblimin e dëmit jokontraktor në formën e fitimit të munguar pas një periudhe 9-

vjeçare, duke filluar nga viti 2004, pra në tejkalim të afatit 3-vjeçar për kërkimin e dëmshpërblimit (*shih faqen 5 të vendimit nr. 5622, datë 13.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

28. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se gjykatat kanë disponuar për sa i përket së drejtës së kërkuarit për të përfituar fitimin e munguar, si dhe lidhur me përcaktimin e masës konkrete të këtij përfitimi, si pasojë e dëmit të shkaktuar pronës së tij në mënyrë të paligjshme. Ato kanë përcaktuar pikërisht fitimin që subjekti i dëmtuar do të realizonte në të ardhmen, sikur të mos ishte shkaktuar ngjarja e dëmshme. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se për sa është kërkuar nga kërkuari në objektin e padisë, çështja është zgjidhur përfundimisht me vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimi nr. 1274, datë 22.12.2005 i Gjykatës së Apelit Tiranë) dhe pretendimi i tij për fitimin e munguar, që rrjedh nga mospërmbushja e detyrimit të palës së paditur për ndërtimin e objektit në gjendjen që ka qenë, është i pabazuar në ligj, pasi kjo e drejtë i është njohur palës paditëse në masën konkrete. Gjithashtu, ajo gjykatë e ka konsideruar të drejtë përfundimin e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me parashkrimin e padisë (*shih faqet 8–9 të vendimit nr. 2221, datë 13.7.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit*).

29. Sipas Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kërkuari i është njohur fitimi i munguar me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, ku është përcaktuar edhe vlera konkrete financiare, ndaj rasti konkret përbën gjë të gjykuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, të dhënë në një gjykim të mëparshëm dhe që nuk mund të gjykohet përsëri. Ndër të tjera, ai ka vlerësuar se argumenti i kërkuarit se ka kërkuar shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të munguar pas dhënies së vendimit të gjykatës është i pabazuar në ligj, pasi gjykatat ia kanë dhënë kërkuarit fitimin e munguar për të gjithë kohën dhe vlera e tij është e tillë që përfshin edhe përdorimin në të ardhmen, prandaj kjo pjesë përbën gjë të gjykuar, duke iu referuar natyrës dhe përmbajtjes së kërtimeve të paditësit të gjykuara me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ndërsa vonesat në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, sipas atij kolegji, nuk lënë shkas për paraqitjen e një padie për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, për sa kohë që kërkuari ka mundësi të ndjekë mjetet e ekzekutimit



të detyrueshëm të parashikuara në KPC, ndërkohë që pretendimet për rindërtimin e objektit lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ku qartësisht ligji procedural ka parashikuar mënyrën dhe procedurën e ekzekutimit të tij (*shih paragrafët 18 dhe 19 të vendimit nr. 00-2023-1941 (159), datë 8.5.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

30. Nga analiza e vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuarit për të përfutur dëmshpërblim në formën e fitimit të munguar deri në zbatimin e detyrimit kryesor nga palët e paditura për ndërtimin e objektit të prishur në gjendjen e mëparshme. Vendimmarrja e tyre mbështetet në arsyetimin se: (i) kërkuari e ka përfutur më parë shpërblimin e dëmit të shkaktuar në formën e fitimit të munguar me vendim gjyqësor të formës së prerë (*procesi i parë gjyqësor*) dhe vlera e tij është e tillë që përfshin edhe përdorimin e objektit në të ardhmen, duke vlerësuar se çështja objekt i procesit të dytë gjyqësor (e kundërshtuar nëpërmjet ankimit kushtetues individual) përbën *res judicata*, (ii) kërkesëpadia është parashikuar, duke konsideruar se dëmshpërblimi kërkohej prej vitit 2004 nga data e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë dhe neni 115, shkronja “dh”, i KC-së parashikon një afat 3-vjeçar për parashkrimin e padisë për shpërblimin e dëmit, argument ky që nuk ka gjetur përkrahje nga Gjykata e Lartë.

31. Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se në kushtet kur në procesin e parë gjyqësor kërkuari ka kërkuar edhe shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të munguar për periudhën nga dita e prishjes së objektit deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, ndërsa nuk ka ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. 1274, datë 22.12.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë, përmes të cilit është vendosur detyrimi i të paditurve për të ndërtuar objektin në gjendjen e mëparshme, si dhe për t'i paguar kërkuarit fitimin e munguar në shumën 3.553.474 lekë, ai, në këtë mënyrë, ka pranuar fitimin e munguar në masën e caktuar, pavarësisht mënyrës dhe periudhës së përlllogaritjes së tij. Për sa kohë ky vendim nuk është kundërshtuar nga kërkuari, ai përbën gjë të gjykuar. Ashtu si ka vënë në dukje Gjykata e Apelit Tiranë gjatë shqyrtimit të kërkesës për interpretimin e vendimit të saj, pretendimet e tij, që në thelb kundërshtojnë vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, për sa ajo ka disponuar në lidhje me fitimin e munguar, duhej të

ishin bërë objekt i mjetit të ankimit dhe më pas i vlerësimit nga një gjykatë më e lartë, por jo i një kërkit të ri. Ndërkohë, për sa u takon pretendimeve të tij për ndërtimin e objektit në gjendjen e mëparshme, sikurse ka arsyetuar edhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ato lidhen me ekzekutimin e vendimit gjyqësor, për të cilin ligji procedural ka parashikuar mjetet dhe procedurën e ekzekutimit të tij.

32. Në këndvështrim të sa më lart, në kundërshtim me sa pretendon kërkuari, Gjykata çmon se arsyetimi i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk rezulton të jetë kontradiktor ose i paqartë në formë dhe përmbajtje. Gjithashtu, nuk rezulton që gjykatat të kenë zbatuar ligjin në mënyrë arbitrare, duke respektuar në këtë mënyrë standardet kushtetuese për arsyetimin e vendimit gjyqësor, për rrjedhojë vendimmarrja e gjykatave nuk ka cenuar as të drejtën e pronës private të kërkuarit.

33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e pronës private nuk janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 18.4.2024.

Shpallur, më 16.5.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahim



VENDIM

Nr. 79, datë 2.5.2024

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “FTL”
SHA PËR ZGJIDHJEN E
MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, geramat “a” dhe “ë”; të nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 15 dhe 23, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; të nenit 11, të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 371/26 prot., datë 30.4.2024, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘FTL’ sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “FTL” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 371/24 prot., datë 16.4.2024, ka paraqitur kërkesën për zgjidhje të mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. ku në mënyrë të përmbledhur, ndër të tjera, parashtroi se: “Në kushtet e përcjelljes së planifikimit të prodhimit vjetor jashtë afatit kontraktor, njoftimi i datës 11.12.2023 dhe planifikimi vjetor i përcjellë nga kjo shoqëri nuk është marrë në konsideratë... Në këtë njoftim është deklaruar se një pjesë e sasisë së energjisë elektrike të prodhuar për periudhën 1.2.2024–31.12.2024, do të shitej në ALPEX”.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., nëpërmjet shkresës nr. 371/21 prot., datë 8.4.2024, ndër të tjera, ka parashtuar se: “Dragobia Energy” sh.p.k. nuk është në shkelje të kontratës dhe është në përmbushje të çdo detyrimi kontraktor apo të çdo akti ligjor dhe nënligjor të sektorit të energjisë elektrike.

- Në nenin 24, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga ERE”, përcaktohet ndër të tjera se: “ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e

mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave. Çdo palë e interesuar, që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t’i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s.”.

- Në këto rrethana, sqarojmë se: Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 17, datë 16.2.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Ceremi” dhe “Dragobia”, sipas përcaktimit në licencën e dhënë nga ERE, si dhe shoqëria “FTL” sh.a. është licencuar nga ERE për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike dhe mban licencën seria 423-F18/F23, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.9.2018, dhe rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 121, datë 4.4.2023.

- Duke qenë se palët: i. “FTL” sh.a. dhe ii. shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k., janë shoqëri të licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe ngrenë një problematikë për zgjidhje mosmarrëveshje, duke mbajtur qëndrime të kundërta, në lidhje me njoftimin e kontratës së shitjes së energjisë elektrike, ERE, në mbështetje të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, si dhe të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016, vlerësohet se palët legjitimohen për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “FTL” sh.a., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të



gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 80, datë 2.5.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK
BALLSH” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 979/1 prot., datë 30.4.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreNNat Solar Park Ballsh’

sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 979 prot., datë 23.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c”; për pikën 2.1, germat: “a”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi konstatohet se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9, formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- Pika 1.3, dokumentacioni financiar dhe fiskal

Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare, referuar vlerës së investimit, sikurse përcaktuar në kontratën me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);

Pika 2, dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës:

- germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë kontratën me MIE-n në format origjinal ose fotokopje e njëzuar me origjinalin;

- germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në



veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 81, datë 2.5.2024

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 155, DATË 7.10.2020, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘MATEO&CO’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘MURASI’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw, NË LUMIN E CEMIT TË SELCËS, DEGË E LUMIT CEM I BASHKUAR, NË BASHKINË MALËSI E MADHE, QARKU SHKODËR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 60/2 prot., datë

30.4.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 155, datë 7.10.2020, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘MATEO&CO’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Murasi’, me kapacitet të instaluar 2000 kw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 155, datë 7.10.2020, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “MATEO&CO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Murasi”, me kapacitet prodhues 2000 kw, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “MATEO&CO” sh.p.k. të bëjë me dije ERE-n mbi ecurinë e procesit të rinovimit, si dhe të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, jo më vonë se 1 muaj pas rinovimit të tyre.

3. Mosplotësimi i kushtit të parashikuar në pikën 2 të këtij vendimin përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ERE.

- Për sa lënë kusht në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155/2020, shoqëria duhet të depozitojë në ERE: lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor brenda datës 9.4.2022, dhe kontratën e qirasë me nr. 6418 prot., datë 8.10.2018, të nënshkruar midis Bashkisë Malësi e Madhe, në cilësinë e qiradhënësit, dhe shoqërisë “MATEO&CO” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, e depozituar nga ana e shoqërisë, me herët, në ERE, në kuadër të pajisjes me licencë, e cila ka përfunduar në datën 8.10.2023.

- Në lidhje me plotësimin e kushteve të sipërcituara është ndjekur një korrespondencë e gjatë me shoqërinë, me shkresat (nr. 386 prot., datë 18.3.2022, nr. 849 prot., datë 26.5.2022, nr. 1397 prot., datë 11.5.2023, nr. 2429/1 prot., datë 21.11.2023). Gjatë kësaj kohe është zhvilluar dhe një seancë dëgjimore me qëllim sqarimin/shterimin e procesit të pajisjes me këto leje.

- Për sa i përket kushtit për depozitim të lejes së rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor nga ana e shoqërisë me shkresat (nr. 386/1 prot., datë 8.4.2023, nr. 2429/2 prot., datë 11.12.2023) është depozituar informacioni, në lidhje me



aplikimet e bëra në datat 22.3.2022, 7.11.2022, 25.9.2023, këto aplikime janë refuzuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) për mangësi dokumentacioni, së fundi, shoqëria, pasi ka plotësuar detyrat e lëna nga AMBU-ja, ka riaplikuar në datën 4.3.2024, po ashtu ajo ka bërë me dije se për gjithë këtë periudhë që është në fazë aplikimesh/trajtimesh për rinovimin e lejes është faturuar dhe ka paguar detyrimet/tarifat rregullisht për përdorimin e burimeve ujore.

- Në korrespondencat e zhvilluara me AMBU-në, me shkresat (nr. 1397/1 prot., datë 19.5.2023, nr. 1928/2 prot., datë 6.10.2023, nr. 633 prot., datë 15.2.2024), (nr. 1928/3 prot., datë 18.10.2023, nr. 633/1 prot., datë 22.2.2024), në të cilat AMBU-ja ka dhënë sqarimet respektive, gjithashtu, ka bërë me dije se subjekti është në fazën e trajtimit të aplikimeve të kryera.

- Nga korrespondencat me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Muras” i shoqërisë “MATEO & CO” sh.p.k. nuk rezulton të ketë një vendim për mosushtim veprimtarie.

- Si e tillë, duke ju referuar aplikimit të fundit të depozituar nga shoqëria, i bërë në datën 4.3.2024, vlerësojmë t’i lihet një afat për depozitim të lejes së rinovuar sipas kohës së trajtimeve dhe të rasteve të tjera nga AMBU-ja, e cila në komunikimet e mëparshme ka sqaruar se, pavarësisht se vlerësimi progresiv i afateve të vendosura në dispozitat në fuqi është mesatarisht rreth 90 ditë.

- Për sa më sipër, referuar dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, korrespondencës me AMBU-në dhe IKMT-në, vlerësojmë që pika 2 e dispozitivit të ndryshojë duke i lënë detyrimin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor deri në datën 3.6.2024. Po ashtu, pas pikës 2 të shtohet pika 3 me përmbajtjen: nëse subjekti ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në depozitim të lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor.

- Për sa lënë kusht në pikën 2 të vendimit të Bordit, shoqëria ka pasur detyrimin të depozitojë në ERE kontratën e qirasë të rinovuar me Bashkinë Malësi e Madhe, e cila e ka pasur afatin e vlefshmërisë deri në datën 8.10.2023. Në lidhje me

plotësimin e këtij kushti, është zhvilluar korrespondencë me shoqërinë me shkresat e referuara më sipër dhe sa trajtuar edhe në seancën dëgjimore ku u sqarua modaliteti i vijimit për ndjekjen e dokumentacionit pronësor, në të u referua se do të vijohet edhe me regjistrimin e kontratës me MIE-n në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). Në zbatim të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 2, shoqëria, me shkresën nr. 60/1 prot., datë 2.4.2024, ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 632 prot., datë 29.2.2024, të lidhur mes shoqërisë “Mateo & Co” sh.p.k. dhe Bashkisë Malësi e Madhe “Për dhënie në përdorim (qira) të fondit pyjqor/kullosor publik”, me afat 10-vjeçar me të drejtë rinovimi.

- Në vijim të sa depozituar nga shoqëria është plotësuar kushti i vendosur në pikën 2, si i tillë vlerësohet që në dispozitiv të shtohet pika 4 pasi përcaktimi i pikës dy është ndryshuar, pika 4 do ketë përmbajtjen: shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar me Malësinë e Madhe “Për dhënie në përdorim (qira) të fondit pyjqor/kullosor publik”, brenda datës 1.3.2034, ose Certifikatën e Lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonën ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 155, datë 7.10.2020, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria “MATEO&CO” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Muras”, brenda datës 3.6.2024.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:

“3. Nëse subjekti ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në depozitim të lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor.”.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

“ 4. Shoqëria “MATEO&CO” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë



me Bashkinë Malësi e Madhe, brenda datës 1.3.2034 ose certifikatën e lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), që rregullon të drejtën e përdorimit të pronës në zonën ku shtrihet centrali i prodhimit të energjisë elektrike.”.

4. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:

“5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit të kushteve të tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 82, datë 2.5.2024

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E BORDIT TË ERE-s NR. 9, DATË
21.1.2022, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘BREÇANI R.O.S.P.’ SHPK
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“DRITA”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 1980 kw”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3 të ligjit nr. 144/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 633/6 prot., datë 30.4.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr.

9, datë 21.1.2022 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Breçani R.O.S.P’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Drita’, me kapacitet të instaluar 1980 kw, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 9, datë 21.1.2022, i ndryshuar, në vijim me vendimin nr. 232, datë 12.9.2022, me kushtet si më poshtë:

1. *Të licencojë shoqërinë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.*

2. *Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., duhet të paraqesë në ERE kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, apo çdo dokument tjetër që i shërben realizimit të saj brenda 30 ditëve-pune nga marrja e djenit.*

3. *Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes për përdorimin e burimit ujor (data 10.12.2023), duhet ta depozitojë atë në ERE, jo më vonë se një muaj pas rinovimit.*

4. *Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së HEC “Drita”, jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.*

5. *Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në rast të plotësimit/ mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi.*

- Në lidhje me plotësimin e kushteve të sipër cituara është ndjekur një korrespondencë e gjatë me shoqërinë me shkresat (nr. 37/3 prot., datë 28.7.2022, nr. 1866/2 prot., datë 14.11.2023, nr. 1866/3 prot., datë 7.12.2023, nr. 52 prot., datë 8.1.2024), gjithashtu, është zhvilluar një seancë dëgjimore me qëllim sqarimin/shterimin e procesit të pajisjes me dokumentacionin pronësor.

- **Në kuadër të plotësimit të kushteve të lëna në pikat 2 dhe 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9/2022**, i ndryshuar, të dyja këto kushte lidhen me pronësinë dhe do t'i trajtojmë bashkë. Shoqëria me shkresat (nr. 37/4, datë 4.8.2022, nr. 1866 prot., datë 29.6.2023, nr. 1866/4 prot., datë 14.12.2023, nr. 52/1 prot., datë 15.1.2024, nr. 633/5 prot., datë 22.4.2024) ka depozituar kontratën e rinovuar me nr. 2693/7 prot., datë 5.11.2020 “Për dhënie në



përdorim të fondit pyjor/kullosor”, për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga data 18.7.2018–17.7.2028, me të drejtë rinovimi çdo vit.

- Kjo kontratë nuk mbulonte të gjithë zonën ku shtrihet projekti, në vijim të vënies në dispozicion të proces verbalit të seancës dëgjimore dhe kërkesës për të depozituar dokumentacionin tashmë sa saktësuar/sqaruara, subjekti ka depozituar aplikimet e bëra në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Tropojë për regjistrimin e kontratës koncensionare për HEC “Drita”, nr. 2076, datë 13.12.2023, nr. 271, datë 10.1.2024 dhe aplikimin e fundit nr. 523, datë 27.2.2024. Ky aplikim është refuzuar nga ASHK Tropojë pasi zona kadastrale është digjitalizuar dhe nga ana e shoqërisë duhet të depozitohet një plan rilevimi sipas VKM-së nr. 782, datë 7.10.2020 për secilën pasuri që bie në gjurmën e projektit. Shoqëria ka bërë me dije se është në proces për hartimin e plan rilevimeve sipas kërkesës së ASHK Tropojë.

- Për sa më sipër referuar dhe afateve që merr një regjistrim në ASHK, rreth 30 ditë ka raste edhe më shumë e duke marrë parasysh që shoqëria aplikimin e ka bërë në datën 27.2.2024 dhe i është refuzuar, aktualisht nga ana e saj është duke u hartuar dokumentacioni i kërkuar nga ASHK Tropojë, si e tillë vlerësojmë që afati i depozitimit të dokumentacionit pronësor të jetë i njëjtë me atë të pikës 3, pra deri në datën 12.7.2024.

- **Në kuadër të plotësimit të kushit të lënë në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9/2022, i ndryshuar**, është zhvilluar korrespondencë me shoqërinë me shkresat e referuara edhe sa më sipër nga shoqëria janë depozituar aplikimet e bëra për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. aplikimi AN051220230010, datë 5.12.2023, AN181220230005, datë 18.12.2023, AN130220240016, datë 13.2.2024, të cilat janë refuzuar për mungesë dokumentacioni dhe detyrime të pa shlyera, aplikimi i fundit nr. AN120420240013 mban datën 12.4.2024, statusi i aplikimit është “Dokumentacion i plotë”. Gjithashtu dhe pagesat e bëra për tarifat e përdorimit të burimit ujqor sipas marrëveshjes që ka nënshkruar shoqëria me AMBU-në, për t’i likuiduar me këste.

- Nga korrespondenca me AMBU-në me shkresën nr. 633 prot., datë 15.2.2024 në lidhje me aplikimet e këtij subjekti dhe afatet e trajtimit të një aplikimi, AMBU-ja, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 633/1 prot., datë 12.2.2024 konfirmoi

aplikimet e bëra nga shoqëria si më sipër cituar dhe arsyet e refuzimit. Gjithashtu, AMBU-ja sqaron se në rastet kur dokumentacioni është depozituar i plotë dhe i saktë nga ana e subjekteve, në përgjithësi procedura zgjat me përafërsi rreth 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e aplikimit deri në vendim marrjen e KBU-së.

- Për sa më sipër cituar, referuar përgjigjes së AMBU-së dhe kërkesës së shoqërisë për shtyrjen e afatit për depozitimin e lejes së përdorimit ujqor, vlerësojmë që të pranohet kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit, si e tillë pika 3 e dispozitivit do të ndryshojë duke i lënë detyrimin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor deri më datën 12.7.2024. Po ashtu pika 4 në vijim do të ketë përmbajtjen: ***nëse subjekti ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në depozitimin e lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor.***

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.12.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për zonën ku ushtron veprimtarinë HEC “Drita”, brenda datës 12.7.2024.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.12.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

3. Shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të burimit ujqor sipërfaqësor, deri në datën 12.7.2024.

3. Pika 4 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.12.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

4. Në rast se shoqëria “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. ka një urdhër për ndërprerjen e aktivitetit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) atëherë nuk ka të drejtë të operojë/ushtrijë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, deri në depozitimin e lejes së rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të



ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 83, datë 2.5.2024

MBI LLOGARITJEN E PAGESAVE
RREGULLATORE PËR VITIN 2024

Në mbështetje të nenit 17, pika 4, nenit 20, germa “d”, nenit 35, pika 1, neneve 45 dhe 46, nenit 51, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 14 dhe 30, pika 3, nenit 31, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 5, pikat 5.2, 5.3 dhe 5.4, nenit 6, pikat 6.1, 6.1.1 (germat “a”, “b” dhe “c”), 6.2, 6.3 dhe 6.4 të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar; neneve 15, 16 dhe 17 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 2 të vendimit nr. 171, datë 15.5.2023, të Bordit të ERE-s “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2023”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.5.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 1017 prot., datë 30.4.2024 nga drejtoritë teknike “Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2024”,

konstatoi se:

- ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- ERE, me shkresat dhe e-maillet e protokolluara gjatë periudhës janar–prill 2024, me lëndë “*Kërkohet depozitimi i pasqyrave financiare të plota për vitin 2023*”, ju rikujtojë të gjitha subjekteve të licencuara përmbushjen e detyrimit për depozitimin e pasqyrave financiare për vitin 2023 duke mbajtur në konsideratë dhe ndarjen në llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara, si dhe për çdo

aktivitet tjetër që nuk lidhet me sektorin e energjisë elektrike, me qëllim shmangien e ndërshtetëzimit dhe cenimit të konkurrencës, në zbatim të përcaktimeve të nenit 35, pika 1 dhe nenit 46, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

- Duke iu referuar bazës së të dhënave, rezultojnë 374 të licencuar nga ERE deri në fund të vitit 2023, të cilët janë subjekt i pagesave rregullatore për vitin 2024.

- Pagesa rregullatore për vitin 2024 është përlllogarit mbështetur në përcaktimet e pikave 5.3 dhe 5.4 të nenit 5 dhe pikave 6.1, 6.1.1 germet “a”, “b” dhe “c”, 6.2, 6.3 dhe 6.4, të nenit 6 të “Rregullores mbi përcaktimin e miratimit e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190/2017, e ndryshuar.

- Informacioni bazë për llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2024 u përfutua në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

- Për të licencuarit që nuk kanë zhvilluar aktivitet apo që në momentin e llogaritjes së pagesës rregullatore nuk e kanë filluar aktivitetin për të cilin janë licencuar, në zbatim të dispozitave 5.2 dhe 6.3 të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, e ndryshuar, pagesa rregullatore është llogaritur në shumën fikse prej 100 mijë lekësh.

- E njëjta shumë fikse është zbatuar edhe për shoqëritë që kanë më shumë se një licencë dhe nuk i kanë paraqitur pasqyrat financiare të ndara sipas aktiviteteve të licencuara në zbatim të kërkesës për ndarjen e llogarive përcaktuar në nenin 35, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, dhe pikës 3, të nenit 30, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar. Kështu, në rastet kur shoqëritë i paraqesin llogaritë e konsoliduara, atëherë ndër dy ose më shumë aktivitete të licencuara, vetëm njërit prej tyre i është llogaritur pagesa rregullatore nëpërmjet peshës specifike të të ardhurave ndaj totalit të të ardhurave të sektorit, ndërsa për aktivitetet e tjera është zbatuar automatikisht tarifa fikse prej 100,000 lekësh.

- Për të licencuarit të cilët kanë ushtruar aktivitetin e licencuar gjatë vitit 2023, sikurse cituar më sipër, llogaritja e pagesës rregullatore është kryer në zbatim të përcaktimeve të pikave 5.3, 6.1, 6.1.1 (pikat “a”, “b” dhe “c”) dhe 6.2 të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, e ndryshuar, të cilat përcaktojnë se pagesa duhet të jetë në



përpjesëtim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar dhe llogariten në bazë të peshës specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i çdo të licencuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike dhe sektorit të gazit natyror.

- Për efekt të përlogaritjes së pagesave rregullatore të vitit 2022 (për subjektet e listuara në vijim), në mungesë të pasqyrave financiare të vitit 2021 është konsideruar pagesa rregullatore e miratuar me vendimin nr. 142/2021, të Bordit të ERE-s, pagesë, e cila do të korrigjohet në bazë të të ardhurave faktike të këtyre subjekteve mbështetur në PF të periudhës në fjalë. Subjektet për të cilat është kryer korrigjimi sa më sipër cituar janë si vijon:

- “Euron Energy” sh.p.k.;
- “Alb-Energy” sh.p.k.;
- “Energal” sh.p.k.;
- “GSA” sh.p.k.;
- “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k.;
- “Green Energy Trading Albania” sh.p.k.;
- Albpetrol sh.a.

- Si rrjedhojë e rillogaritjes së pagesave rregullatore për periudhën 2022 është kryer korrigjimi rezultues për të gjithë të licencuarit e tjerë, të cilët kanë rezultuar me të ardhura për periudhën pasardhëse respektive duke sjellë si rrjedhojë dhe korrigjimet përkatëse në përlogaritjen e pagesave rregullatore rezultuese të vitit 2024, në zbatim të pikës 2 të vendimit nr. 124, datë 31.5.2022, të Bordit të ERE-s. Shoqëritë të cilat i është rillogaritur pagesa rregullatore për vitin 2023 janë: “KESH” sh.a., “GSA” sh.p.k., “Kurum International” sh.a., “Ayen as Energji” sh.p.k. dhe “Ayen Energy Trading” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2024 sipas tabelës bashkëlidhur.

2. Diferencat që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2023, të konsiderohen në llogaritjen e pagesave të rregullimit të periudhës pasardhëse.

3. Të licencuarit subjekt i këtij vendimi (sipas tabelës bashkëlidhur) duhet të kryejnë pagesat rregullatore ndaj ERE, jo më vonë se 30 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi, në të kundërt, do të jenë subjekt i aplikimit të masave administrative të parashikuara në nenin 42, pika 1, germa “ç”, pika 2, germa “b” dhe nenit 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 27, pika 1, germa “ç” dhe nenit 106, germa “a” (xi) e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, miratuar me vendimin nr. 125, datë 29.7.2016, të Bordit të ERE-s.

4. Për të licencuarit, për të cilët pagesa rregullatore për vitin aktual është pezulluar, nëse do të ndryshojnë rrethanat ligjore, që çuan në pezullim, ky vendim do të jetë objekt rishikimi sa i përket përlogaritjes së pagesave rregullatore që do të rezultojnë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



I	Liçensë për prodhim	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	"KESH" sh.a	J61817005F	44,579,242
2	"KURUM INTERNATIONAL " sh.a.	K02727230T	2,962,580
3	"TERMOCENTRALI VLORE" sh.a	K72422003G	100,000
4	"EMIKEL" sh.p.k	K23418201C	103,389
5	"ALBANIAN GREEN ENERGY" sh.p.k	K71624027U	1,100,220
6	"BALKAN GREEN ENERGY " sh.p.k	K71624026M	1,791,054
7	"SPAHIU GJANÇ" sh.p.k.	K41316003O	260,469
8	"WONDER POWER" sh.a	K39003403C	256,967
9	"AMAL" sh.p.k	K08027612N	56,662
10	"HIDRO INVEST 1" sh.p.k	K89504202H	776,082
11	"PURE ENERGY STEBLEVA" sh.p.k	K87922601G	76,555
12	"MALIDO - ENERGJI" sh.p.k	K98824001D	125,370
13	"TEODORI 2003" sh.p.k	K42301006L	306,568
14	"ENERGJI ASHTA" sh.p.k	K82417005V	5,827,311
15	"HIDROALBANIA ENERGJI" sh.p.k	K98420202O	1,469,011
16	"POWER-ELEKTRIK-SLABINJE" sh.p.k	K81813003S	515,709
17	"HEC- i BISHNICA 1,2 "sh.p.k	K82403011S	328,374
18	"C & S Construction Energy" sh.p.k	K81914029T	1,192,606
19	"HydroEnergy" sh.p.k	K91527017E	507,024
20	"WEnerg " sh.a.	K92118019L	365,846
21	"DISHNICA ENERGJI" sh.p.k	K94015001S	12,499
22	"ELEKTRO LUBONJA" sh.p.k	K94003002M	17,823
23	"KOKA & ERGI ENERGY PESHK" sh.p.k	K88027901B	427,942
24	"ANSARA KONÇENSION" sh.p.k	K83622201L	9,586
25	"ENERGY PLUS" sh.p.k	K91928002U	1,592,602
26	"HEC VLUSHE " sh.p.k	K81915002A	1,210,072
27	"ENERGY PARTNERS AL" sh.p.k	K92129030I	574,399
28	"KORKIS-2009 " sh.p.k	K93008001E	2,529
29	"FERAR ENERGY " sh.p.k	K91915001Q	100,000
30	"HEC - i DRAGOSTUNJE" sh.p.k	K92230003T	708,343
31	"HP OSTROVICA ENERGY" sh.p.k	K99230402D	561,173
32	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	K92115027K	1,632,828
33	"BEKIM ENERGJITIK" sh.p.k	K99605301O	129,700
34	"SELIShte" sh.p.k	K86921702N	218,276
35	"ERMA M.P." sh.p.k	K84606001N	99,110
36	"DITEKO" sh.p.k	K92108022E	4,056,007
37	"IDRO ENERGIA PULITA" sh.p.k	L01305510P	285,790
38	"SNOW ENERGY" sh.p.k	L06614401F	213,388
39	"STRAVAJ ENERGY" sh.p.k	L11823001A	385,193
40	"PESHKU-PICAR I" sh.p.k	K92925601M	14,552
41	"HYDRO - SALILLARI" sh.p.k	L11810008O	25,792
42	"ALBANIAN POWER " sh.p.k	K81918013H	629,537
43	"HYDRO POWER PLANT OF KORCA" sh.p.k	K81830009N	284,268
44	"HENZ ENERGY"sh.p.k	K91502021A	846,836
45	"HYDROBORSH" sh.p.k	K92129029E	247,687
46	"LU & CO ECO ENERGY 2011" sh.p.k	L16411401I	31,709
47	"GJO-SPA POWER"sh.p.k	K87920201S	1,631,482
48	"ERDAT LURA" shpk	K82321008Q	1,312,068
49	"E.T.H-H "shpk	L14307001D	127,541
50	"REJ ENERGY" shpk	K94821601Q	571,685



I	Liçensë për prodhim	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
51	"ÇAUSHI-ENERGJI" shpk	K98217001T	119,590
52	"SA-GLE KOMPANI" shpk	K92227019N	130,090
53	"ENERGJI-XHAÇI " shpk	K96917601D	24,859
54	"TRUEN" shpk	L21617015E	156,791
55	"DUKA T2" shpk	K48130531M	118,733
56	"TUÇEP" shpk	L06804402P	98,517
57	"HEC TRESKA" shpk	L22322003A	407,729
58	"HYDRO ENERGY SOTIRA" shpk	K97212802C	151,487
59	"SHUTINA ENERGJI" shpk	L01613008A	110,693
60	"ZALL HERR ENERGJI 2011" sh.p.k	L21310027G	123,542
61	"Hidrocentrali QARR & KALTANJ" sh.p.k	L37902001E	144,636
62	"BARDHGJANA" shpk	L12018005I	129,351
63	"Gjoka Konstruktion - ENERGJI" shpk	L01815004G	178,365
64	"SAROLLI" sh.p.k	J74706049O	36,889
65	"En.Ku" sh.p.k	K81511029P	100,000
66	"MAKSI ELEKTRIK " sh.p.k	K54708001A	34,472
67	"JUANA " sh.p.k	K48210601P	43,676
68	"W.T.S-ENERGJI" sh.p.k	K48109743L	86,063
69	"MARJAKAJ" sh.p.k	K46909003H	35,780
70	"FAVINA.I." sh.p.k	K54624001I	348,089
71	"Selca Energji" sh.p.k	K98510701M	235,425
72	"DN & NAT ENERGJI" shpk	L08908001K	56,257
73	"ENERGO-SAS" shpk	K64006850W	703,287
74	"MUSO HC QYTEZË" shpk	K86504601R	74,594
75	"HEC-i Tërvolit" shpk	K73621202N	1,024,428
76	"REMI" shpk	K57604601T	400,883
77	"M.T.C. ENERGY" shpk	K91524003T	263,787
78	"EnRel Hydro" shpk	L33915001P	169,889
79	"GUR SHPAT ENERGY" shpk	K91425017O	307,736
80	"BISTRICA 3 ENERGY" shpk	K82118005R	165,639
81	"GJURR REÇ" shpk	L36814701J	432,223
82	"SA'GA - MAT " shpk	L11814001B	406,006
83	"HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION" sh.p.k.	K92201013T	495,522
84	"FATLUM" shpk	L32125021H	24,272
85	"KOXHERRI ENERGJI" sh.p.k	L17231401M	55,679
86	"EURON ENERGY" sh.p.k	L57703202C	2,400,270
87	"ALB-ENERGY " sh.p.k	L51503039D	1,843,219
88	"ENERGAL" sh.p.k	L57703201R	634,243
89	"KISI-BIO-ENERGJI " sh.p.k	K86907701E	181,856
90	"HEC LANABREGAS" sh.a	L41918001E	688,534
91	"GAMA ENERGY" sh.p.k	K92224004U	246,519
92	"HEC-i KABASH POROCAN" sh.p.k	K82403009G	348,992
93	"LENGARICA & ENERGY " sh.p.k	K83026602A	849,697
94	"MESOPOTAM ENERGY" sh.p.k	L31917016A	73,877
95	"DENAS POWER sh.p.k	L34102003N	1,354,122
96	"STRELCA ENERGY" sh.p.k	K91610007H	415,734
97	"HP UJANIKU ENERGY" sh.p.k	L19509401H	157,456
98	"C & S ENERGY" sh.p.k	K92402005Q	1,047,702
99	"NISHOVA - ENERGY" sh.p.k	K99631401M	11,758
100	"PERPARIMI SK" sh.p.k	K99601201L	67,979



I	Liçensë për prodhim	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
101	"DRAGOBIA ENERGY" sh.p.k	K92025004T	2,478,212
102	"BALLENJA POWER MARTANESH" sh.p.k	L37201401C	127,450
103	"HEC LASHKIZA" sh.p.k	L21917008H	222,845
104	Liria Energji sh.p.k	L34203002N	336,446
105	DEVOLL HYDROPOWER sh.a	K82418002C	24,841,904
106	REKA ENERGY sh.p.k	L27705201B	100,000
107	GAVRAN ENERGY sh.p.k	L32012503R	132,364
108	PRELL ENERGY sh.p.k	L17610901S	1,318,225
109	XHENGU ENERGJI sh.p.k	L34616003G	278,801
110	DAAB ENERGY GROUP sh.p.k	L32127008N	78,849
111	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k	L32126004A	926,971
112	"ENERGJI UNIVERS" sh.p.k	K82109507S	212,917
113	"SKATINË - HEC" sh.p.k	L39809601H	158,213
114	"AYEN AS ENERGJI" sh.a	L11731504A	23,525,616
115	"EUROBIZNES" sh.p.k	J74818812C	15,772
116	"THE BLUE STAR" sh.p.k	J73721019U	181,687
117	"AFRIMI K" sh.p.k	K07713216Q	231,295
118	"SIMA-COM" sh.p.k	L01502020G	209,473
119	"HEC LLËNGË" sh.p.k	L22125012H	340,209
120	"ALESIO - 2014" sh.p.k.,	L41713003M	100,000
121	"LUÇENTE - KONÇESIONARE" sh.p.k	L07926601T	114,065
122	"HYDRO SETA" sh.p.k	L31528016T	1,227,546
123	"FAVINA.1." sh.p.k	K54624001I	103,623
124	"DOMI TEC" sh.p.k.	L32301058Q	80,715
125	"BLAC ENERGY" sh.p.k	L59024001B	32,836
126	"DERBI-E" sh.p.k	K77916947A	78,760
127	"EDIANI" sh.p.k.	L39523001J	81,365
128	"ALESIO - 2014" sh.p.k.,	L41713003M	100,000
129	"OSOJA HPP" sh.p.k.	L83719003E	278,745
130	"SGD ENERGY" sh.p.k.	L66523702K	66,021
131	"SANG 1" sh.p.k	L52414501C	100,000
132	"SPE GJADËR" sh.p.k	L32120012G	857,492
133	"BE-IS ENERGY" sh.p.k	L61621008A	100,000
134	"IRARBA ENERGJI" sh.p.k	L38402901A	82,692
135	"MP-HEC" sh.p.k.	K93826001D	54,005
136	"ELVA 2001" sh.a.	K12809402J	131,766
137	"HEC ARSTI" sh.p.k	L61601028F	444,098
138	"HYDRO POWER PANARIT" sh.p.k	L52229023C	169,324
139	"D I E Z E L A" sh.p.k	K91420010C	100,000
140	"KROI MBRET ENERGJI" sh.p.k	L29326401S	427,627
141	"ERA HYDRO" sh.p.k	L62309013O	339,694
142	"GEGA-G" sh.p.k.	K27713604T	282,454
143	"KALISI HYDROPOWER" sh.p.k.	L81818009A	839,210
144	SEKA HYDROPOWER sh.p.k	L32116020A	2,224,031
145	"MATEO & CO" sh.p.k.	L61720018E	266,846
146	"TIRANA ENERGJI" sh.p.k	L72007015M	383,069
147	"KOKA & ERGI ENERGY STAVEC" sh.p.k.	K88027902J	996,658
148	"IDI 2005" sh.p.k	K61507510N	218,313
149	"ERDY ENERGY" sh.p.k.	L61313061F	316,776
150	"HEC ZALL XHUXHË" sh.p.k.	L32201037O	191,244



I	Liçensë për prodhim	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
151	"GREENTECH ENERGY SYSTEMS" sh.p.k	L61618004V	40,084
152	"AGETA" sh.p.k	L42417014R	107,850
153	"ARIS ALBANIA" sh.p.k	K97114401A	307,870
154	"REI-ENERGJI" sh.p.k	L22818201N	163,982
155	"GERTI" sh.p.k	J96829417K	389,267
156	"BREÇANI - R.O.S.P" sh.p.k	K52116005E	303,883
157	"LAJTHIZA INVEST" sh.p.k	J98009202P	127,541
158	"HEC TERFOJA" sh.p.k	L77727201B	208,932
159	"ECO - ELB" sh.a	M13606204T	101,607
160	"VOKOPOLA ENERGJI" sh.p.k	L31407010B	2,318
161	"Egnatia Hydropower" sh.p.k	L82529203M	100,000
162	"SOT -AL" sh.p.k (eolike)	K71819034H	100,000
163	"E VENTO srl Albania" sh.p.k (eolike)	K81419015N	100,000
164	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korçë)	J64103141O	100,000
165	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	L73015401Q	93,185
166	"Seman Sunpower" sh.p.k	K81722018P	131,642
167	"SEMAN1SOLAR" sh.p.k.	L81416014O	129,482
168	"SEMAN2SUN" sh.p.k	L73629401M	129,428
169	"SONNE" sh.p.k	L73015405C	128,224
170	"AED SOLAR" sh.p.k	L73014403E	128,391
171	"AEE" sh.p.k.	K81414038D	147,815
172	"R T S " sh.p.k.	L76812601U	125,420
173	"Smart Watt " sh.p.k	L72320013B	144,911
174	"ES 2019" sh.p.k	L92801402B	144,347
175	"STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA" sh.a	L82006008C	66,079
176	"KESH" sh.a	J61817005F	100,000
177	"KARAVASTA SOLAR" sh.p.k	M02020001J	100,000
178	"SPV BLUE 1" sh.p.k	M11512005P	100,000
179	"NTSP" sh.p.k	L86326601H	118,373
180	"KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK" sh.p.k	L97026601B	119,552
181	"TREN SUN SYSTEM" sh.p.k	M06812602A	121,294
182	"SUN BEAT SYSTEM" sh.p.k	L97019601M	119,458
183	"GREEN ENERGY BILISHTI" sh.p.k	M06812603H	112,959
184	"EZ-5 ENERGY" sh.p.k	L91325503D	100,000
185	"ERNI SOLAR" sh.p.k	L97016603N	101,081
186	"CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)" sh.p.k	L42311012O	100,000
187	"HYDROPOWER" sh.p.k.	K51828006W	100,000
188	"DIMAX ALBANIA" sh.p.k	L31908006Q	100,000
189	"ALBSOLAR" sh.p.k.	M21317508U	21,176
190	"ATEANI ENERGY" sh.p.k	L78305901P	62,864
191	ALB SUN ENERGY sh.p.k	L82208032O	100,000
192	"BIGWIND" sh.p.k.	M11620024S	100,000
193	GERTI sh.p.k	J96829417K	100,000
194	"SUN AVENUE" sh.p.k	L72320028C	100,000
195	"SUNPOWER 2017" sh.p.k	L72218037L	100,000
196	Sun Energy Solutions sh.p.k	M21311011D	6,874
197	Erseka Solar Park 1 sh.p.k	M24816001T	100,000
198	"G.S.K" shpk	M01707503J	100,000
199	"Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" shpk	M31529026J	100,000
200	IDI 2005 sh.p.k	K61507510N	100,000
200	Total I		170,790,510



II	Liçensë për transmetim të energjisë elektrike/gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	“OST” sh.a	K42101801N	31,779,172
2	“ALBGAZ” sh.a.	L71306034U	54,411
3	TAP AG Albania sh.p.k	K92402023O	35,499
3	Total II		31,869,082
III	Liçensë për shpërndarje të energjisë elektrike/gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	“OSSH” sh.a	L81530018E	104,368,891
2	“ALBGAZ” sh.a.	L71306034U	100,000
2	Total III		104,468,891
IV	Liçensë për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	“FSHU” sh.a	L81530016L	20,856,248
2	“ALPIQ ENERGY ALBANIA” sh.p.k	K91906013R	100,000
3	“GEN - I Tirana” sh.p.k	K81413005A	100,000
4	“GSA”sh.p.k	J61820031J	78,508
5	“KURUM INTERNATIONAL” sh.a	K02727230T	100,000
6	“AYEN ENERGY TRADING” sh.a	L32130008F	94,140
7	“DEVOLL HYDROPOWER” sh.a	K82418002C	-
8	“ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k	L42304017T	78,471
9	“ENERGY SUPPLY - AL” sh.p.k	L01320008C	100,000
10	“LENGARICA & ENERGY” sh.p.k	K83026602A	100,000
11	“ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k	L41811003F	750
12	“ALBANIAN GREEN ENERGY” sh.p.k	K71624027U	100,000
13	“ALBPETROL” sh.a	J82916500U	- 458,253
14	“Energy Financing Team Tirana” sh.p.k	L71801017U	100,000
15	“ENERGJI ASHTA” sh.p.k	K82417005V	100,000
16	“FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a (FTL sh.a)	L81530029T	203,989
17	“ENER TRADE” sh.p.k	L82118017S	100,000
18	“ReNRGY Trading Group” sh.p.k	L81818026N	100,000
19	“KESH” sh.a	J61817005F	100,000
20	“EZ-5 ENERGY” sh.p.k	L91325503D	102,474
21	“AYEN AS ENERGJI” sh.a	L11731504A	100,000
22	“DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k	K92025004T	100,000
23	“AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k	M12221008I	100,000
24	“NOA ENERGY TRADE” sh.p.k	L42203031A	263,494
25	Yildirim Energy Europe Albania sh.p.k	M12107031P	100,000
26	“H&K @ Vala Mar Residences” sh.p.k	L72113506H	100,000
27	“PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k	M21525012S	100,000
28	“Salillari Energy Trade” sh.p.k	M21528006M	100,000
29	“NRG Power” sh.p.k	M21615009U	100,000
30	“Alb Energy Trade” sh.p.k	M22127044J	100,000
31	“SWISS BALANCING POOL” sh.p.k	M32128022I	100,000
32	ALBPETROL sh.a	J82916500U	100,000
33	“NATYRE ENERGY” sh.p.k	L91331002S	100,000
34	Energy24’ sh.p.k	L91331002S	100,000
34	Total IV		23,619,822
V	Liçensë të Njëhsuar për furnizim të energjisë elektrike /gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	“FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k.	M21421046C	200,000
2	“SOLE 24 DOOEL Shkup-Dega në Shqipëri” Dege e shoqërisë së huaj	M31625022G	100,000
2	Total V		300,000
VI	Operimi i Tregut të Energjisë Elektrike	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE -ALPEX SH.A.	M02223006B	134,631
1	Total VI		134,631



VII	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	"GEN - I Tirana" sh.p.k	K81413005A	149,059
2	"KESH" sh.a	J61817005F	7,390,246
3	"WONDER POWER" sh.a	K39003403C	100,000
4	"HydroEnergy" sh.p.k	K91527017E	100,000
5	"ENERGY PARTNERS AL" sh.p.k	K92129030I	100,000
6	"YLLIAD" sh.p.k	K91617013R	100,952
7	"ENERGY PLUS" sh.p.k	K91928002U	100,000
8	"HEC VLUSHE" sh.p.k	K81915002A	100,000
9	"HEC - i DRAGOSTUNJE" sh.p.k	K92230003T	100,000
10	"HP OSTROVICA ENERGY" sh.p.k	K99230402D	100,000
11	"GSA" sh.p.k	J61820031J	4,299,385
12	"ERMA M.P." sh.p.k	K84606001N	100,000
13	"PROINFINIT CONSULTING" sh.p.k	M21525012S	524
14	"DITEKO" sh.p.k	K92108022E	100,000
15	"HEC LANABREGAS" sh.a	L41918001E	100,000
16	"KURUM INTERNATIONAL" sh.a	K02727230T	100,000
17	"MALIDO - ENERGJI" sh.p.k	K98824001D	100,000
18	"SNOW ENERGY" sh.p.k	L06614401F	100,000
19	"STRAVAJ ENERGY" sh.p.k	L11823001A	100,000
20	"HYDRO - SALILLARI" sh.p.k	L11810008O	100,000
21	"ENERGY SUPPLY - AL" sh.p.k	L01320008C	101,047
22	"ALBANIAN POWER" sh.p.k	K81918013H	100,000
23	"ALBANIAN GREEN ENERGY" sh.p.k	K71624027U	100,000
24	"BALKAN GREEN ENERGY" sh.p.k	K71624026M	100,000
25	"HENZ ENERGY" sh.p.k	K91502021A	100,000
26	"ENERGJI ASHTA" sh.p.k	K82417005V	100,000
27	"ERDAT LURA" sh.p.k	K82321008Q	100,000
28	"REJ ENERGY" sh.p.k	K94821601Q	100,000
29	"Danske Commodities Albania" sh.p.k	L21702005R	- 674
30	"WEnerg" sh.a	K92118019L	100,000
31	"TRUEN" sh.p.k	L21617015E	100,000
32	"SHUTINA ENERGJI" sh.p.k	L01613008A	100,000
33	"ZALL HERR ENERGJI 2011" sh.p.k	L21310027G	100,000
34	"Gjoka Konstruktion - ENERGJI" sh.p.k	L01815004G	100,000
35	"SPAHIU GJANÇ" sh.p.k	K41316003O	100,000
36	"M.T.C. ENERGY" sh.p.k	K91524003T	100,000
37	"AYEN ENERGY TRADING" sh.a	L32130008F	2,314,964
38	"EnRel Hydro" sh.p.k	L33915001P	100,000
39	"GJURR REÇ" sh.p.k	L36814701J	100,000
40	"BISTRICA 3 ENERGY" sh.p.k	K82118005R	100,000
41	"Emikel 2003" sh.p.k	K23418201C	100,000
42	"HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION" sh.p.k	K92201013T	100,000
43	"ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA" sh.p.k	L41811003F	102,113
44	"NOA ENERGY TRADE" sh.p.k	L42203031A	2,731,176
45	"POWER-ELEKTRIK-SLABINJE" sh.p.k	K81813003S	100,000
46	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	K92115027K	100,000
47	"FATLUM" sh.p.k	L32125021H	100,000
48	"DEVOLL HYDROPOWER" sh.a	K82418002C	4,501
49	"ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" sh.p.k	L42304017T	100,000
50	"GREEN Energy Trading Albania" sh.p.k	L42125016S	97,592



VII	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
51	"KOXHERRI ENERGJI" sh.p.k	L17231401M	100,000
52	"ALPIQ ENERGY ALBANIA" sh.p.k	K91906013R	46,105
53	"ENERGAL" sh.p.k	L57703201R	100,000
54	"EURON ENERGY" sh.p.k	L57703202C	100,000
55	"HEC-i KABASH POROCAN" sh.p.k	K82403009G	100,000
56	"GAMA ENERGY sh.p.k	K92224004U	100,000
57	"KISI-BIO-ENERGJI" sh.p.k	K86907701E	100,000
58	"LENGARICA & ENERGY" sh.p.k	K83026602A	100,000
59	"MESOPOTAM ENERGY" sh.p.k	L31917016A	100,000
60	"DENAS POWER" sh.p.k	L34102003N	100,000
61	"HP UJANIKU ENERGY" sh.p.k	L19509401H	100,000
62	C & S ENERGY sh.p.k	K92402005Q	100,000
63	NISHOVA - ENERGY sh.p.k	K99631401M	100,000
64	"PERPARIMI SK " sh.p.k	K99601201L	100,000
65	DRAGOBIA ENERGY shpk	K92025004T	100,000
66	BALLENJA POWER MARTANESH sh.p.k	L37201401C	100,000
67	HEC LASHKIZA sh.p.k	L21917008H	100,000
68	Liria Energji sh.p.k	L34203002N	100,000
69	XHENGO ENERGJI sh.p.k	L34616003G	100,000
70	DAAB ENERGY GROUP sh.p.k	L32127008N	100,000
71	"PPC Albania" sh.a.	L71319022Q	100,000
72	"Energy Financing Team Tirana" sh.p.k	L71801017U	77,122
73	"ALBPETROL "sh.a	J82916500U	100,000
74	"BINDI" sh.p.k	J71630001K	100,076
75	"SMART Trade & Consulting" sh.p.k	L72122041K	100,402
76	"ReNRGY Trading Group" sh.p.k	L81818026N	307,981
77	"URADRIN" sh.p.k	L66425401O	100,000
78	"FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" sh.a (FTL sh.a)	L81530029T	564,558
79	"AEE" sh.p.k.	K81414038D	100,000
80	"ENER TRADE" sh.p.k	L82118017S	6,521,637
81	"HYDRO SETA" sh.p.k	L31528016T	100,000
82	"EZ-5 ENERGY" sh.p.k	L91325503D	604,484
83	"Energy24" sh.p.k	L91331002S	71,298
84	"POWER AND GAS OPERATIONS" (PGO) sh.p.k	L91330014N	100,000
85	"SANG 1" sh.p.k	L52414501C	100,000
86	"ENSCO TRADING (ALBANIA)" sh.p.k	L91819025L	932,004
87	"AYEN AS ENERGJI" sh.a	L11731504A	100,000
88	"ELECTRAL BATRA HPP" sh.p.k	L62423006M	100,000
89	"KROI MBRET ENERGJI" sh.p.k	L29326401S	100,000
90	"AxpO Albania" sh.a	K51628010V	- 33,455
91	"GEGA - G" sh.p.k.	K27713604T	100,000
92	"TIRANA ENERGJI" sh.p.k	L72007015M	100,000
93	"AGETA" sh.p.k	L42417014R	100,000
94	"ERDY ENERGY" sh.p.k	L61313061F	100,000
95	"GERTI" sh.p.k	J96829417K	100,000
96	"TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT" sh.p.k	J82427007R	530,695
97	"INFO - TELECOM" sh.p.k	K92402002P	535,487
98	"AlbEsp Trading & Consulting" sh.p.k	M12221008I	37,232
99	Yildirim Energy Europe Albania sh.p.k	M12107031P	100,000
100	"ADA Solar SE" sh.p.k	L81906036J	15,408



VII	Liçensë për tregtim te energjisë elektrike /gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
101	"HEC TERFOJA" sh.p.k	L77727201B	100,000
102	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k	L32126004A	100,000
103	"Duferco Shqipëria" sh.p.k	L91813110D	100,000
104	"Salillari Energy Trade" sh.p.k	M21528006M	100,000
105	"NRG Power" sh.p.k	M21615009U	100,000
106	"ALB - ENERGY" sh.p.k	L51503039D	100,000
107	"M & K ENERGY TRADING CO" sh.p.k	M04516001I	100,000
108	"Egnatia Hydropower" sh.p.k	L82529203M	100,000
109	"Cosmogral" sh.p.k	L71420011J	100,000
110	"H&K @ Vala Mar Residences" sh.p.k	L72113506H	100,000
111	"IDRO ENERGIA PULITA" sh.p.k	L01305510P	100,000
112	"HYDRO ENERGY SOTIRA" sh.p.k	K97212802C	100,000
113	"HYDROPOWER" sh.p.k	K51828006W	100,000
114	"H & E ENERGY" sh.p.k	L71716029A	100,000
115	"Alb Energy Trade" sh.p.k	M22127044J	100,000
116	BALKGAZ sh.p.k	L81912023I	100,000
117	"ATEANI ENERGY" sh.p.k	L78305901P	100,000
118	"SWISS BALANCING POOL" sh.p.k	M32128022I	100,000
119	"GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k	L71529026M	100,000
120	"Energy Market Albania" sh.p.k	L61530016J	100,000
121	EU GREEN ENERGY sh.p.k	L82323006L	100,000
122	"Balkan Energy Trade" sh.p.k	L62022010A	100,000
123	"NATYRE ENERGY" sh.p.k	L72220033M	100,000
124	SPV BLUE 1 sh.p.k	M11512005P	100,000
124	Total VII		37,401,918

VIII	Liçensë të Njësuara për tregtim të energjisë elektrike /gazit natyror	NIPT	Pagesa Rregullatore 2024
1	"FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS" sh.p.k.	M21421046C	185,145
2	"SOLE 24 DOOEL Shkup-Dega në Shqipëri" Dege e shoqërisë së huaj	M31625022G	100,000
2	Total VIII		285,145
368	Total		368,870,000



VENDIM

Nr. 118, datë 9.4.2024

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE
“GARANCIA SHTETËRORE E HUAS PËR
SUBJEKTET E INDUSTRISË
PËRPUNUESE, KATEGORIA NACE 2,
PËR INVESTIME NË TEKNOLOGJI DHE
INOACION SI DHE PËR BLERJE TË
LËNDËS SË PARË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z. Blendi Gonxhja	kryetar;
Znj. Mimoza Dhëmbi	anëtare;
Znj. Brikena Qela	anëtare;
Znj. Inida Methoxha	anëtare;
Z. Ahmet Mançellari	anëtar;

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 9.4.2024, në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, mori në shqyrtim *ex-post* skemën e ndihmës shtetërore të hartuar, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 221/2024, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”, vlerëson nëse masa është në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore.

I. Procedura

1. Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Agjencinë për Menaxhimin e Garancive dhe Kredive të Pakthyera kanë hartuar vendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare për garantimin e huamarrjes së subjekteve të industrisë përpunuese, kategoria Nace 2, për investime në teknologji dhe inovacion si dhe për blerje të lëndës së parë si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e ndihmës shtetërore, në bazë të planit të ndihmës shtetërore të sipërpërmendur.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi*: akordimi i mbështetjes financiare ndaj sektorit të industrisë përpunuese, e cila është goditur vitet e fundit nga disa prej krizave që kanë ndikuar në ambientin ekonomik të brendshëm dhe të huaj duke u reflektuar në uljen e eksporteve. Plan i ndihmës synon të lehtësojë blerjen e makinerive, automatizimin e linjave të prodhimit, krijimin e kushteve strukturore, për të realizuar ciklin e plotë (Made in Albania), si dhe do të ketë mundësinë e disponimit të likuiditetit për nevoja të blerjes së lëndës së parë.

3. *Baza ligjore e planit të ndihmës*: plani i ndihmës shtetërore mbështetet në nenet 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024; të aktit normativ nr. 1, datë 21.2.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024” dhe ligjin nr. 55/2023 “Për menaxhimin e garancive dhe kredive shtetërore të pakthyera”.

4. *Kohëzgjatja*: referuar planit të ndihmës, Huamarrësi duhet të dorëzojë kërkesën e aplikimit për Hua pranë Huadhënësit jo më vonë se 31 tetor 2024. Kontratat e huas duhet të nënshkruhen jo më vonë se 31.12.2024. Afati i huas do të jetë në diskrecion të Huamarrësit, por duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 7 (shtatë) vitesh në rastin e kredive për investim dhe duke mos tejkaluar në asnjë rast afatin prej 3 (tre) vitesh në rastin e kredive për blerje të lëndës së parë.

5. *Dhënësi i ndihmës*. Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

